



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN



Plani Lokal i Veprimet në Mjedis 2023-2028



PËRMBATJA:

Fjala e Kryetarit të Komunës.....	
Vendimi për hartimin e PLVM-së.....	
Indeksi shkurtesave	
Indeksi i tabelave	
Indeksi i figurave.....	

Pjesa 1

1. Hyrje	
1.1 Baza ligjore për hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis.....	
1.2 Qëllimi dhe objektivat e PLVM-së.....	
1.3 Procesi dhe metodologjia e hartimit të PLVM-së.....	
1.4 Procesi i hartimit të PLVM-së 2023-2028 punëtorit dhe debati publik.....	
1.5 Akteret dhe përgjegjësitë e PLVM-së.....	

Pjesa 2

2. Profili i komunës	
2.1 Pozita gjeografike dhe organizmi administrativ.....	
2.2 Pozita dhe karakteristikat gjeografike.....	
2.3 Karakteristikat klimatike.....	
2.4 Pedologjia dhe kushtet gjeologjike.....	
3. Demografia dhe zhvillimi demografik.....	
3.1 Dendësia	
3.2 Shtimi natyror i popullsisë.....	
4. Vizioni	
4.1 Deçani qytet ekologjik dhe destinacion turistik.....	
5. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese mjedisore.....	
5.1 Analiza mjedisore	
5.2 Pasuritë Natyrore.....	
5.3 Mineralet.....	
5.4 Pyjet	
5.5 Bujqësia	
5.6 Sipërfaqet bujqësore dhe kualitetet e tyre	
5.7 Kultivimi i kulturave bujqësore	
5.8 Prodhimtaria blegtorale.....	
5.9 Prodhimtaria perimore.....	
5.10 Zhvillimi i pemëtarisë.....	
6. Burimet ujore	
6.1 Lumëbardhi i Deçanit	
6.2 Lumëbardhi i Lloqanit.....	
6.3 Uji mineral (Gushavci).....	



7. Ekonomia	
7.1 Shkalla e punësimit	
7.2 Niveli i varfërisë.....	
7.3 Mjedisi biznesor	
7.4 Turizmi dhe hoteleria	
7.5 Trashëgimia natyrore	
7.6 Trashëgimia kulturore.....	
7.7 Zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë	
8. Barazia gjinore.....	
9. Energjia	
9.1 Sektori i ndriçimit publik i rrugëve	
9.2 Telekomunikacioni.....	
9.3 Ngrohja	
10. Infrastruktura dhe shërbimet publike	
10.1 Ujësjellësi	
10.2 Kanalizimi.....	
10.3 Kanalizimi atmosferik.....	
10.4 Menaxhimi i mbeturinave	
10.5 Ndërmarrja Publike Lokale “Higjiena” Sh.A.....	
10.6 Mbeturinat e ndërtimit dhe demolimit (prishjes).....	
10.7 Mbeturinat e bujqësisë dhe industrisë ushqimore.....	
10.8 Mbeturinat e rrezikshme.....	
10.9 Automjetet e hedhura dhe mbetjet e tyre.....	
10.10 Mbeturina e gomës	
10.11 Mbeturinat e pajisjeve elektrike dhe elektronike	
10.12 Mbeturinat e vajërave	
11. Infrastruktura e transportit dhe transporti	
11.1 Ndotja nga Komunikacioni	
12. Infrastruktura publike dhe sociale	
12.1 Shëndetësia	
12.2 Përkujdesja sociale.....	
12.3 Mirëmbatja-higjenanes në QKMF.....	
12.4 Institucionet arsimore	
12.5 Gjelbërimi i hapësirave të shkollave.....	
13. Kultura	
13.1 Manifestimet kulturore.....	
13.2 Hapësirat publike dhe hapësirat e gjelbra.....	

14. Mbrojtja e mjedisit	
14.1 Mjedisi	
14.2 Menaxhimi i mbeturinave.....	
14.3 Mbrojtja e tokave bujqësore	
14.4 Mbrojtja e ajrit	
14.5 Mbrojtja e pyjeve	
14.6 Mbrojtja nga erozioni.....	
14.7 Masat për mbrojtje nga vërshimet.....	
14.8 Zhurma.....	
14.9 Fatkeqësitë natyrore.....	
14. 10 Fatkeqësitë tekniko-teknologjike.....	
14.11 Sipërfaqet me ndotje të lartë (hot spote).....	
14.12 Sipërfaqet e rrezikuara nga zjarri	
14.13 Erozioni	
15. Trashëgimia natyrore.....	
15.1 Zona e veçantë e mbrojtjes.....	
15.2 Rezervati “Bjeshka e Kozhnjerrit”	
15.3 Malet e Prilepit	
15. 4 Lista e objekteve të monumenteve natyrore.....	
15.5 Biodiversitetit.....	
15.6 Flora	
15.7 Fauna	
15. 8 Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemura”	
15. 9 Asetet e Trashëgimisë Kulturore	
15.10 Lista e Trashëgimisë Kulturore për mbrojtje të përkohshme	
16. Identifikimi i Problemeve.....	
16.1 Uji.....	
16.2 Ajri.....	
16.3 Toka.....	
16.4 Biodiversitetit.....	
16.5 Peisazhi dhe ekosistemet specifike.....	
16.6Mjedisi social dhe ekonomik.....	
16.7 Turizmi.....	
17. Plani i veprimit, prioriteti dhe aktivitetet për periudhën 2023-2028.....	
18. Plani i monitorimit dhe i zbatimit	

Shtojca: Projekt propozimi- Rregullimi i hapësirave në fshatin Rastavicë dhe Isniq
- Këndi i lojrave fëmijë



Të nderuar qytetarë të Komunës së Deçanit!



Kam nderin dhe kënaqësinë që t'ju njoh me Planin Lokal të Veprimit në Mjedis, i cili është dokumenti i rëndësishë së veçantë për qytetarët e Deçanit dhe Institucionin Komunal, njëkohësisht, për faktin që ky plan përcakton strategjinë bazike për ruatjen dhe mbrojtjen e vlerave mjedisore, duke detyruar institucionet ta zbatojnë nga afër me përpikëri këtë plan.

Ky plan ka për qëllim kryesor përmirësimin e gjendjes së mjedisit në territorin e komunës. Në kuadër të planit është bërë vlerësimi i gjendjes ekzistuese të mjedisit, janë identifikuar problemet kryesore mjedisore, janë përcaktuar prioritetet kryesore si dhe janë planifikuar afatet, veprimet, aktivitetet dhe projektet kryesore që do të ndërmerren për periudhën e ardhshme 5-vjeçare në fushën e mjedisit në komunën e Deçanit.

Hartimi dhe miratimi i këtij plani është i një rëndësie të veçantë për komunën, meqenëse është kërkesë ligjore që del nga *Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit* dhe po ashtu është pjesë e angazhimeve të komunës, për përmbushjen e përgjegjësisë për fuqizimin e qeverisjes lokale. Objektivi kryesor i këtij plani është që Komuna e Deçanit të ketë një Plan Mjedisor, në harmonizim me normat ligjore të infrastrukturës mjedisore.

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis është në harmoni me *Planin Zhvillimor Komunal* dhe me dokumente të tjera strategjike dhe zhvillimore të komunës. Ky dokument do të ndihmojë po ashtu edhe në përmbushjen dhe zbatimin e politikave mjedisore nacionale dhe plotësimin e kërkesave për realizmin e objektivave që dalin nga dokumentet strategjike mjedisore në nivelin qendror.

Për implementimin e këtij plani komuna do të bëjë edhe planifikimin e nevojshëm buxhetor por, njëkohësisht, ky dokument do të shërbejë edhe për të adresuar kërkesat për mbështetje nga donatorët, për implementimin e projekteve të këtij plani.

Zhvillimi i qëndrueshëm i përcaktuar brenda këtij plani mjedisor, nuk nënkupton vetëm ruajtjen e mjedisit, por edhe shfrytëzimin racional të resurseve për zhvillimin ekonomik, duke e bërë Deçanin qytet ekologjik dhe destinacion turistik.

Përkushtimi im si Kryetar i Komunës, do të jetë i përqendruar në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Deçanit, duke e mbështetur fuqishëm zhvillimin dhe përmirësimin e standardit jetësor dhe mjedisor.

Përzemërsisht,
Kryetari i Komunës:
Bashkim RAMOSAJ



Vendimi për hartimin e PLVM-së



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Në bazë të nenit 24 të Ligjit Nr. 03/L-025 Për Mbrojtje të Mjedisit, sipas planit për Hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis, në bazë të nenit 13 dhe nenit 17 shkronja (e) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 26 pika 3 dhe nenit 56 pika 20 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, me propozimin e Kryetarit të Komunës së Deçanit, z.Bashkim Ramosaj, Kuvendi i Komunës së Deçanit, në mbledhjen e mbajtur me dt.30.05.2022, merr këtë:

V E N D I M

Për hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis 2022-2026

Neni 1

Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis 2022-2026, më qëllim të mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm komunal në Komunën e Deçanit.

Neni 2

Planit Lokal për Veprim në Mjedis duhet të përmbajë të gjitha elementet themelore, të cilat janë përcaktuar në nenin 24 të Ligjit për Mbrojtjen të Mjedisit më Nr. 03-L 025, dhe elementeve strategjikë të Planit të Kosovës për Veprim Mjedisor.

Neni 3

Ngarkohet Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit- Sektori i Mjedisit për hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis, në bashkëpunim me Drejtoritë e Komunës së Deçanit.

Neni 4

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit në bashkëpunim me Drejtoritë e Komunës së Deçanit, Kompanitë Publike, OJQ-të, Komunitetin, duhet të sigurojë të dhënat për përgatitjen e Planit Lokal për Veprimin Mjedisor.

Neni 5

Planit Lokal për Veprimin Mjedisor në përputhje me këto udhëzime dhe nën kushtet dhe parametrat e ligjit të cekur duhet të zbatohen sipas dispozitave ligjore, rregulloreve dhe normave përmes Buxhetit të Komunës së Deçanit.

Neni 6


Planit Lokal i Veprimin në Mjedis, do të financohet nga buxheti i Komunës së Deçanit, në shumën që përcaktohet në Kuvend.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01.Nr.VIII-8

Deçan,dt.20.05.2022



Faqe 1 nga 2

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



Indeksi i shkurtesave

AMMK	Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
APK	Agjencia e Pyjeve të Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
DKA	Drejtoria për Arsim
DZHE	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik
DUPMM	Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
FAO	Organizata Botërore e Ushqimit
KKEE	Fondi Kosovar për Eficiencë të Energjisë
GIZ	Organizata Gjermane për Shoqëri të Hapur
GZK	Gazeta Zyrtare e Kosovës
IHMK	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
IKMN	Instituti Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës
IMMK	Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës
IPA	Instrumenti i Para Anëtarësimit
KINP	Kontrolli i Integruar për Parandalimin e Ndotjes
KRU	Kompania Raionale e Ujësjetës
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NPL	Ndërmarrja Publike Lokale
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ	Organizata Joqeveritare
PKVM	Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis
PLVM	Plani Lokal i Veprimit në Mjedis
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QPS	Qendra për Punë Sociale
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor

Indeksi i tabelave

Tabela 1:	<i>Dokumentet strategjike dhe planifikuese të Komunës së Deçanit</i>
Tabela 2:	<i>Tabela e përbërjes gjeologjike</i>
Tabela 3:	<i>Të dhënat nga Regjistrimet e popullsisë në periudhat 1948 – 2011 për komunën e Deçanit</i>
Tabela 4:	<i>Mbulushmëria me shërbimin e ujësjellësit nga njësia operative KRU "Hidrodrini" sha.a Pejë</i>
Tabela 5:	<i>Përbërja e mbeturinave komunale në komunën e Deçanit</i>
Tabela 6:	<i>Infrastruktura në komunën e Deçanit</i>
Tabela 7:	<i>Numri i institucioneve arsimore sipas niveleve dhe numri i vijuesve sipas niveleve 2019/2020</i>
Tabela 8:	<i>Hapësirat publike dhe hapësirat e gjelbra</i>
Tabela 9:	<i>Zonat dhe monumentet e mbrojtura në Deçan para realizimit të projektit</i>
Tabela 10:	<i>Vlerat e natyrës të evidentuara në komunën e Deçanit-2020</i>
Tabela 11:	<i>Bimët endemike të florës vaskulare, karakteristike për Kosovën të cilat janë të përhapura edhe në Alpet Shqiptare-Komuna e Deçanit</i>
Tabela 12:	<i>Lista e numrit të objekteve të trashëgimisë kulturore sipas kategorive (nën mbrojtje të përhershme dhe të përkohshme) e Trashëgimisë Kulturore</i>
Tabela 13:	<i>Lista e trashëgimisë për mbrojtje të përkohshme</i>
Tabela 14:	<i>Identifikimi i problemit (Ujë, Ajri, Toka, Biodiversiteti, Pejshazi dhe ekosistemet specifike, Mjedisi social dhe ekonomik, Turizmi)</i>
Tabela 15:	<i>Plani i veprimit, prioriteti dhe aktivitetet për periudhën 2023-2028</i>
Tabela 16:	<i>Plani i monitorimit dhe zbatimit</i>

Indeksi i figurave

Figura 1:	<i>Pozita gjeografike e komunës së Deçanit në Kosovë</i>
Figura 2:	<i>Popullsia e Komunës së Deçanit përgjatë viteve 1948-2011</i>
Figura 3:	<i>Taksonet e përhapjes së bimëve sipas ndarjes së Raunkierit</i>

Foto

<i>Foto 1: Punëtorja në SHML "Vëllezërit Frashëri" Deçan</i>
<i>Foto 2: Puntoria në SHML "Tafil Kasuma", Deçan, më datë 08 dhjetor 2022</i>
<i>Foto 3: Puntoria në fshatin Rastavicë, më datë 09 dhjetor 2022</i>
<i>Foto 4: Puntoria më anëtarët e Asamblesë Komunale, më datë 13 dhjetor 2022</i>
<i>Foto 5: Puntoria më anëtarët e Asamblesë Komunale, më datë 27 dhjetor 2022</i>
<i>Foto 6: Debati publik, më datë 23 dhjetor 2022</i>
<i>Foto 7: Debati publik, më datë 23 dhjetor 2022</i>
<i>Foto 8: Puntoria në Ndërmarrjen Publike Lokale "Hixhiena", më datë 13 dhjetor 2022</i>
<i>Foto 9: Puntoria në QKMF "Adem Ukëhaxhaj", më datë 16 dhjetor 2022</i>
<i>Foto 10: Klubi i biçiklistëve të Deçanit</i>

1. Hyrje

1.1. Baza ligjore për hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis (PLVM) është dokument planifikues - strategjik, për të adresuar zgjidhjen e problemeve mjedisore në nivel lokal. Hartimi dhe miratimi i tij është paraparë me Ligjin për Mjedisin (2009/03-L-025), i cili ua përshkruan komunave përgjegjësinë për përgatitjen e planit, për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territorit të tyre. Po ashtu, ai udhëzon: *“planin për mbrojtje të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territorit të komunës, e aprovon Kuvendi Komunal përkatës”*. Ndërkaq, në mënyrë më specifike, specifikon që *“Komunat të miratojnë planet e veprimit lokal në mjedis, ose programe mjedisore për mbrojtjen e mjedisit, në përputhje me Planin e Kosovës për Veprim në Mjedis, sipas interesave specifike të saj”*.

Gjatë hartimit të këtij Plani janë marrë për bazë edhe kërkesat e **Strategjisë së Kosovës për Mjedisin, 2013-2022**. E zhvilluar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit, kjo strategji paraqet bazën për hartimin e Planit të Kosovës për Veprim në Mjedis, orientimet strategjike dhe kornizën e veprimeve për mbrojtjen e mjedisit në nivel kombëtar.

Në hartimin e dokumentit janë marrë në konsideratë edhe ligjet e fushës së mjedisit që prekin interesat në nivelin vendor. Ku synojnë të sigurojnë shkallë të lartë për mbrojtje të mjedisit në procedurën e përgatitjes, miratimit dhe realizimit të projekt-propozimeve të PLVM-së. Ligje, strategji dhe dokumente të tjera të rëndësishme për hartimin e PLVM-së, 2023-2028, janë:

1: Infrastruktura mjedisore ¹

- Ligji nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit
- Ligji nr. 04/L-060 për Mbeturina
- Ligji nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga zhurma
- Ligji nr. 04/L - 086 për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nëmura”
- Ligji nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e ajrit nga ndotja
- Ligji nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e natyrës
- Ligji nr. 03/L-043 për Parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes
- Ligji nr. 03/L-230 për Vlerësimin strategjik mjedisor
- Ligji nr. 03/L-214 për Vlerësimin e ndikimit në mjedis
- Ligji nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës
- Ligji nr. 03/L-153 për Pyjet e Kosovës
- Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale
- Ligji nr. 04/L-175 për Inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit.
- Ligji nr. 04/L – 110 për Ndërtimin
- Ligji nr. 04/L-040 për Rregullimin e tokës
- Ligji nr. 06/L-029 për Mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore
- Ligji nr. 04/L-197 për Kimikate
- Ligji nr. 04/L-174 për Planifikim hapësinor

¹Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (<https://gzk.rks-gov.net/>)

- Ligji nr. 04/L-176 për Turizmin
- Ligji nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.
- Strategjia (2021-2030) dhe Plani i Veprimit (2021-2023) për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë.
- Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2018

Në tabelën 1 janë prezantuar dokumentet planifikuese dhe strategjike të komunës së Deçanit që janë marrë në konsideratë gjatë përcaktimit të objektivave dhe aktiviteteve të PLVM. **Tabela 1:** Dokumentet strategjike dhe planifikuese të Komunës së Deçanit

Dokumenti	Qëllimi dhe fushëveprimi
Statuti i Komunës së Deçanit	Rregullon organizimin e brendshëm të komunës dhe përcakton përgjegjësitë vetiake të organeve komunale.
Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Deçanit	Është bazë për zhvillim të qëndrueshëm në komunën e Deçanit dhe synon ruajtjen e mjedisit, shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve për zhvillim ekonomik, për gjeneratat e ardhshme dhe balancimin e zhvillimeve hapësimore. Përmes këtij plani koordinohen kërkesat sociale dhe ekonomike për hapësirën me funksionet e saj kulturore dhe ekologjike.
Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2012-2017	Dokumenti lokal që është zbatuar gjatë periudhës 2012-2017 me synimin që të zgjidhë problemet mjedisore, nëpërmjet identifikimit të prioritetëve dhe përcaktimit të veprimeve për zgjidhjen e tyre, duke përfshirë të gjithë aktorët e mundshëm për përcaktimin e këtyre veprimeve dhe krijimin e strategjive për zbatimin e tyre në mënyrë efektive, të ndërthurura.
Plani për Menaxhimin e Mbeturinave 2020-2022	Plani Komunal i Menaxhimit të Mbeturinave të Deçanit është dokument planifikimi që rregullon Menaxhimin e Mbeturinave në nivel vendor. Plani synon shtrirjen e shërbimit për menaxhimin e mbeturinave komunale në të gjithë territorin e komunës.
Plani Komunal i Veprimit për Eficencë të Energjisë për Komunën e Deçanit (PKVEE) 2019-2021	Objektivi i PKVEE është zvogëlimi i konsumit të energjisë në objektet publike, transporti dhe ndriçimi publik, rritja e nivelit të komoditetit, zvogëlimi i kostos së shpenzimeve të energjisë si dhe krijimi i sistemit për menaxhimin e energjisë në komunën e Deçanit.
Plani Lokal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave 2021-2025	Plani Lokal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave ka për qëllim zhvillimin e politikave mjedisore për zvogëlim, riciklim, trajtim të duhur të mbeturinave ku nënkupton krijimin e mundësive për zhvillim ekonomik në këtë sektor në nivel komunal dhe nivel vendi si dhe shfrytëzimin sa më racional të resurseve natyrore.
Plani për qendrën e grumbullimit dhe magazinimit të mbeturinave voluminoze	Është dokument planifikimi që mundëson zbatimin e Strategjisë së Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave në nivel vendor, duke kontribuar zbatimit të politikave dhe përmbushjes së objektivave kombëtare.

1.2. Qëllimi dhe objektivat e PLVM-së

Qëllimi i përgjithshëm i Planit Lokal për Veprim në Mjedis për Komunën e Deçanit është që të identifikojë problemet mjedisore, të përcaktojë prioritetet në sektorin e mjedisit dhe të ofrojë zgjidhje për problemet prioritare mjedisore, duke synuar një menaxhim më efektiv të tyre, duke i vendosur ato në agjendën e institucioneve përgjegjëse. Objektivat specifike të planit janë:

- Të bëjë vlerësimin dhe analizën e gjendjes ekzistuese të mjedisit dhe ndikimeve në mjedis nga sektorët e ndryshëm zhvillimorë;
- Të identifikojë dhe përcaktojë problemet dhe mangësitë kryesore mjedisore në territorin e Komunës së Deçanit;
- Të identifikojë dhe përcaktojë prioritetet kryesore që do të adresohen në kuadër të PLVM-së për periudhën 5-vjeçare dhe rekomadimet për përmirësimin e gjendjes;
- Të planifikohen dhe përcaktohen afatet, aktivitetet dhe projektet që do të ndërmerren për adresimin e prioritetëve të identifikuar si dhe indikatorët përkatës për monitorimin e zbatimit të planit dhe autoritetet përgjegjëse për zbatimin e tyre.

1.3 Procesi dhe metodologjia e hartimit të PLVM-së

Në kuadër të aktiviteteve për hartimin e këtij plani, Komuna e Deçanit , ka ndërmarrë këto veprime: Kryetari i Komunës së Deçanit ka miratuar **Vendim për hartimin e PLVM-së**, me qëllim që të koordinojë aktivitetet për hartimin dhe miratimin e tij. Sipas Vendimit bartës të aktivitetit gjatë procesit të hartimit të PLVM-së është caktuar Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit. Drejtoria në fjalë ka hartuar një plan dinamik për mbledhjen e të dhënave dhe koordinimin e aktiviteteve për hartimin e planit. Metodologjia e hartimit të planit dhe përcaktimit të prioritetëve të tij është orientuar duke u bazuar në:

- **Identifikimin e problemeve kryesore** në mjedisin e komunës së Deçanit që vijnë nga sektorët e ndryshëm zhvillimorë bazuar në të dhënat ekzistuese dhe trendet e tyre.
- **Analizën dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese** të mjedisit në Komunën e Deçanit ku është bërë prezantimi i gjendjes aktuale mjedisore bazuar në të dhënat në dispozicion. Në kuadër të analizës së gjendjes është prezantuar gjendja e komponenteve mjedisore. Kjo analizë shërben për të pasur një ide më të qartë të problemeve mjedisore që ka komuna dhe ndikimeve në mjedis nga sektorët e ndryshëm.
- **Identifikimi i problemeve kryesore mjedisore** të cilat do të trajtohen për zgjidhje në kuadër të PLVM-së, duke marrë për bazë kapacitetet financiare dhe zhvillimore të komunës dhe mundësitë e zgjidhjes së tyre.

- Duke u bazuar në këto probleme mjedisore janë **përcaktuar prioritetet mjedisore për periudhën 5-vjeçare** dhe janë grupuar ato sipas tematikave përkatëse mjedisore.
- Bazuar në prioritetet kryesore mjedisore është propozuar edhe **plani i veprimeve për përmbushjen e këtyre prioritetëve**, që do t'i shërbejnë komunës për të hartuar projektet konkrete të mbështetura nga buxheti i komunës, apo nga sigurimi i fondeve nga donatorët.
- Për të siguruar një implementim më efikas të PLVM-së është propozuar **Plani i monitorimit për zbatimin** e tij, ku janë përcaktuar edhe treguesit përkatës të monitorimit sipas prioritetëve.

1.4 Procesi i hartimit të PLVM-së 2023-2028 - punëtorit dhe debati publik

Në kuadër të aktiviteteve për hartimin e këtij plani, Asambleja Komunale ka marrë vendim për hartim e planit, më datë 06.06.2022 me nr. të protokollit 01/18581. Kryetari i Komunës z. Bashkim Ramosaj, me qëllim që t'i koordinojë aktivitetet për hartimin dhe miratimin e këtij planit, formuan grupin e punës dhe ka hartuar një plan të përbashkët dinamik për mbledhjen e të dhënave dhe koordinimin e aktiviteteve për hartimin e planit deri në miratim.

Në kuadër të këtij plani, janë mbajtur gjashtë puntori, një debat publik dhe konsultime deri në finalizimin e dokumentit për miratim në Asamblenë Komunale. Puntoritë dhe debati publik të organizuara janë:

- Shkollën e Mesme të Lartë “Vëllezërit Frashëri”
- Shkollën e Mesme Teknike “Tafil Kasumaj”
- QKMF “Adem Ukëhaxhaj”
- Ndërmarrja Publike Lokale “Hixhiena”
- Anëtarët e Asamblesë Komunale
- Banorët e fshatit Rastavicë dhe
- Një debat publik

Foto 1: Puntoria në SHML “Vëllezërit Frashëri”, Deçan më datë 07 dhjetor 2022



Foto 2: Puntoria ne SHML “Tafil Kasuma”, Deçan, më datë 08 dhjetor 2022



Foto 3: Puntoria në fshatin Rastavicë, më datë 09 dhjetor 2022



Foto 4: Puntoria më anëtarët e Asamblesë Komunale, më datë 13 dhjetor 2022



Foto 5: Puntoria më anëtarët e Asamblesë Komunale, më datë 27 dhjetor 2022



Foto 6: Debat i publik, më datë 23 dhjetor 2022



Nga puntoritë dhe debati publik janë dhënë propozime dhe rekomandime të cilat janë përfshirë me referenca në PLVM-në:

- Trotuari përgjatë qendrës deri të hyrja e gjimnazit gjatë periudhës së hyrjes dhe daljes² në orarin e mësimi të jenë të lira për lëvizjen e nxënësve;
- Të mbështeten dhe përkrahen aktiviteti i nxënësve për hapjen e ekspozitës së punimeve me materiale të ricikluar;
- Të mbillen dhe fidanë (peme-brezi mbrojtës) përgjatë trotuareve, bunari i fushës në Carrabreg deri të Ura e Dëmës në Deçan;
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e vijës së Hazeraj dhe Përroit të Ukaj i cili takohet së bashku tek rruga për në Podin e Gështenjës, të mirëmbahet dhe pastrohet sepse përgjatë reshjeve bashkohen dhe nuk menaxhohet me rrjedhën e ujit;
- Kontejnerët në qendër të zhvendosen në ndonjë vend dhe të mos jenë të ekspozuar nga të gjithë qytetarët përgjatë kalimit nëpër qendër;
- Të sigurohet hapësirë për parkingje publike³;
- Rreziku nga linja e tensionit të lartë që kalon përgjatë parkut të gjimnazit dhe parashihet si rrezik shoqëror, gjegjësisht nxënësit, të cilët i shfrytëzojnë këto hapësira (parku i shkollës) dhe
- Shqetësimi tjetër ishin edhe qentë endacakë.⁴

Foto 7: Debat i publik, më datë 23 dhjetor 2022



Punëtorja me anëtarët e Asamblesë Komunale për draft-Planin Lokal të Veprimit në Mjedis, 2022-2027, më datë 27.12.2022 në ora 10.00 – 11.00, i cili është aprovuar në leximin e parë nga Asambleja Komunale në mbledhjen e IX-të, të rregullt të datës: 30.11.2022.

Draft-Plani Lokal i Veprimit në Mjedis, 2022-2027, është dokument i politikës mjedisore lokale, që paraqet prioritetet mjedisore dhe listën e veprimeve për zgjidhjen e tyre, ku

² Nxënësit SHML "Vëllezërit Frashëri". Deçan

³ Nxënësit e SHMT "Tafil Kasumaj", Deçan

⁴ Hamid Qorraj-Drejtor i SHML "Vëllezërit Frashëri". Deçan

pjesëmarrësit e kësaj punëtorie i dhanë plotësim nga Mon Selmonaj, Miftar Ahmetxhekaj, Arjan Dobraj, të cilët janë përfshirë në planin e lartpërmendur. Propozimet nga Arjan Dobraj-anëtar i Asmablesë Komunale.

- Plotësimi i ndriçimit publik në fshatin Gramaçel si dhe rehabilitimi i rrjetit energjetik pasi në disa pjesë të fshatit ende është sistemi i vjetër dhe paraqet rrezik për jetën e banorëve.
- Ndërtimi i kanaleve të ujitjes, projekt me rëndësi jetike për fshatin Gramaçel dhe fshatin Jasiq i Ri.
- Shporta për mbeturina përgjatë rrugës kryesore në fshatrat Gramaçel dhe Jasiq i Ri
- Pastrimi dhe rregullimi i lumit të fshatit Jasiq i Ri e deri në hyrje të fshatit Dujakë, me gjatësi afërsisht 1400 m.
- Këndi i lojërave për fëmijë në fshatin Gramaçel (pasi që si lokacion gjendet si më në qendër të disa fshatrave përreth, ku gjendet shkolla, ambulanca, restorante, etj.) dhe si rrjedhojë është më shumë i frekuentuar
- Kënd i lojërave për fshatin Isniq ⁵

Rekomandimet nga puntoria e QKMF-së “Adem Ukëhaxhaj”, Ndërmarrjes Publike Lokale “Hixhiena”, SHMT “Tafil Kasumaj”, fshati Rastavicë dhe debatit publik janë përfshirë plan. Lokal i Veprimit në Mjedis 2023-2028, ku paraqesin prioritetet mjedisore dhe listën e veprimeve për zgjidhjen e tyre me projekt propozime dhe kosto financiare. Plani Lokal i Veprimit në mjedis ka për qëllim, të zgjidhë problemet mjedisore nëpërmjet identifikimit të prioritetëve dhe përcaktimit të veprimeve për zgjidhjen e tyre, janë përfshirë të gjitha propozimet nga aktorët e mundshëm në planin e veprimit dhe planin për monitorim dhe zbatim të PLVM-së 2023-2028, ku propozimet nga puntorit dhe debati publik janë prezentuar në formë tabelare.

Foto 8: Puntoria në Ndërmarrjen Publike Lokale “Hixhiena”, më datë 13 dhjetor 2022



⁵ Miftar Ahmetxhekaj- Anëtar i Asamblesë Komunale

Foto 9: Puntoria në QKMF“Adem Ukëhaxhaj”, më datë 16 dhjetor 2022



Foto 10. Klubi i biçiklistëve të Deçanit



Akteret dhe përgjegjësitë e PLVM-së:

Anëtarët e Trupit Koordinues:

1. Bashkim Ramosaj - Kryetar i Komunës
2. Hajdar Sutaj - Kryesues i Kuvendit (Asamblesë)
3. Rame Meli - Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
4. Ajne Iberhysaj - Koordinatore e PLVM-së
5. Jashar Dobraj - Drejtor i Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme

Anëtarët e grupit punues:

1. Ajne Iberhysaj- Inspektore për Mbrojtje të Mjedisit
2. Antigone Dabiqaj- zyrtare për zhvillim të projekteve
3. Edona Kameraj- Zyrtare për Informim
4. Ajshe Qorraj- Zyrtare e lartë për planifikim
5. Dyke Lolluni – Zyrtare ligjore e kuvendit
6. Lulavere Qorraj-Anëtare e Asamblesë Komunale
7. Hyse Dinaj- Zyrtare e lartë për ndërtim
8. Agron Demukaj- Zyrtar për buxhet
9. Hasan Gjikokaj- Mjekë -QMFK
10. Riza Kasumaj- Zyrtar për planifikim urban
11. Enver Cacaj- zyrtar ligjor
12. Lendim Kuqi- Zyrtar për buxhet
13. Riza Gjikokaj – Zyrtar për Informim
14. Shkelzen Hadergjonaj- Klubi i biçiklistëve të Deçanit
15. Veton Shala- Zyrtar- fotografë
16. Mujë Kadrija- Inspektor i tregut
17. Monë Selmonaj- Anëtar i Asamblesë Komunale
18. Faton Selmonaj- Anëtar i Asamblesë Komunale
19. Miftar Ahmetxhekaj- Anëtar i Asamblesë Komunale
20. Arjan Dobraj- Anëtar i Asamblesë Komunale
21. Hamid Qorraj – Drejtor i Gjimnazit “Vëllezërit Frashëri”, Deçan
22. Lan Stojkaj- Drejtor Teknikës “Tafil Kasumaj”, Deçan
23. Pranvera Pajazitaj – Zyrtare e Komunës
24. OJQ SHIP Adem Lushaj
25. Xheladin Malaj – Shef i Urbanizmit dhe PH
26. Shkelzen Shehu- Udhëheqës i sektorit për Urbanizëm
27. Kushtim Loshaj – Drejtor i Ndërmarrjes Lokale Publike “Higjiena”
28. Shkelzen Goçi – Zyrtar i lartë i ndërtimeve të ulëta
29. Mirjeta Bozhdaraj-Hidiq- zyrtare për planifikim
30. Selmon Berisha Drejtor i QKMF “Adem Ukëhaxhaj”
31. Isuf Demhasaj – Drejtori për Ekonomi dhe Zhvillim
32. Petrit Januzaj KRU “Ujësjiellësi “– Deçan
33. Blerta Qosaj – Zyrtare për legalizim
34. Lirije Zukaj – Zyrtare ligjore
35. Rifat Stojkaj Drejtori i Bujqësisë, Pylltarisë, Zhvillimit Rural
36. Bajram Çeku- Shef për Bujqësi
37. Besnik Hulaj – Drejtor për Arsimit
38. Jetmir Avdijaj- zyrtar i gjeodezisë
39. OJQ “Bjeshktare alpiniste” Jeton Berisha

2. Profili i Komunës

2.1. Pozita gjeografike dhe organizimi administrativ

Deçani, apo Ulza e dikurshme, është vend i banuar që nga kohërat më të lashta antike, ku ishte pjese e Dardanisë Ilire. Territori i sotëm i Deçanit, ishte i banuar nga fiset Ilire, gjegjësisht fisi Dardan. Kosova në kohën antike quhej Dardani.

Gjurmët e autoktonisë dhe të pranisë së Dardanëve edhe në trevën e komunës së Deçanit, sikurse edhe në trevat e tjera të Kosovës, janë etnografike, kulturore, historike, toponimike, topografike, arkeologjike dhe antropologjike. Këtë e dëshmojnë edhe një varg dokumentesh arkivore austriake dhe turke. Edhe sot e kësaj dite, në Komunën e Deçanit më rrethinë ekzistojnë gjurmët e mbi shtatë kishave katolike ilire dhe të përmendoreve tjera, siç është Veku i Kaurreshës, pastaj gjurmët e *Tumave ilire*, materialet dekorative nga stolitë deri tek stolitë e tjera.

Shënimet e para të shkruara, në të cilat përmendët Deçani janë në krisobulën e vitit 1330. Në vitin 1330 pjesë e Deçanit me rrethinë ishin 40 fshatra me 2432 shtëpi. Kopja e Krisobulës së Deçanit është gjetur në shekullin XIX, e cila padrejtësisht ruhet në Arkivin e Serbisë. Objekt i rëndësishëm monumental dhe fetar është manastiri i Deçanit, ky manastir është vepër që ruan elemente të stilit të ndërtimit perëndimor (Shqiptaro-Dalmate). Në arkitrarin e portalit jugor të narteksit gjendet një mbishkrim i gdhenduri i arkitektit shqiptar dom Vita Kuçi. Është ruajtur e dhëna se dom Vita Kuçi me 30 gurskalitës ndërtoi manastirin e Deçanit. Ky manastir është ndërtuar në themelet e një kisha të vjetër ilire (paleokristiane). Në kohën e sundimit osman, kjo trevë ishte në kuadër të Sanxhakut të Dukagjinit me qendër në Pejë.

Treva e Deçanit, sikurse edhe e tërë Kosovës, ishte nën sundimin Osman. Mirëpo, ajo i bëri përherë qëndresa atij sundimi, duke organizuar forma të ndryshme të rezistencës, sidomos gjatë shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX. Vlen të përmendim këtu Lidhjen shqiptare të Prizrenit më 1878, pastaj Besa kombëtare të Verrat e Llukës si dhe Lidhjen e Pejës.

Më fillimin e luftës së Parë Botërore, nga fundi i vitit 1915, në këto treva u vu pushteti dhe administrata Austro-Hungareze, e cila zgjati deri në vitin 1918. Më ripushtimin e kësaj treve nga pushteti serbo-malazias në vitin 1918, u vendos organizimi territorial, sikurse në viset e tjera të pushtuara. Deçani në atë kohë ishte në kuadër të Rrethit të Pejës dhe Rrethit të Gjakovës.

Me ndryshimet administrative, territoriale, në vitin 1929, treva e komunës së Deçanit ishte në kuadër të Banovinës së Zetës. Në kohën e Luftës së Dytë Botërore, treva e Deçanit ishte në kuadër të zonës italiane deri në vitin 1943, e pas kapitullimit italian ishte nën sundimin gjerman.

Në fund të vitit 1959 suprimohen rrethet dhe forcohet sistemi komunal. Komuna e Deçanit formohet si komunë më vete, e cila deri në vitin 1963 quhet Këshilli Popullor i Komunës, ndërsa prej vitit 1963 me ndryshimet kushtetuese, quhet Kuvendi i Komunës së Deçanit. Më 1974 Kosova fitoi elementin konstituiv në Federatën Jugosllave.

Në vitin 1989 u bë suprimimi i organeve të Kuvendit të Komunës së Deçanit. U vendos administrata e dhunshme serbe. Mirëpo, në anën tjetër, popullata shqiptare u organizua dhe formoi organet paralele. Edhe Deçani funksionoi si organ paralel në kuadër të Republikës së Kosovës. Pas përfundimit të luftës së armatosur me pushtetin serb që ndodhi në Kosovë më 1998 dhe 1999, Kosova u vu nën administrimin e Kombeve të Bashkuara, u bë konstituimi i

organeve Komunale dhe të tjera. Komuna e Deçanit u krijua si njësi territoriale- administrative në pajtim me dispozitat e Rregullores për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës, nr. 2000/45. Ku më 17 shkurt 2008 shpallet Pavarësia e Kosovës dhe fillon nje atape e re e zhvillimit.

2. 2 Pozita dhe karakteristikat gjeografike

Komuna e Deçanit ka një pozitë mjaftë të mirë gjeografike. Ndodhet në pjesën Perëndimore të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit.

Gjendët pothuajse në qendër të Ballkanit, në vijën ajrore nga Deti Adriatik më gjatësi 90 km, kurse 220 km gjatësi nga Deti Egje.

Në Perëndim kufizohet më Republikën e Shqipërisë që shtrihet prej PT-1660 deri PT-2366 në gjatësi prej 13850 m.

Në Veri-Perëndim kufizohet me Malin e Zi PT-2366 deri 2424 me gjatësi 9750 m.

Në Veri kufizohet me Komunën e Pejës PT-2424 deri 460 [Maznik] me gjatësi prej 50550m.

Në Jug-Lindje dhe Jug kufizohet me Komunën e Gjakovës dhe Junikut nga PT-460 deri PT-1660 [Rajoni i gjerë i Rrasës së Koshares].

Komuna e Deçanit shtrihet në një sipërfaqe prej 293,948,468.50 m² ose 293,94 km² dhe përfshinë 136 banorë për km²

- 5504.53 sipërfaqe e shfrytëzuar e tokës bujqësore/sipërfaqe ha
- 4302.07 tokë e punueshme /arë sipërfaqe ha
- 198.6 ha kopshte ha
- 1873 livadhe ha
- 150.4 tokë bujqësore e papërdorur sipërfaqe ha
- 15995.4 tokë pyjore sipërfaqe ha-park kombëtar Bjeshket e Nemura ha
- 790.7 Zona e vecantë e mbrojtur rreth manastirit të Deçanit ha
- 378.6 tokë jo bujqësore sipërfaqe ha
- 200.75 tokë e degraduar (depone, ndërtime) sipërfaqe ha

Komuna e Deçanit ka një qendër administrative dhe 38 fshatra. Qyteti i Deçanit nga kryeqyteti (Prishtina) ka një largësi prej 90 km.

Në këtë hapësirë jetojnë rreth 40,019 banorë, sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011.

Lartësia mbidetare varion nga 412 lartësi mbidetare në fshatin Maznik deri në 2530 m lartësi mbidetare në majën e Marjashit. Në sajë të krijimit të relievit Komuna e Deçanit ndahet në dy pjesë:

- Në Ultësirë që është pjesë e rrafshit të Dukagjinit;
- Dhe në Lartësi që përfshin masivin e Bjeshkëve të Nemuna (Alpet shqiptare)

Rrafshi i Dukagjinit është krijuar në periudhën gjeografike – Neogjen. Nga lëvizjet tektonike krijohet një liqen që përfshinë tërë Rrafshin e Dukagjinit. Nga mesi i Laçerit, niveli i ujit të liqenit fillon të ulet dhe më vonë, fillon të tërhiqet përmes luginës së Drinit të Bardhë.

Bjeshkët e Nemuna, apo Alpet shqiptare, shtrihen në pjesën Perëndimore të Komunës së Deçanit, që i takon nga sipërfaqja e përgjithshme e parkut, ka përfshirje me këtë sipërfaqe prej 16,786 ha, apo 27% nga territori i Bjeshkeve të Nëmuna.

Lartësitë e Bjeshkëve të Nemuna pak ndryshojnë nga lartësia e vargmaleve alpine. Këto janë pjesët më të larta dhe më shkëmbore të vargmaleve të siujdhesës Ballkanike. Me ç'rast shkëmbinjtë e bardhë dhe të dhëmbëzuar formojnë pamje imponante. Nga masivi i Bjeshkëve të Nemuna, në komunën e Deçanit mund të veçojmë këto maja më të larta me lartësi mbi detare:

- Maja e Rupës 2501 m
- Maja e Qenit 2406 m
- Maja e Strellcit 2377 m
- Maja e Marjashit 2530 m

2.3 Karakteristikat klimatike

Deçani ka klimë kontinentale me ndikim të klimës mediterane. Gjatë vitit në Deçan ka 1975 orë me diell. Viset e ulëta të Deçanit karakterizohen me temperatura relativisht të larta me vlerë mesatare vjetore më tepër se 11° C, me muajt më të nxehtë gushtin dhe korrikun 21.7° C dhe 21.68° C dhe me muajin më të ftohtë janarin – 0.5°C.

Lagështia mesatare e ajrit gjatë vitit është 70.2 % në të cilin rast rritja është dukshëm më e madhe prej verës nga dimri për 17.5% se sa zvogëlimi prej dimrit në drejtim të verës.

Në këtë rajon vranësirat mesatare vjetore janë 58% gjatë së cilës frekuenca e ditëve të kthjellëta është 60.5 (16.6%) në vit, ndërsa e ditëve pa diell 119,3 ditë (32.6%). Zgjatja mesatare vjetore e zënies së diellit për shkak të ndikimeve orografike është më e vogël se sa mesatarja për Kosovë dhe është 1972 orë, nga e cila në Korrik 293,6 orë, ose 72.1% diell në vit.

Sasitë e të reshurave në këtë rajon janë ndër më të mëdhatë në Kosovë. Në viset e ulëta është 724,6 lit/m², në viset malore të Bjeshkëve të Nemuna sasitë mesatare të të reshurave arrijnë më tepër se 1.300 lit/m².

Era, shpejtësia mestare e erës gjatë vitit është 16 m/s, ndërsa ajo maksimale arrin deri më 26,5 m/s. Më së shumti fryn era nga veriu dhe veriperëndimi;

Trashësia e borës në viset kodrinore-malore, gjatë dimrit arrinë deri më 50 cm, në viset më të larta (bjeshkë) edhe mbi 1m, kurse në lartësitë e mëdha malore (alpine) qëndron gjatë tërë vitit.

Shi bie më së shumti në pranverë dhe vjeshtë edhe atë mesatartisht 900-1500 mm. Elementet kryesore që i përkasin komunës janë: moti i kthjellët, lartësia e lartë mbidetare e bjeshkeve të Deçanit, temperatura të freskëta gjatë verës dhe mjaft të ftohta gjatë dimrit, reshjet atmosferike me sasi të bollshme të ujërave. Kushtet e këtyra klimatike mundësojnë zhvillimin e aktiviteteve rekreative gjatë gjithë vitit e sidomos ato sportive (skijimit) gjatë sezonës së dimrit.

2.4 Pedologjia dhe kushtet gjeologjike

Përbërja pedologjike: Sipas përbërjes pedologjike, tokat në territorin e komunës së Deçanit janë të përfaqësuar si në vijim:


- Tokë pseudoglej - 9066,44 ha
- Tokë e kuqërremtë - 5590 ha
- Tokë aluviale - 5305.82 ha
- Tokë ranker - 5170 ha
- Tokë e murme në shtresat kompakte - 2160.2 ha
- Tokë e kuqe - 678.79 ha
- Tokë deluviale - 636.81 ha
- Tokë e livadheve - 632.58 ha
- Tokë litosole - 156.38 ha

Gjeologjia: Sa i përket përbërjes gjeologjike⁶, territori i komunës së Deçanit në masë të madhe është i ndërtuar nga gurët ranor, filit, rreshpe klorite, konglomerat, çert dhe gurë gelqëror 5082.73 ha, sedimente liqenore dhe lumore 4215.46 ha, shkëmbinj metagranitikë (shkëmbinjë kataklastikë skistozë) -3196.01 ha, terracë lumore-3115.68 ha, ortoskist (epidot, aktinolit dhe shist klorit) -2717.83 ha etj **Tabela 2: Përbërjës gjeologjike:**

Përbërja gjeologjike	Sip/ha	Përbërja gjeologjike	Sip/ha
Aluvium	2868	Metadiabaza	117
Fushë gurore	311	Metagabro	3
Deluvium	98	Shkëmbinj metagranitikë (shkëmbinjë kataklastikë skistozë)	3196
Diabazë, spilit, basalt	19	Ortoskist (Epidot, aktinolit dhe shist klorit)	2718
Sedimenti glacial (morenë)	718	Proluvium	894
Granit	35	Gëlqere e kuqe dolomit cefalopod	190
Sedimenti liqenor dhe lumor	4215	Terracë lumore	3116
Gëlqëror, dolomit	446	Rërë, argjilë, zhavorr, pjesërisht tufit linjit	583
Gëlqëror, dolomit, breccia	429	Gur ranor, filit, reshpe klorite, konglomerat, çert, gur gëlqëror	5083
Sedimenti limno-glacial	537	Serpentin	152
Mermer, gëlqere e rikristalizuar	1171	Seri sedimentarësh vullkanike	47

⁶ Vlerësimi Strategjik Mjedisor 2020-2028

Harta 1-Komuna e Deçanit në Republikën e Kosovës



3. Demografia dhe zhvillimi demografik

3.1. Dendësia- Shtimi natyror i popullsisë

Popullsia me tërë kompleksitetin e saj është një faktor kyç për planifikimin e zhvillimeve të ardhme.

Bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, dendësia e popullsisë në komunën e Deçanit është rreth 136 banorë në 1 km², që është nën mesataren në nivel vendi prej 165 banorë në 1 km². Në disa vendbanime që kanë numër më të madh të popullsisë edhe dendësia është shumë më e lartë dhe e kundërta në vendbanimet që kanë numër të vogël të popullsisë edhe dendësia është shumë më e vogël.

Që nga viti 1981 deri në vitin 2011, në Kosovë nuk kishte regjistrim të popullsisë.

Tabela Nr. 3 - Të dhënat nga Regjistrimet e popullsisë në periudhat 1948 – 2011 për komunën e Deçanit


Viti	Ekonomitë Familjare		Popullsia		Madhësia e Familjes (Numri i antarëve në Ekonomi Familjare)	
	Komuna	Qyteti (Vendbanimi Deçan)	Komuna	Qyteti (Vendbanimi Deçan)	Komuna	Qyteti (Vendbanimi Deçan)
1948	23	188	17840	1205	7.6	6.4
1953	2	226	19223	1339	7.8	5.9
1961	2	327	22230	1829	7.7	5.6
1971	3	431	27478	2585	8.4	6.0
1981	4	519	35577	3280	8.8	6.3
1991 ¹	50	721	42898	4440	8.5	6.1
2011 ²	58	602	40019	3803	6.8	6.3

Në tabelë prezantohen të dhënat në nivel të komunës dhe qytetit për numrin e ekonomive familjare, popullsinë dhe numrin mesatar të antarëve në ekonomitë familjare për të gjitha periudhat e Regjistrimit, 1948 – 2011.

Numri i popullsisë në qytetin e Deçanit nga viti 1948 deri në vitin 2011 ka shënuar një rritje të konsiderueshme me 2598 banorë. Pra, në bazë të kësaj rritje, brenda periudhës kohore 63 vjeçare, del se mesatarisht popullsia ka shënuar rritje prej rreth 41 banorë në vit në qytetin e Deçanit.

1. Të dhënat për vitin 1991 janë të vlerësuara nga Enti Federativ i Statistikës në Beograd. Kosova në vitin 1991 nuk ka marrë pjesë në Regjistrim të popullsisë.
2. Në vitin 2011 duke u bazuar në metodologjinë e Regjistrimit, për herë të parë janë regjistruar vetëm banorët rezident të cilët jetojnë në Deçan, me tepër se një vit, apo ata të cilët mendojnë të jetojnë me tepër se një vit.

Grafiku Nr. 2 -Popullsia e Komunës së Deçanit përgjatë viteve: 1948-2011



3.2 Shtimi natyror i popullsisë



Të dhënat e shtimit natyror për vitin 2021 janë vlerësuar duke i shfrytëzuar të dhënat për lindjet dhe vdekjet nga Agjencia e Statistikës së Kosovës për vitin 2021 për komunën e Deçanit.

Për vitin 2021 është vlerësuar se në komunën e Deçanit jetojnë 42,480 banorë

Gjatë vitit 2021 në komunën e Deçanit janë shënuar 554 lindje dhe 279 vdekje. Bazuar në këto të dhëna është llogaritur shkalla e shtimit natyror për vitin 2021 është 275, gjithsej popullsia dhe shtimi natyror për 31 dhjetor 2021 është 42.755.

Nëse i analizojmë të dhënat për numrin e popullsisë për komunën e Deçanit prej vitit 1948–2011 del se numri i popullsisë ka rritje për 22,179 banorë.

Sipas moshës: Mosha e re 0-14 vjeç merr pjesë me 26.2% në popullsinë e Deçanit, ndërsa grupmoshat 15-64 që është popullsi aktive (e aftë për punë) merr pjesë me 66.4%, kurse mosha 65 vjeç e më tepër kanë pjesëmarrje të vogël me rreth 7.4% të popullsisë së përgjithshme. Në përgjithësi grup moshat e popullsisë 15-64 vjeç dominojnë në popullatën e përgjithshme.

Sipas gjinisë: në grup moshat 15-19 vjeç, raporti meshkuj/femra është 50.3% / 49.7% femra, derisa në grup moshat 30-44 vjeçare dhe 50 e më shumë vjeç dominon gjinia femrore.

Gjatë vlerësimit të popullsisë për komunën e Deçanit në vitin 2028 është marrë për bazë komponenti themelor që ndikon drejtpërdrejtë në rritjen demografike siç është shtimi natyror.

Sipas të dhënave të vlerësuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës për periudhën 2011 deri 2028 del se në komunën e Deçanit për çdo vite kemi shtim natyror të popullsisë prej 225 banorë. Në fund të vitit **2021** komuna e Deçanit kishte **42,755** banorë ⁷. Si rezultat përlllogaritja e rritjes së popullsisë për vitin 2028, popullata e komunës së Deçanit do të jetë rreth **44,126 banorë**.

4. Vizioni

4.1. Deçani qytet ekologjik dhe destinacion turistik

Deçani i vlerave të trashëgimisë me kushte të favorshme natyrore e kulturore për zhvillimin e turizmit, bujqësisë, po ashtu vend i pasur me shumë bimë mjekuese, me peisazhe të bjeshkeve të Deçanit si destinacion tërheqës turistikë për të gjithë në Republikën e Kosovës dhe rajonit.

Vizioni për të ardhmen e Komunës së Deçanit është vazhdimësi e qëllimeve të përcaktuar në Planin Hapësinor të Kosovës dhe Planin Komunal Zhvillimor të bazuar në begatitë natyrore dhe pozitën gjeografike e gjithë kjo ndërlidhet me një zhvillimin të qendrueshëm, duke e bërë Deçanin, qendër logjistike rajonale për turizëm me potencial të traditës kulturore, bujqësore, blegtorale, bletare dhe gastronomisë tradicionale. Për të realizuar këtë vizion është e nevojshme që zhvillimi ekonomik në përgjithësi dhe turizmit në veçanti, është i bazuar në ruajtjen, mbrojtjen dhe rehabilitimi i monumenteve të trashëgimisë kulturore dhe historike, si dhe rritja e atraksionit për investitorët e jashtëm dhe të brendshëm përmes përgatitjes së ofertës lokale zhvillimore- turisitike.

⁷ ASK-ë; Vlerësimi i Popullsisë së Kosovës 2021, Prishtinë, qershor 2022

Qëllimet:

- Krijimi i kushteve të favorshme për zbatimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM)
- Promovimi i vlerave mjedisore dhe atraktive, zhvillimi ekonomik i bazuar zhvillim të qendrueshëm dhe rigjenerim të vendeve të punës nga sektori i turizmit.
- Ruatja dhe mbrojtja e vlerave mjedisore, natyrore, kulturore dhe ofrimi i kushteve për një zhvillim të qëndrueshëm për nevojat e komunitetit dhe qytetarëve në tërësi.
- Mbrojtja e cilësisë së ujërave sipërfaqësore nga veprimet degraduese dhe fatkeqësitë natyrore
- Ruajtja, mbrojtja dhe rehabilitimi i monumenteve të trashëgimisë kulturore dhe historike.
- Rritja e atraksionit për investitorët e jashtëm dhe të brendshëm, përmes përgatitjes së ofertës lokale zhvillimore - turistike.
- Bashkëpunim ndërkufitar për zhvillime me interes të përbashkët në fushën e mbrojtjes së mjedisit, manifestimeve tradicionale dhe projekteve të përbashkëta turistike ndërkufitare.
- Krijimi i kushteve për monitorimin e cilësisë së ajrit dhe zvogëlim i ndikimit mjedisor negativ nga ndotësit e ajrit.
- Planifikimit të shtimit të hapësirave të gjelbra në përgjithësi e në veçanti në të gjitha hapësirat ekzistuese publike.
- Vetëdijësimi i popullatës për rëndësinë e mjedisit dhe kushteve mjedisore në kualitetin e jetës.

Synimet:

- Ulja e shkallës së ndotjes nga mbeturinat dhe kompostimi i tyre,
- Hartimi i planit të mobilitetit dhe promovimi dhe nxitja e ecjes dhe çiklizmit
- Zhvillimi hapësinor i balancuar dhe ruajtja e tokës bujqësore.
- Shtrirja e kanalizimit në pjesën rurale dhe ndërtimi i impiantëve
- Ruajtja, kultivimi, promovimi i trashëgimisë kulturore
- Shfrytëzimi sa më racional i resurseve natyrore në mënyrë që ato të jenë të mjaftueshme edhe për gjeneratat e ardhshme.
- Hartimi planeve dhe zbatimi i tyre për zonat e rrezikuara, ose ndikuara nga vërshimet, erozioni.
- Rregullimi i shtretërve të lumejeve dhe rritja e sipërfaqeve rregulluese të gjelbërta,
- Investime në ndërtimin e pendave dhe kanaleve të ujitjes dhe mirëmbatja e tyre,
- Ngritjes së vetëdijës së popullatës për rritjen e ndjesisë së qytetarisë aktive dhe të qenit kontribues në mbrojtjen e mjedisit me synim ruatjes të së mirës publike, rritjes së mirëqenies sociale.
- Promovimi i ekoturizmit dhe turizmit të qëndrueshëm me synim për ruatjen e mjedisit dhe jetës së egër ku gjenden specie të rrezikuara qoftë të florës dhe faunës.

Prioritetet strategjike:

- Ofrimi i infrastrukturës së domosdoshme për krijimin e kushteve për investime në zhvillimin ekonomik e në veçanti në turizëm.
- Përfshirja e të gjitha vendbanimeve në shërbime dhe infrastrukturë publike (zgjerimi i hapësirave gjelbëruese)
- Shtirja e rrjetit të kanalizmit në pjesën rurale dhe trajtimi i ujerave te zeza (impiante)
- Rregullimi dhe zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbëra në pjesën urbane dhe rurale,
- Planifikimi dhe ndërtimi, sigurimi infrastrukturës për zonat e indentifikuara si potenciale turistike në Bjeshkët e Deçanit,
- Planifikimi dhe ndërtimi i shtigjeve për biçiklista që lidh objektet e trashëgimisë kulturore,
- Përgatitja e guidave turistike dhe bashkëkordinim me vendet e rajonit etj.

5. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese

5.1. Analiza mjedisore

Gjendja e mjedisit paraqet situatën e treguesve të komponentëve kryesorë të mjedisit si: toka, uji, ajri dhe biodiversiteti etj. Në komunën e Deçanit, si pasojë e aktiviteteve të ushtruara nga faktori njeri, ka ndikime në mjedise ku veprimtaria e vazhdueshme e njeriut ka sjellë ndikim në këta komponentë, duke ndryshuar gjendjen e tyre në: fondi pyjor, tokën bujqësore, hapësira gjelbëruese rregulluese, ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga ujërat e ndotura-zeza, përdorimi pa kriterë i preparateve bujqësore.

Qëllimi kryesor i kësaj analize mjedisore është informimi për gjendjen e mjedisit në Komunën e Deçanit, me qëllim që të dhënat e prezantuara të shërbejnë për hartimin e politikave të përshtatshme mjedisore dhe për orientimin e zhvillimeve, planifikimeve dhe investimeve strategjike në sektorët të ndryshëm, cilët kanë ndikim në mjedis, siç janë: ekonomia, industria e lehtë, energjetika, transporti, bujqësia etj.

Gjendja e Lumëbardhit të Deçanit dhe Lumëbardhit të Lloqanit, nuk është aq keq nga mbeturinat, por kërkohet rregullim, ndërtim dhe mirëmbajtje të vazhdueshme të tyre. Përgjatë rrjedhjes së lumejve po ashtu shfaqen dukuritë e erozionit dhe vërshimet, duke ndikuar negativisht në degradimin e tokave bujqësore. Duhet të thkesohet se përgjatë rrjedhjes së Lumëbardhit të Lloqanit, dëme e shkatuara në reshjet atmosferike të shirave sezonale në pranverë dhe vjeshtë shkakton dëme të mëdha në fshatin Rastavicë, Baballoqa dhe Gramaqel. dëmet e shkatuara nga reshjet përgjatë shtratit në të dy anët e lumit Lloqan nga erozioni kanë dëmtuar sistemin rrënjor të masës drunore, të cilat kanë shërbyer si masë mbrojtëse e tokave bujqësore me theks të veçantë të lokacioni i quajtur “ Arat e Pukës”⁸, pastaj te ura e fshatit duke rrezikuar në masë të madhe edhe rrugën me gjatësi prej 120 m. Rregullimi dhe ndërtimi i

⁸ Mon Selmonaj- Anëtar i Asamblesë Komunale

shtratit të Lumëbardhit të Lloqanit duhet të jetë prioritet nga Komuna dhe Qeveria më qëllim të përmirësimit të dëmeve të shkatuara nga dukuritë e vërshimeve dhe erozionit. Infrastruktura: kanalizimi i ujërave të zeza, mbeturinat inerte (lokacioni të jenë dy, apo tri lokacione) që lehtësojnë më afër me i dergu mbeturinat inerte, ndriçimi i rrugëve të fshatit.⁹

Burim kryesor në ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore në komunën tonë janë mungesa e sistemit të kanalizimit për ujërat e ndotura (zeza), në disa fshatra, apo shumicën e pjesës rurale. Në gjithë pjesën rurale aty ku mungon sistemi i kanalizimit, ujërat e ndotura grumbullohen në gropat septike, ose derdhen në sipërfaqe të hapur duke shkaktuar ndotje të komponenteve mjedisore. Kanalizimi për ujërat e ndotura në pjesën urbane ka përfunduar, në të përveç Deçanit janë të kyçura edhe këto fshatra: Carrabregu i Epërm, Carrabregu i Ultë, Belegu, Llukë e Epërm, Llukë e Ultë dhe Lumbardhi, kanalizim kanë fshati Rastovicë, Pobergjë, Dranoc ku mungojnë koletoret (impianetet).

Sistemi i administrimit të mbeturinave bëhet në të gjithë fshatrat e komunës. Mbulueshmëria me shërbimet për grumbullim të mbeturinave përfshihen rreth 90% e popullatës e komunës ku qasje në shërbimet publike të grumbullimit të mbeturinave kanë nga Ndërmarrja Publike Lokale “Higjiena”. Gjenerimi i mbeturinave shtëpiake sipas të dhënave të fundit, sillet prej 0.30 kg/banor/ditë. Tarifa për mbeturina është 4.65 Euro/familje dhe shkalla e inkasimit sillet afërsisht 75 %. Gjithsej në komunë¹⁰ kanë qenë gjithsej 22 deponi ilegale prej të cilave 19 deponi janë pastruar dhe rehabilituar, ndërsa janë edhe dy deponi ilegale që duhet pastruar.

Komuna nuk ka një lokacion të caktuar për mbeturina inerte. Rregullimi i deponisë lokale për mbeturina inerte (ndërtimet dhe prishjet), do të mundësojë menaxhim më të mirë të mbeturinave inerte, do të ketë ndikim të madh pozitiv mjedisor dhe në shëndetin publik. Nuk ka trajtim për mbeturinat e rrezikshme, insinerator për djegien e mbeturinave spitalore (qendrave të mjekësisë familjare). Në komunën e Deçanit ka filluar të bëhet kompostimi i mbeturinave organike.

Ajri - Cilësia e ajrit në Komunën e Deçanit monitorohet përmes matjeve sistematike të rrjetit të stacioneve monitoruese që menaxhohet nga AMMK/IHMK stacioni i ajrit të vendosur në Pejë. Procesi i identifikimit të burimeve të ndotjes të emisioneve në ajër, në komunën e Deçanit tregon se emetimet më të mëdha për PM10 dhe PM 2.5 vijnë nga sektori i djegieve të vogla ekonomitë familjare. Emetimet më të mëdha për NOx vijnë nga sektori transporti. Emetimet vjetore të gazrave serrë në Kosovë janë vlerësuar të jenë rreth 9613 Gg (Giga gram) CO2 eq, (equivalent), ose rreth 9.6 milion ton CO2 eq ku si burimi kryesor i emetimeve të gazrave serrë në komunën e Deçanit, ashtu si në përgjithësi është sektori i bujqësisë, pylltarisë kurse në sasi të vogël paraqesin kurse ndotja nga deponit ilegale është në përmasa shumë të vogla. Komuna e Deçanit ka përfshirë në politikat e saj prioritet mbrojtjen e mjedisit – “Deçani ekologjik”

Uji - Cilësia e ujërave sipërfaqësore në Kosovë, vazhdon të jetë e ndikuar nga ndotja që vjen si rezultat i shkarkimeve të ujërave të ndotura (zeza). Përdorimi i pesticideve dhe fertilizerëve në bujqësi. Deçani ende nuk e ka të zhvilluar sistemin e trajtimit të ujërave të ndotura si dhe ndërtimit të impianteve për trajtimin e ujërave të zeza.

Toka: Sipërfaqja tokësore e Komunës së Deçanit shtrihet në një sipërfaqe prej 293,948,468.50 m² ose 293,94 km² dhe përfshinë 136 banorë për km²

⁹ Mon Selmonaj - propozimet për fshatin Rastavicë në puntorinë e datës 27.12.2022

¹⁰ Bazuar në Raportin Vlerësimit të Deponive Ilegale, Drejtoria për Mbrojtje Shpëtim dhe Shërbime Publike, qershor 2020

- 5504.53 sipërfaqe e shfrytëzuar e tokës bujqësore/sipërfaqe ha
- 4302.07 tokë e punueshme /arë sipërfaqe ha
- 198.6 ha kopshte ha
- 1873 livadhe ha
- 150.4 tokë bujqësore e pa përdorur sipërfaqe ha
- 15995.4 tokë pyjore sipërfaqe ha-park kombëtar Bjeshket e Nemura ha
- 790.7 Zona e veçantë e mbrojtur rreth manastirit të Deçanit ha
- 378.6 tokë jo bujqësore sipërfaqe ha
- 200.75 tokë e degraduar (depone, ndërtime) sipërfaqe ha

Problemet themelore mjedisore në problematikën e tokave në Komunën e Deçanit kanë të bëjnë me:

- humbjet e përhershme, ose të përkohshme, të fondit tokësor (çdo vit humbin rreth 15-25 ha tokë pune) e shkaktuar nga ndërtimet, erozioni dhe faktorë të tjerë.
- mungesën e strategjisë së menaxhimit dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të pasurive natyrore.
- mungesën e monitorimit të cilësisë së tokave dhe ndjekjes ligjore të degraduesve të fondeve tokësore bujqësore.

Biodiversiteti: Komuna e Deçanit karakterizohet me një biodiversitet dhe trashëgimi natyrore. Në bazë të hulumtimeve të deritashme janë të inventarizuara në Bjeshkët e Nemuna ku llogaritet se ekzistojnë në bjeshkët e Deçanit: 8 lloje peshqish, 13 lloje ujëtokësorësh, 12 lloje rrëshqitësish, 154 lloje shpendësh, 37 lloje gjitarësh dhe 147 lloje fluturash ditore.

Ndikimet negative kryesisht rezultojnë me prerjet dhe dëmtimin e pyjeve, shkatërrimi i vlerave kryesore, pastërtrimi sanitar në pjesët më të degradura të tyre etj. Mungojnë investimet në mbrojtjen, planet rregulluese dhe përparimin e zonave të mbrojtura. Vetëdija e vizitorëve dhe e popullatës së zonave të mbrojtura ende është e ulët për ruajtjen e tyre dhe shndërrimin e tyre në interes lokal si një burim ekonomik të mundshëm në drejtim të zvogëlimit të varfërisë.

Bujqësia: Komuna e Deçanit, ka resurse të konsiderueshme që mundësojnë zhvillimin e bujqësisë, gjithashtu ka fonde të konsiderueshme edhe të tokës bujqësore. Bazuar në Strategjinë Zhvillimore Lokale 2015-2020. Infrastruktura bujqësisë në Komunën e Deçanit është në zhvillim e sipër, ku kërkohet të bëhet mbështetje financiare projekteve në sitemin e ujitjes.

Problemet kryesore në sektorin e bujqësisë janë:

- kontrolli i pamjaftueshëm i cilësisë së produkteve bujqësore të prodhuara në vend dhe të importuara,
- përdorimi jo i duhur i plehrave dhe pesticideve,
- ndotja nga mbeturinat e kafshëve të therura, të ngordhura etj.
- mungesa e trajtimit të plehrave të fermave të mëdha dhe të mesme blegtorale, mungesa e subvencioneve dhe produkteve ekologjike.

5.2. Pasuritë natyrore

5.3 Mineralet

Komuna e Deçanit, ka potencial të madh për zhvillimin ekonomik duke u bazuar në resurset humane me popullsi me moshë të re, që premtan shumë në të ardhmen, gjithashtu pozita gjeografike si dhe trashëgimia natyrore me: pyjet, toka bujqësore, lumenjtë, rërë dhe zhavorr, minerale, flora dhe fauna, sasia e mineralit të mermerit, trashëgimia kulturore dhe ajo shpirtërore: objektet arkitektonike, kullat, objektet fetare dhe objektet e trashëgimisë kulturore, kultivimin e argo-industrisë, tregtisë dhe turizmit me shtrirje dhe lidhje ndërkufitare, duke përfshirë edhe evenimentet tradicionale të cilat do të ndikonin në zhvillimin ekonomik lokal me synim zvogëlimin e papunësisë dhe përmirësimin e mirëqenies sociale.

Materialet ndërtimore, shkëmbinjtë e fortë silikatë në komunën e Deçanit ekziston një sasi të shkëmbinjve të fortë silikatë, në pjesën e Bjeshkëve të Deçanit që kanë mundësi të përdoren në ndërtimtari. Deri më tani, shkëmbinjtë e fortë silikatë janë hulumtuar dhe shfrytëzuar rrallë dhe për shkak të cilësisë së tyre të lartë ata mund të bëhen burim i rëndësishëm i mineraleve ndërtimore në të ardhmen. Shfrytëzimi kryesor i mundshëm i shkëmbinjve të fortë silikatë, si lëndë e parë ndërtimore, është prodhimi i agregatëve si dhe perspektiva e shfrytëzimit si gurë dekorativë dhe dimensionalë. Vendburimet e shkëmbinjve të fortë silikatë me vlera të larta gjenden kryesisht në pjesët veriore, verilindore dhe lindore të Deçanit. Në bazë të rezultateve të Planit të Guroreve të Kosovës (PGK), rekomandohet intensifikimi i hulumtimeve gjeologjike. Shkëmbinjtë e fortë karbonatikë. Janë hulumtuar dhe verifikuar rezerva të konsiderueshme të gëlqerorëve, të cilët përdoren si materiale gjeologjike në ndërtimtari dhe industri.

Mermeri dhe gëlqerorët e mermerizuar gjenden kryesisht në sasi konsiderueshme në komunën tonë. Ato përdoren si gurë dekorativë. Paraqitjet e mermerit në komunën tonë paraqitet në formë mermerit brekçiozë në pjesën e Uzbilit në Grykën e Deçanit, i cili mund të përdoret si gurë dekorativë dhe dimensionalë.

Në Komunën e Deçanit janë të pranishme vetëm tri paraqitje të dolomitëve dhe analizat e pakta të hulumturara kanë dhënë vlera të MgO (Oksidi i Magnezit) deri në 16%. Kështu, ata janë të klasifikuar si gëlqerorë dolomitikë. Dolomitët si të tilla gjenden në Grykën e Deçanit, Grykën e Lloqanit dhe Bjeshkët e Deçanit. Vendburimet e travertinit janë të kufizuara në burimin e ujit mineral afër apo Gushavcit, i cili ka cilësi të mira kurative – shëndetësore.

Rëra dhe zhavorri në Komunën e Deçanit ka përbërje minerale dhe kokrrizore të përshtatshme, gjë që është e përshtatshme si lëndë e parë për prodhimin e betonit. Rezervat e rërës dhe zhavorrit në Komunën e Deçanit janë të koncentruara në shtretërit e lumenjve të Lumbardhit të Deçanit dhe Lloqanit, dhe për shkak të aktivitetëve të shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit, ka pjesë të peizazhit të këtyre lumenjve janë dëmtuar. Vlerësohet që resurse totale të rërës dhe zhavorrit janë rreth 3310 m³. Bazuar në faktin se ndikimet mjedisore gjatë procesit të shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit janë të dukshme dhe qasja e kufizuar për shkak të destinimeve të tjera të tokës ku shtrihen këto vendburime, kjo veprimtari rezulton të jetë e papspektivë dhe duhet bërë zëvendësimi i operimeve të tilla në favor të shfrytëzimit të shkëmbinjve të fortë silikatë dhe karbonatikë.

Megjithatë, meqenëse shtresimet dhe depozitimet e rërës dhe zhavorreve në shtretërit e lumenjve janë të ripërtitshëm (prurjet vjetore të lumenjve), çështja e lejimit të shfrytëzimit të kufizuar duhet të shtrohet pas një elaborimi më të detajuar, profesional nga institucionet relevante.

Gurët dekorativë dhe dimensionalë të mermerit në Komunën e Deçanit deri më tani nuk janë bërë hulumtimet edhe ato hulumtime që janë bërë janë hulumtime të pakta dhe kërkohen hulumtime e kërkime gjeologjike të tjera. Gjeo-databaza e Kosovës (GDK) përmban të dhëna për mbi 116 lokacione të gurëve dimensionalë dhe dekorativë. Përshtatshmëria për gurë dekorativë dhe dimensionalë ende nuk është hulumtuar. Nuk ekzistojnë të dhëna mbi blloqet e përshtatshme për shfrytëzim dhe sasinë e tyre dhe për humbjet gjatë shfrytëzimit. Nevojiten hulumtime të hollësishme teknike dhe petrografike, si dhe zgjerimi i bazës së të dhënave mbi rezervat/ resurset.

5.4 Pyjet

Ndër pasuritë natyrore të Deçanit, pyjet zënë vend me rëndësi dhe kanë vlerë të çmueshme. Përveç rëndësisë ekonomike, pyjet kanë rëndësi dhe ndikim të madh edhe në funksionin natyror mbrojtës: klimë, ajër, ujë, tokë, konservim të trashëgimisë biologjike dhe funksionin social-kultural, siç janë: turizmi, rekreacioni dhe shumë funksione të tjera. Sipërfaqet pyjore në Komunën e Deçanit, janë si vijon: sipërfaqja e përgjithshme 16,786.1 ha. Nga sipërfaqja e përgjithshme Komunës së Deçanit, pyjet bëjnë pjesë rreth 36 % të sipërfaqes, rritja vjetore është 92,691 m³, kualiteti i masës drunore është i nivelit të lartë ku 70 %, është dru teknik i cili përdoret për përpunimin e mëtejshëm në industrinë e drurit. Pyjet shtrihen në lartësi të larta mbidetare, ku pika më e lartë në Parkun Kombëtar të Bjeshkëve të Nemura është Gjeravica 2656 m, ndërsa në Bjeshkët e Deçanit është pika më e lartë në Marjash 2530 m/lmd ku pika më e ulët mbidetare është në Podin e Gështenjave. Pyjet janë burim kryesorë për prodhimin e biomasës tokësore, furnizuesi kryesorë me oksigjen, ruajnë tokën nga erozioni, erërat etj. Pjesa më e madhe e pyjeve të Komunës së Deçanit, është në pronësi publike, në viset e ulëta dominojnë pyjet e dushkut të cilat dita ditës po degradohen në mënyra të ndryshme, ndërsa në viset malore me të larta janë pyjet e pastra të ahut dhe halorëve (pishave) të ndryshme. Pyjet e Deçanit, janë jashtëzakonisht atraktive dhe ideale për vizitë turistike dhe për një pushim malor. Për menaxhim të suksesshëm të resurseve pyjore duhet të ndërmerren masa:

- Ri-pyllëzimi i sipërfaqeve të degraduara, sidomos ato sipërfaqe që janë shkatërruar nga zjarri.
- Nga shfrytëzimi në mënyrë të pakontrolluar nga personat e papërgjegjshëm.

Pyjet e Komunës së Deçanit, kanë ndikim të madh në natyrë nëpërmjet procesit të fotosintezës, fletët dhe halat e drurëve CO₂ (dyoksidi i karbonit) atmosferik konvertohet në karbon të ngurtë të depozituara në biomasë. Biomasa pyjore për prodhimin e energjisë përfshin drutë e zjarrit, mbetet që rezultojnë nga procesi i shfrytëzimit (maja, degë, lëvore) dhe mbetet e procesit të përpunimit industrial të drurit si tallash, ashkla etj. Harmonizimi i kërkesës dhe ofertës për dru zjarri dhe lëndë punimi ka qenë dhe mbetet një sfidë për ekonominë pyjore ndër vite.

Problemet kryesore të evidentuara në menaxhimin e pyjeve janë:

- Rritja vjetore është 92,691 m³, kualiteti i masës drunore është i nivelit të lartë ku 70 % është dru teknik, i cili përdoret për përpunimin e mëtejshëm në industri.
- Një nga qëllimet kryesore duhet të jetë zhvillimi i fondit pyjor, përmes:

- Pyllëzimit të sipërfaqeve të zhveshura;
- Shndërrimit gradual të shkurreve në pyje të rregulluara;
- Shndërrimi gradual (natyror, artificial) të pyjeve të ulta në të mesme dhe në të larta dhe;
 - Kultivimi intensiv të pyjeve të larta të ruajtura.

Asgjësimi dhe degradimi i pyjeve është parakusht i parë i paraqitjes së ndryshimeve të padëshiruara në natyrë, gjë që negativisht manifestohet në kushtet e jetesës, ekonomizimit, madje edhe në interesin e përgjegjshëm të popullatës. Pyjet duhet të qeverisen në bazë të planeve pyjore-ekonomike. Prerja e pyjeve duhet të silltet në kufij të lejueshëm/përkatës, të cilët do të sigurojnë drejtpeshimin në mes të rritjes së masës drunore, respektivisht, të sigurojnë drejtpeshimin në mes të rritjes dhe prerjes. Përveç kësaj, nevojitet që vazhdimisht dhe sistematikisht të ndërmerren masa në punët kultivuese-pyjore për përtëritjen dhe ruajtjen e tyre. Kujdesi ndaj pyjeve dhe përdorimi racional i pyjeve janë bazë për zhvillimin afatgjatë të pylltarisë. Të bëhet pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura ku është e mevojshme.

REKOMANDIME:

- Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura

5.5 BUJQËSIA

Komuna e Deçanit shtrihet në një sipërfaqe prej 293,948,468.50 m² ose 293,94 km² dhe përfshinë 136 banorë për km²

- 5504.53 sipërfaqe e shfrytëzuar e tokës bujqësore/sipërfaqe ha
- 4302.07 tokë e punueshme /arë sipërfaqe ha
- 198.6 kopshte ha
- 1873 livadhe ha

Bujqësia, si dege e rëndësishme e ekonomisë, ka një rendësi të madhe për Komunën e Deçanit. Deçani shtrihet në një sipërfaqe prej 293,948,468.50 m² ose 293,94 km² dhe përfshin 136 banorë për km²

- 5504.53 sipërfaqe e shfrytëzuar e tokës bujqësore/sipërfaqe ha
- 4302.07 tokë e punueshme /arë sipërfaqe ha
- 198.6 kopshte ha
- 1873 livadhe ha
- 150.4 tokë bujqësore e pa përdorur sipërfaqe ha
- 15995.4 tokë pyjore sipërfaqe ha-park kombëtar bjeshket e Nemura
- 790.7 Zona e vecantë e mbrojtur rreth manastirit të Deçanit ha
- 378.6 tokë jo bujqësore sipërfaqe ha
- 200.75 tokë e degraduar (depone, ndërtime) sipërfaqe ha

Nga aspekti gjeografik, zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë shtrihet në gjithë pjesën rurale të komunes së Deçanit. Pjesa kodrinore-malore përfshin pyjet dhe kullotat alpine në zonën e Bjeshkëve të Deçanit. Ekzistojnë kushte specifike të cilat favorizojnë bujqësinë e kësaj Komune për prodhimin e kulturave bujqësore të kualitetit të lartë. Prodhimtaria bujqësore është e orientuar në: prodhimtarinë bimore, blegtorale, shpezëtari dhe bletari. Me bujqësi merret një

numër i konsiderueshëm i popullsisë së Komunës së Deçanit, rreth 55 % dhe prej saj një pjesë e madhe e popullsisë siguron ekzistencën e tyre. Në bazë të kushteve agroekologjike, nga agrikultura mund të arrihen edhe rendimente të kënaqshme dhe cilësore, si të kulturave lavërtaria, ashtu edhe prodhimeve blegtorale. Edhe pse ekzistojnë kushte të volitshme natyrore, zhvillimi dhe prodhimi i produkteve vendore të natyrës ushqimore janë të ulëta dhe shumica prej tyre vijnë nga importi, si: miell, qumësht, peme, perime, vaji, mishi, faroret etj. Komuna e Deçanit ka përparësi të mëdha për zhvillimin e bujqësisë, duke filluar nga: Kushtet agroekologjike mjaft të favorshme, resurset natyrore, toka, pasuritë ujore (lumenjtë) etj. Fuqia punëtore, me përvojë dhe të kualifikuar; shitja e produkteve të brendshme, si dhe mundësia për eksport. Krahas përparësive që ekzistojnë ka vështirësi në zhvillimin e bujqësisë:

- Sipërfaqja e tokës është mjaft e kufizuar-fragmentuar (mesatarisht 0.25 ha për koke banori), me tendencë të zvogëlimit e cila ul mundësinë e konkurrimit dhe;

- Mungon subvencionimi i prodhimit të bujqësorë.

Sipërfaqja e përgjithshme /ha e shfrytëzuar e tokës bujqësore/sipërfaqe ha është: 5504.53 ha, ndërsa tokë e punueshme /arë sipërfaqe ha lërueshme është 4302.70 ha. Kulturat kryesore janë: misri, gruri, pemët dhe perimet. Sipas mënyrës së shfrytëzimit me të mbjella mund të thuhet se kulturat e lavërtarisë kultivohen në sipërfaqe më të mëdha ndërsa, kulturat industriale fare pak kultivohen si: duhani, panxhari, kolza, luledielli.

Kopshtet në Komunën e Deçanit zënë një sipërfaqe prej afro 198.6 ha. Me përmishte dikur kanë qene të përfshira rreth mbi 1000 ha, të sipërfaqes së tokës së punueshme, ndërsa tani kjo sipërfaqe në formë plantacionesh llogaritet afërsisht vetëm 790 ha, nga sipërfaqja e dikurshme e përmishteve.

Sipërfaqja e tokës është e kufizuar, si dhe dita-ditës po zvogëlohen nga ndërtimet e egra. Në Komunën e Deçanit prioritet duhet dhënë: zhvillimit të blegtorisë, prodhimit të perimeve, kultivimit të pemëve të ndryshme etj.

Infrastruktura ujitjes në zonat bujqësore është e nivelit të ulët. Kanë nevojë për përmirësimin dhe veprimin urgjent në rregullimin e kanaleve dhe vijave të ujitjes, si dhe në ndërtimin e një ujëmbledhësit në Grykën e Lloqanit, që do të ujiteshin rreth 4000 ha tokë punuese, do të ketë furnizim me ujë të pijshëm për disa fshatra.

5.6 Sipërfaqet bujqësore dhe kualiteti i tyre

Komuna e Deçanit disponon me 12,028.6 ha tokë bujqësore (sipërfaqe e shfrytëzuar e tokës bujqësore/sipërfaqe ha, tokë e punueshme /arë sipërfaqe ha, kopshte ha, livadhe ha dhe tokë bujqësore e pa përdorur sipërfaqe ha) që përfshinë 60 % të sipërfaqes së tërësishme të komunës së Deçanit (293,94 km²).

Kjo sipërfaqe bujqësore në bazë të kualitetit të tokës e shprehur në përqindje është si vijon:

Nga kjo sipërfaqe 11,168.47 ha janë në pronësi private dhe 860.13 ha janë në pronë shoqërore me të cilën menaxhon Agjencia Pyjore e Kosovës. Në zonat rurale jetojnë rreth 74.19% e popullsisë së tërësishme të komunës së Deçanit.

Bujqësia është veprimtari kyç në këtë trevë nga e cila sigurojnë të ardhura mbi 65% të banorëve të komunës së Deçanit.

Ekzistojnë kushte specifike që e favorizojnë bujqësinë dhe prodhimin e rendimenteve të

kualitetit të lartë. Prodhimtaria bujqësore është orientuar në: prodhimtarinë bimore, prodhimtarinë blegtorale, shpendari, bletari dhe peshkim.

Punonjësit që merren me veprimtari bujqësore në shkallën më të madhe janë me arsim të mesëm, por të kualifikimeve të ndryshme. Në zhvillimin e bujqësisë kontribuojnë edhe ekspertët dhe teknikët e bujqësisë, ku në këtë komunë janë mbi 45 agronomë të diplomuar dhe afër 200 teknikë të bujqësisë, të cilët ndihmojnë me këshilla profesionale dhe punë të drejtpërdrejtë.

Nevojitet riaktivizimi i kooperativave ekzistuese në bazë të procesit të ri mbi organizimin e kooperativave, ngritja e serave për perimekultura, plantacioneve (për dredhëza, lajthi mjedra, kumbulla, molla), ngritja e minifermave (qumështore, për viça për majmëri, për mështjerra për riprodhim, të deleve, dhi), ngritja e fermave të pulave, ngritja e parkut të bletëve për sezonin e gështenjës, ullinjve, të peshkut etj.

5.7 Kultivimi i kulturave bujqësore

Në komunën e Deçanit, nga sipërfaqja e tërësishme bujqësore prej 12,028.6 ha. Kulturat kryesore bujqësore që kultivohen në këtë komunë janë: misri, gruri, perimet, pemët, patatja etj., ndërsa dominon më së shumti kultura e misrit dhe perimekultura.

Prodhimi vjetor i kulturave bujqësore sipas viteve (2017-2019) është si vijon: Kulturat bujqësore, sipërfaqet e mbjella, rendimenti për ha dhe prodhimi vjetor.

Tabela Nr. 1-Prodhimi vjetor i kulturave bujqësore në komunën e Deçanit:

Kulturat	2017			2018			2019		
	Sipërf (ha)	Rend/ha/t	Prodh. Vjetor /t	Sipërf ha	Rend/ha/t	Prodh. Vjetor/ t	Sipërf.(h)	Rend/ha/t	Prodh. Vjetor/t
Grurë	900	3,5	2800	900	3.7	3.330	600	3.8	2280
Elb birre	100	2,2	110	100	2.7	405	20	2.2	44
Misër Hybri	950	7,5	5850	950	8	7.360	1625	9	14625
Misër autokton	1700	4,0	6800	1680	4.3	7.224	1191	4.5	5359
Patate	450	15	5250	370	15	5.550	300	30	9000
Perimekultura	1100			1460			1600		
Bimë foragjere	150			150			480		
Livadhe natyrale	5871			5171			4845		
Pemishte	830			750			890		
Fruta të imëta	924.68		500	924		560	924		580
Totali :	12,975.6			11551			11551		

Sipërfaqet e tokës bujqësore me kultura intensive kanë rritje në sipërfaqe dhe në rendiment e normalisht edhe në prodhimin vjetor.

Te kultura e grurit ka rritje të rendimentit me përjashtim të këtij viti, sepse thatësia që mbizotëroi vitin e fundit ndikoi në rendimentin e të gjitha kulturave lavërtarie. Sipërfaqet me misër, poashtu kanë rritje të dukshme dhe kryesisht vërehet rritje e sipërfaqeve të kultivuara me misër të hibrideve të ndryshme dhe ulje e sipërfaqeve të kultivuara me misër autokton.

Kulturat perimore për çdo vit janë në shtim e sipër në sipërfaqe tek fermerët. Bimët foragjere kanë gjithashtu rritje në sipërfaqe, ndërsa livadhet natyrale po zvogëlohen duke u rritur livadhet artificiale.

Në Komunën e Deçanit nuk ka pika grumbulluese, as përpunuese të prodhimeve bujqësore, kështu që fermerët janë të detyruar që tepricën e prodhimeve të tyre ta tregtojnë në tregjet e tjera të Kosovës.

Në zonat bujqësore gjithashtu infrastruktura është e nivelit të ulët, ku rrjeti rrugor dhe ai i ujitjes janë shumë të shkatërruar.

5.8 Prodhimtaria blegtorale

Në Komunën e Deçanit dominojnë kullosat natyrale me 1873 ha fondi blegtoral dhe struktura blegtorale është si në tabelën vijuese:

Tabela Nr. 2-Numri i kafshëve dhe shpezëve shtëpiake gjatë periudhës 2016-2019 në Komunën e Deçanit:

Fondi i kafshëve dhe shpendëve	2016	2017	2018	2019
Lopë Qumështore	5.640 krerë	6.340 krerë	Reth 8.000	14.000 krerë
Viça	2.420 “	3.000 “	” 3.600	5.500
Dele	3.366 “	3.800 “	“ 4.000	4.000
Qengja	1.700 “	2.000 “	“ 2.000	2.300
Kuaj	868 “	1.000 “	“ 1.100	460
Derra	30 “	70 “	“ 120	480
Pula	26.700 copë	30.000 copë	“ 35.000 copë	40.000
Bletë	960 shoqëri	1.328 shoqëri	1.600 shoqëri	3.000

Gjatë viteve në vijim numri i kafshëve dhe shpendëve është në rritje të dukshme. Kryesisht ka rritje të lopëve qumështore. Delet janë në rritje jo të kënaqshme për arsye se nuk janë importuar raca të deleve. Numri i shoqërive të bletëve është në rritje të dukshme. Janë dhënë donacioneve për shtimin e shoqërive të bletëve në Kosovë.

Zhvillimii blegtorisë zhvillohet në pjesën e rrafshulëtave, por edhe në pjesën kodrinore malore duke shfrytëzuar sipërfaqet e konsiderueshme të kullotave dhe livadheve për prodhimin ekologjik të prodhimeve blegtorale.

Përpunimi i produkteve blegtorale në Komunën tonë është me metodat te vjetra dhe bëhet vetëm në ekonomitë familjare (nuk kemi fabrika për përpunimin e produkteve blegtorale), ndërsa shitja e këtyre produkteve bëhet pa ndonjë organizim të veçantë.

Për sipërfaqe bujqësore të kultivuara në Komunën e Deçanit përdorimi i pesticideve është pothuajse i kufizuar, por megjithatë, gjen përdorim në perimekultura dhe pemishte, ndërsa përdorimi i plehërave kimike pothuajse përdoret në disa sipërfaqe bujqësore dhe ato me doza mesatare 300-500 kg/ha, varësisht nga kultura bujqësore. Sipas të dhënave nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nuk ka ndotje të mjedisit nga përdorimi intensiv i tepëruar të pesticideve (herbicideve, fungicideve, insekticideve) etj. Në të ardhmen bujqit duhet që të informohen më shumë për eko-bujqësinë, për llojet e reja të pemëve, perimeve etj., gjegjësisht bujqit të motivohen, që të prodhojnë, prodhime ekologjike nëpërmes menaxhimit të integruar të dëmtuesve (IPM-MID). Informim i pamjaftueshëm për eko-bujqësinë, ose bujqësinë organike.

Në përgjithësi bagëtia mbahet për prodhimin e produkteve të tyre. Përpunimi i produkteve blegtorale bëhet ende me metoda të vjetra dhe ajo bëhet vetëm në ekonomitë familjare që do të thotë se nuk ka fabrika për përpunimin e produkteve blegtorale, ndërsa shitja e këtyre produkteve bëhet pa ndonjë organizim të veçantë. Nevojat e Komunës së Deçanit plotësohen me produkte blegtorale afër 60 %. Ojëktivat për një zhvillim të qëndrueshëm të blegtorisë janë¹¹:

- Shtimi i fermave të mesme dhe të mëdha
- Raca produktive në prodhimtari të lartë të qumështit
- Përmirësim racor në mish dhe qumësht
- Krijimi i vendeve të reja të punës
- Punësim familjar dhe përmirësim i të ardhurave buxhetore nga ferma
- Zvogëlim i importit të produkteve blegtorale: mishit dhe produkteve qumështore etj.

5.9 Prodhimtaria perimore

Për Komunën tonë rendësi ekonomike ka edhe ngritja e serave për kultivimin e perimeve. Për këtë qëllim sipërfaqet e rrafshta duhet të destinohen për ngritjen e serave, duke pasur parasysh edhe kushtet e favorshme që krijon rrjedha e Lumëbardhit të Deçanit dhe Lumëbardhit të Lloqanit, ku toka është më cilësore, si edhe afërsia me tregun-konsumatorin. Hapësirat e përshtatshme për kultivimin e perimeve ekzistojnë në fshatrat: Isniq, Prejlep, Rastovic, Irzniq, Gllloqan, Baballoq, Gramacel, kurse në Ratish, Maznik, Pobergje, Vokshe, Dranoc, për kultivimin pemëve të imta etj. Rritja e kultivarëve të rinj dhe zgjerimi i asortimenteve, të llojeve dhe kultivarëve të ndryshëm që sjellin përfitime më të mëdha ekonomike, si dhe ngritja e kapaciteteve për konservimin dhe përpunimin e perimeve në afërsi të qendrave prodhuese, janë të nevojshme.

¹¹ Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

5.10 Zhvillimi i pemëtarisë

Hapësirat e duhura për ngritjen e plantacioneve ekzistojnë në pjesën bregore që shtrihen në: Deçan, Irzniq, Rastovice, Beleg, Pobergje, Voksh etj. Per zgjerimin e pemishteve duhet të realizohen edhe këto masa: Stimulimi i fermerëve për ngritjen e pemishteve, sigurimi i fidanëve cilësorë me potencial të lartë prodhues dhe rezistencë nga sëmundjet e ndryshme, të organizohen trajnime me fermerët për ngritjen dhe menaxhimin e pemishteve, zgjerimi i sistemit të ujitjes, ngritjen e depove bashkëkohore për ruajtjen e pemëve dhe përpunimin e tyre. Hapësirë e përshtatshme për ngritjen e pemishteve ekzistojnë hapësirat e ish-kooperativave bujqësore në fshatin Rastovice.

REKOMANDIME:

- Ngritja e serave për perime;
- Të riorganizohen trajnime për bletarët e rinj;
- Ngritja e plantacioneve: me dredhëza, manaferra, lajthi, mjedra, kumbulla, mollë, boronica etj.;
- Ngritja e mini-fermave qumështore, viçave për majmëri, mështjerrave për riprodhim, deleve etj.;
- Ngritja e fermave për pula dhe brojler;
- Ngritja e parkut të bletarisë dhe shtimi i numrit të shoqërive të bletëve etj.;
- Rregullimi i sistemeve të ujitjes (në serra preferohet ujitje me pika);
- Rritja e aftësive konkurruese përmes ngritjes së cilësisë dhe produktivitetit;
- Shtimi i numrit të kafshëve të imta (deleve dhe dhive).
- Informimi dhe trajnimi i fermerëve nëpërmjet shërbimeve këshilluese të Kosovës.
- Ndërtimi i pikave grumbulluese për kulturat e ndryshme bujqësore dhe pyjore
- Përpilimi i kadastrës së tokave bujqësore;
- Mbrojtja e tokave bujqësore nga ndërtimet e egra;
- Zgjerimi i qytetit të racionalizohet me ndërtime të larta-banime kolektive;
- Të bëhet komasacioni, apo rregullimi i tokave,
- Rregullimi i infrastrukturës nëpër zona rurale do t'i kontribuonte zhvillimit të bujqësisë, pengimit të migrimit të popullsisë fshat-qytet

6. BURIMET UJORE

Territori i Komunës së Deçanit shtrihet në pellgun e dy lumenjve, të cilët burojnë në masivin e “Bjeshkëve të Nemuna”, të cilët kanë burime të shumta të ujit. Të gjithë lumenjtë, që përshkojnë territorin e Komunës së Deçanit burojnë në lartësinë e “Bjeshkëve të Nemuna”, të cilat derdhen në Drinin e Bardhë, që është ujëmbledhës dhe derdhen në Detin Adriatik. Lumenjtë që burojnë dhe përshkojnë territorin e Komunës janë:

6.1 Lumëbardhi i Deçanit

Më gjatësi 40,5 km buron në Bjeshkën e Roshkodolit në vendin e quajtur, Tëdel i Lumëbardhit në lartësi 2130 m. Pellgu i tij përshkon fshatrat: Deçan, Isniq, Llukë e Epër dhe Llukë e Poshtëm, Lumbardhë dhe Broliq, fushat e të cilave i ujit, si dhe furnizon me ujë liqenin akumulues të Radoniqit. Shtrati Lumëbardhit të Deçanit është duke u rregulluar nga pjesa të livadhet Mushkuloj në afërsi të Manastirit të Deçanit e deri në fshatin Lumbardhë me gjerësi prej 50 metrash në të dy anët e lumit. Ky rregullim i lumit në të dy anët e lumit, që do të marrin funksionin edhe me shëtitoreve.

6.2 Lumëbardhi i Lloqanit



Më gjatësi 23,7 km që buron nga shpatet e Kurvallës, Dervishë-Komit dhe të Stanishtës së Zogut në lartësi mbi detare 2100 m. Pellgu i Lloqanit përshkon fshatrat Hulaj, Lloqan, Carrabreg i Epër, Prejlep, Rastovicë, Baballoq, Gramaqel. Ky lumë përveç që ujit fushat e këtyre fshatrave, uji i tij përdoret për ujitje të fushave edhe të shumë fshatrave të tjera si: Pobërgjë, Voksh, Sllup, Dranoc etj. Shtrati dhe brigjet lumit janë pjesërisht të rregulluara. Në lumenjtë që përshkojnë

territorin Komunës sonë, në ta ekzistojnë kushte shumë të volitshme për kultivimin dhe rritjen e peshkut dhe ndërtimin restoranteve dhe hoteleve që do të kishte efekt shumë pozitiv socio-ekonomik dhe turistik. Potenciali ujqor i “Bjeshkëve të Nemuna”, në masë të madhe është i grumbulluar nëpër rezervuare, prej nga distribuohet si ujë i pijshëm nëpër ujësjellës të vendbanimeve dhe shfrytëzohet nga qytetarët për pije. Pjesën tjetër popullata e shfrytëzon për ujitje të sipërfaqeve bujqësore. Mirëpo, shtretërit e lumenjve janë të parregulluar që periodikisht vërshojnë tokat bujqësore dhe dëmtojnë mbulesën vegjetative. Pellgjet e tyre janë të ekspozuara proceseve erozive dhe vërshuese.

Territorin e Komunës së Deçanit e përshkojnë edhe një numër i konsiderueshëm i përrenjve dhe përrockave si: Përroi Durakut, i Strellcit, Përroi i Behovcit, Prrojet e Vokshit, Përroi i Glllogjanit, Përroi i Lëbushës dhe Përroi i Ratishit. Në lartësinë e bjeshkëve ekziston një numër madh i liqeneve me origjinë glaciale të njohur në gjuhën popullore si “sytë e maleve”. Këta liqene janë burimet kryesore të vlerave mjedisore, turistike dhe ekonomike për Komunën tonë. Liqenet natyrorë që gjenden në masivin e “Bjeshkëve të Nemuna” paraqesin habitat për interes të veçantë për zhvillimin e turizmit, por nuk janë aq shumë të hulumtua.

6.3 Uji mineral- i thartë (Gushavcit)

Burimi i ujit mineral është një ndër produktet më të rëndësishme turistike që ka Deçani. Kjo pasuri i ofron mundësi Komunës së Deçanit, për ngritjen e infrastrukturës për kurim të sëmundjeve ngjitëse, sëmundjeve të lëkurës, sëmundjeve të eshtrave etj. Burimi mineral është

në masivin gëlqeror, në pjesën e majtë të lumit. Është burim i tipit karstik. Uji, nga këta gurë gëlqerorë, del nga disa çarje dhe plasa në sipërfaqen e tokës dhe një pjesë në aluvionet e lumit. Kapaciteti i burimit mineral, sipas një pompimi testues, vërtetoi se me këtë sasi të prurjes së ujit mineral: $Q=16$ l/s, 180 m, më poshtë nuk kishte rrjedhje të ujit, ndërsa në metrin 175 m, rrjedhja e ujit ishte $Q=1,4$ l/s. Mbi metrin 170 m, rritet kapaciteti në $Q= 5,6$ l/s, në metrin e 80 m, $Q= 7,0$ l/s dhe mbi 31 m, prurja e ujit ishte $Q= 16$ l/s. Ky burim derdhet në një bazen të krijuar nga vetë banorët e Deçanit, në mënyrë që të shfrytëzohet për nevojat e tyre, edhe pse kushtet e këtij bazeni nuk janë shumë të mira për t'u përdorur si duhet. Papajtueshmëria me Manastirin e Deçanit, i cili po pengon, që në këtë vend të investohet dhe të krijohen kushte më të mira për shfrytëzimin e këtij burimi. Edhe pse në këto kushte jo të mira, ky vend vizitohet shumë jo vetëm nga banorët e Deçanit, por edhe nga mbarë Rrafshi i Dukagjinit, pasi siç e kemi cekur më lart, ky ujë ka veti shëruese, si për sëmundjet e lëkurës, ashtu edhe për shumë sëmundje të eshtrave, duke përfshirë edhe problemet reumatike etj.

7. EKONOMIA

Komuna e Deçanit, ka një potencial mjaft të mirë të zhvillimit ekonomik, bazuar në resurset ekzistuese. Në këtë komunë ekziston mundësia e zhvillimit të shumë sektorëve ekonomikë, filluar nga veprimtaritë ekonomike dhe shërbyese. Sipërfaqet e konsiderueshme me tokë bujqësore, pyje, ara, livadhe e kullosa, ofrojnë një bazë të mirë për zhvillimin ekonomik. Gjithashtu, ka bazë të mirë për zhvillimin e bizneseve individuale, tregti, industrinë e lehtë, gjithashtu resurset e trashëgimisë natyrore dhe kulturore ofrojnë mundësi të mirë për zhvillimin ekonomik lokal. Komuna e Deçanit, në të ardhmen ka për qëllim të ofrojë shërbime standarde dhe efikase. I gjithë planifikimi për zhvillimin e ardhshëm ekonomik të komunës duhet të mbështetet në potencialet ekzistuese natyrore dhe në avancimin dhe ngritjen e kapaciteteve të resurseve humane.

Qëllimi kryesor është që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm ekonomik duke i shfrytëzuar resurset natyrore dhe kulturore në mënyrë racionale, por gjithsesi duke i lënë mundësinë edhe gjeneratave që vijnë një potencial të mirë për t'i shfrytëzuar ato resurse. Në Komunën e Deçanit, aktivitetin e tyre biznesor e ushtrojnë 2254 biznese. Në bazë të kriterëve mbi vlerësimin e madhësisë së bizneseve dhe atë numri i të punësuarve ku pjesa dërmuese e tyre i takon bizneseve individuale ku aktiviteti i tyre është prodhues, tregtar, ndërtimor dhe shërbyes.

7.1 Shkalla e punësimit

Shkalla e Punësimit. Shkalla e punësimit sipas Anketës të Fuqisë Punëtore (AFP) në komunën e Deçanit për vitin 2021 është 40.8% në raport të përgjithshëm, ku punësimi me i lartë është të meshkujt (53,4), ndërsa punësimi të femrat është (46.6%). Femrat janë të punësuar, kryesisht në këto sektorë: arsim, kujdes shëndetësor dhe tregti, ndërsa meshkujt janë kryesisht të punësuar në sektorët: ndërtimtarisë, tregtisë dhe prodhimit.

7.2 Niveli i varfërisë

Niveli i varfërisë, një prej parametrave thelbësor për mirëqenien e një vendi është shkalla e punësimit. Bazuar në Anketën e Buxhetit Familjar 2021, konsumi mesatar vjetor për familje është vetëm 11,803 €. Nga kjo vlerë, rreth 70% qind shpenzohet për ushqim dhe banim, dhe

vetëm 3% e mesatares së konsumit vjetor për ekonomi familjare i takon kategorisë së shpenzimeve për shëndetësi, ndërsa që vlera e shpenzimeve për aktivitete tjera sociale mbetet tejet e ulët. Duke u bazuar në të dhënat e Mirëqenies Sociale nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, gjatë vitit 2021, në Komunën e Deçanit, janë gjithsej 316¹² ekonomi familjare të përfshira në programin për asistencë sociale, apo gjithsej 1,220 persona. Kjo, shifër paraqet rreth 4% të gjithë popullsisë së vlerësuar në Deçan (42,755). Në të njëjtën kohë, bazuar në gjendjen e muajit shtator 2021, në Komunën e Deçanit, përfitues nga skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës janë 624.

7.3 Ambienti biznesor

Në vitet e fundit qeverisja lokale në Deçan, në bashkëpunim me Nivelin Qendror kanë krijuar ambient biznesor me një sërë masash reformuese me qëllim të përmirësimit të ambientit të biznesit në komunë. Si rrjedhojë e këtyre reformave, tani Ndërmarrjet e Vogla, Mesme dhe të Mëdha- NVM-të regjistrohen përmes Qendrës Komunale për Regjistrimin e Bizneseve. Disa prej zhvillimeve të rëndësishme në këtë drejtim që ka krijuar kushte Komuna e Deçanit, për ushtrimin e veprimtarive biznesore është investimi në infrastrukturë rrugore i cili investim ka hapur rrugë bizneseve për investime edhe në zhvillimin ekonomik lokal në fushën e turizmit, që është një nga potencialet e mëdha të zhvillimit.

7.4 Turismi dhe hoteleria

Duke vlerësuar potencialet natyrore dhe trashëgimisë kulturore me të cilat disponon Komuna e Deçanit, mundësia e zhvillimit të turizmit si një sektor i rëndësishëm ekonomik, paraqet një nga shtyllat kryesore të zhvillimit të Komunës. Parku Kombëtar i “Bjeshkëve e Nemuna” dhe monumentet e trashëgimisë natyrore, trashëgimia kulturore arkitekturale dhe arkeologjike, paraqesin asetet e vetme për promovimin e turizmit në Komunën e Deçanit. Që nga viti 2017, ka filluar ndërtimi i rrugës rajonale Deçan -Plavë, R107, e cila krijon kushte të favorshme për ofrimin e aktiviteteve turistike duke paraprirë ndërtimin e objekteve turistike-Qendrës Turistike në Bjeshkën e Belegut, bujtinat, apo stane në Bjeshkët e Deçanit. Për lehtësim të orientimit drejt zonave turistike dhe pikave të interesit është realizuar edhe sinjalizimi i shtigjeve, është hapur edhe Qendra për Informim Turistik, e cila ofron material promovues dhe informues për Bjeshkët e Deçanit, të cilat janë:

- Bjeshka e Belegut;
- Bjeshka e Pleqes;
- Bjeshka e Strellcit;
- Bjeshka e Kurvallës-Lloqanit;
- Bjeshka e Prilepit;
- Bjeshka e Milidhevcit;
- Bjeshka e Roshkodolit;
- Bjeshka e Madhe-Deçanit;
- Bjeshka e Budoshit;
- Bjeshka e Lumëbardhit;
- Bjeshka e Irzniqit;

¹² Agjencioni i Statistikave të Kosovës -Raporti i Statistikave të Mirëqenies Sociale për vitin 2021

- Bjeshka e Zllonopojës;
- Bjeshka e Baballoqit;
- Bjeshka e Pllaqicës;
- Bjeshka e Carrabregut-Koria;
- Bjeshka e Jedovës;

7.5 Trashëgimia natyrore

Komuna e Deçanit, është e njohur me trashëgimi natyrore ku një pjesë e kësaj pasurie është e vendosur në mbrojtje sipas normave ligjore mjedisore. Deçani disponon “Bjeshkët e Nemuna” që janë Park Nacional, paraqet një prej vlerave më të rëndësishme natyrore. Bukuritë natyrore dhe vlerat e këtij territori e posaçërisht “Gryka e Deçanit”, kanë vend të rëndësishëm në vlerat, peizazhit dhe bukurive natyrore specifike me florë dhe faunë. Vlerë të mëdha këtij territori i shton edhe “Gryka e Deçanit” më “Kanyonin e Lumëbardhit” të Deçanit, si dhe “Gryka e Lloqanit” me “Lumëbardhin e Lloqanit”, vlera që krijojnë mundësi të jashtëzakonshme për vizita dhe ekskursione nga turistët vendas dhe të huaj. Këto gryka janë me bukuri të rralla natyrore atraktive dhe të rëndësishme, jo vetëm për rrafshin e Dukagjinit dhe me gjerë ku “Lugina e Lumëbardhit”, është e ndërtuar në kanyonin e Glacialit të dikurshëm në luginën që është e gjatë 30 km. Në dalje të Grykës, është qendra rekreative-turistike kompleksi i hoteleve dhe pushimorja e fëmijëve, e cila duhet të jetë bazë për zhvillimin e mëtejshëm të një Qendre Turistike Rekreative për “Bjeshkët e Nemuna”. Gjithashtu, në këtë pjesë gjendet edhe kompleksi i trungjeve të pishës së zezë (pinus nigra), i vënë në mbrojtje ligjore, si zonë e mbrojtur e pishës pyjore. Kjo hapësirë është mbjellë në pjesën e parë të shek. XIX-të, më sipërfaqe prej 15 ha, kurse pjesët jugore dhe lindore të kësaj hapësire, është e pasur më gështenjë. Gjithashtu, janë në mbrojtje të monumenteve të natyrës edhe 17 monumente natyrore.

7.6 Trashëgimia kulturore

Qyteti i Deçanit, karakterizohet me monumente të gjitha kategorive ku përfshihen: komplekse, shtëpi tradicionale, kulla, xhami, kisha, mullinj etj. Territori i Deçanit, është i pasur me monumente kulturore, historike dhe arkeologjike. Vendet më interes të madhe janë: lokalitet arkeologjike parahistorike në; Belle, Pleqe, Vranoc të Vogël, Glllogjan, Strellc i Epërm, Rastavicë, Irzniq, dhe Baballoq, monumentet myslimane, kullat, monumentet kristiane, si dhe mullinj. Identifikimi i vendeve me rëndësi arkeologjike janë: Llukë e Epërm, Lëbushë, Kisha Selishtave, Rrazhga, Qelia, Shpella e Madhe, Balleja, Kozhnjerit, Carrabregut etj. më interes të madh në Komunën tonë kemi një numër të madh të kullave, të kompleksit të kullave në disa fshatra tjera të Komunës së Deçanit.

Kulla është një shtëpi e fortifikuar prej gurit që zanafillën e ka që nga kohërat e lashta, që ka evoluar në formën e sotme, e që destinimi parësor i tyre ka qenë mbrojtja nga pushtuesit e ndryshëm të kohës. Kullat janë objekte të ndërtuara më gurë të gdhendur me porta, dritare dhe frangji në formë harku që zakonisht kanë qenë me tri dhe katër etazhe (kate). Kati i parë (etazhi i parë) ka shërbyer për ruajtjen e bagëtisë, kati i dytë (etazhe i dytë) është i destinuar për banim dhe përbëhet nga korridori i brendshëm dhe dhomat për fjetje, kurse kati më i lartë është i

zbukuruar më punime artizanale nga druri, oda e burrave, është punuar më dekorime të ndryshme nga druri (tavani), punime dore, si dhe punime të tjera artizanale, kurse në pjesën balllore të saj gjendet oxhaku karakteristik dhe është destinuar për pritjen e mysafirëve.

Duhet të theksohet se përveç monumenteve kulturore të palujshme një rol të madhë paraqet historia dhe kultura, që na bëjnë të kujtojmë se trashëgimia e historike e artistike; monumentet, arkeologjike, peizazhet mjedisore, veprat artistike të prodhuara nga njeriu etj., kanë një vlerë të njohur artistike të papërsëritshme e që e përcjellin atë përmes një konotacioni të fortë estetik dhe shprehës njëherësh dhe si të tillë ata i përkasin kulturës dhe bashkësisë që i ka prodhuar, ruajtur e kultivuar si një dëshmi historike autentike e unike njëherësh e që përbëjnë objekt të edukimit estetik, prandaj duhet të jenë objekt i vlerësimit dhe mbrojtjes. Kryeveprave të trashëgimisë kulturore shpirtërore të Deçanit janë:

- Instrumentet popullore (çifteli, sharki) këngët e kënduara nëpër oda dhe manifestimet tradicionale.
- Ahengjet familjare dhe ditët e manifestimeve tradicionale – vallet e vajzave ku duhet të veçohet vallja dyshe e vajzave deçanase është folklor instrumental dhe koreografik, tipologji e trashëgimisë shpirtërore e përcjellë brez pas brezi duke prezantuar atë pjesën e diversitetit kulturor të Deçanit.

7.7 Zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë

Për zhvillimin e bujqësisë duhet të revidohet (plotësohet) strategjia dhe plani për zhvillimin e bujqësisë. Komuna e Deçanit, duhet të planifikojë politika lehtësuese, për subvencionimin e këtij sektori. Në këtë aspekt Komuna, duhet të ndërmarrë këto objektiva për zhvillimin e bujqësisë duke ndihmuar bujqit në: grupimi i parcelave bujqësore, aplikimi i masave agro teknike, ngritja e kapaciteteve të magazinimit dhe përpunimit të produkteve, ngritja e fermave dhe serave (përpunim qumështi, mishi dhe perimeve të freskëta) të favorizojë me investime rritjen e sipërfaqeve me pemëtari, bletari, kultivimin e bimëve mjekuese dhe rritjen e fondit të gjedheve dhe shpezëve, gjithashtu të mbështetet edhe ngritja e qendrës së grumbullimit dhe përpunimit të frutave malore, frigoriferëve për ruajtjen e prodhimeve bujqësore, organizmin e fermerëve në organizata bujqësore të prodhimeve bujqësore.

Objektivi për zhvillimin e bujqësisë së qëndrueshme, nënkupton menaxhim të resurseve natyrore dhe siguron mbrojtjen dhe ruajtjen e tokës bujqësore, sipërfaqet e pyjeve, rritjen e kapaciteteve të rendimenteve, duke siguruar që rrjeti ekzistues i kanaleve të ujitjes të betonohet dhe zgjerohet me aplikim e sistemit të avancuar-sistemit të ujitjes.

Kullotat dhe livadhet janë potencial ku duhet të mbështetet zhvillimi i blegtorisë, lavëtarisë, pemëtarisë, perimtarisë dhe agro-industrisë. Bletaria. -Komuna e Deçanit, ka mjaft sipërfaqe tokësore në të cilën rriten dhe zhvillohen një numër i konsiderueshëm i bimëve nektaruese (nektarmbajtëse), që janë burim kryesor i ushqimit të bletëve. Bimët nektaruese që shfrytëzohen për kullotjen e bletës sipas shtrirjes së tyre ndahen si: bimë natyrore dhe bimë të ndryshme bujqësore të kultivuara. Gjithashtu vlen të përmendet ndikimi i faktorit njeri, i cili më punën e tij në ngritjen dhe rregullimin e kopshteve dhe kultivimin kulturave të tjera bujqësore ndikojnë shumë në përmirësimin e kullotave për bletët.

Natyra e Komunës së Deçanit, ofron kushte mjaft të mira për të nxjerrë sa më herët bletët në kullotë para fillimit të pranverës gjejnë kullota të bollshme në natyrë si: Bagren (Akacia-Robinia pseudacacia L.), Blirit (Tilia sp.L), Gështenjës (castane sativa) etj. Përpos bimëve

drunore të cilat gjenden të përhapura në vendin tonë, kemi edhe shumë lloje të bimëve barishtore mjekuese. Këto bimë barishtore janë të përhapura nëpër livadhet e ultësirave, livadhet kodrinore, livadhet malore dhe kullosat. Në të gjitha këto livadhe rriten shumë bimë që janë të njohura për prodhimin e nektarit dhe të pjalmnit (polenit) me cilësi shumë të mirë. Vlen të përmendet si: Zymbyli i livadheve (*C. Caerylea*), që lulëzon nga fundi i qershorit dhe gjatë tërë korrikut, Manaferra (*Ribes rubrum*), Tërfili i livadheve (*Trifolium Pratense L.*), Sherbela e livadheve (*Silvia verticilata L.*), Trumza (*Satureia subspicata Vis.*) Luleverdha (*C. Palustris*) që është e pranishme në livadhet kodrinore dhe në Bjeshkët e Deçanit. Këto kushte të favorshme që ofron natyra bëjnë të mundur zhvillimin e bletarisë. Komuna në bashkëpunim me OJQ-të në të ardhmen planifikon:

- Trajnime për bletarët e rinj;
- Ngritja e parkut të bletarisë dhe shtimi i numrit të shoqërive të bletëve;
- Subvencionimi i bletërritësave.

Zhvillimi i blegtorisë. -Fondin e konsiderueshëm të livadheve e kullosave me sipërfaqe prej 1,873 ha, mundëson zhvillimi e kësaj veprimtarie gjithashtu do të mundësoj edhe zhvillimin e blegtorisë në pjesën rurale. Ekziston tradita dhe përkushtimi i banorëve për ta zhvilluar këtë veprimtari.

Pylltaria si aktivitet ekonomik- Në komunën e Deçanit, ekzistojnë sipërfaqe të konsiderueshme me pyje dhe kërkohet një plan për shfrytëzim dhe mbrojtje të pyjeve. Mbrojtja e pyjeve ka rëndësi të veçantë për ruajtjen e mjedisit të shëndosh dhe atraktiv ndërsa shfrytëzimi racional i tyre do të ndikojë në zhvillimin e industrisë së drurit, biomasës dhe artizanateve me kapacitet racional. Komuna e Deçanit, duke pasur parasysh fondin e pyjeve mund të shfrytëzohet masa drunore të dëmtuar për biomase (ngrohje).

8. BARAZIA GJINORE

Barazia gjinore u referohet të drejtave, përgjegjësi dhe mundësi të barabarta burrave, grave, vajzave dhe djemve në një shoqëri. Në Komunën Deçanit kësaj çështje i është kushtuar rëndësi e veçantë, sidomos në politikën e punësimit dhe përfaqësimit të gruas në të gjitha sferat e jetës. Sipas të dhënave në administratën publike janë të punësuar 134 punëtorë, prej tyre, femra janë: 27, ndërsa meshkuj janë: 107. Në sektorin e arsimit, numri i të punësuarve dhe përfaqësimi gjinor është si vijon: mesimdhënës të gjinisë femërore janë:184, ndërsa meshkuj janë: 394. Në shëndetësi: të gjinisë femërore janë: 84, ndërsa meshkuj janë 36. Si pasojë e mundësisë së kufizuar për pjesëmarrje në organizmat vendimmarrëse, gratë dhe vajzat kanë arritur mundësi drejtuese nëpërmjet alternativave të tjera, në mënyrë të veçantë në sektorin jo-qeveritar. Në Komunën tonë, ato gjetën më shumë hapësirë dhe liri për një angazhim aktiv në dobi të çështjeve të grave/vajzave dhe fëmijëve në veçanti, por edhe të komunitetit në tërësi. Shoqatat e grave kanë arritur të realizojnë një sërë aktivitetesh lidhur me të drejtat e grave/vajzave dhe fëmijëve, përkujdesjen sociale e shëndetësore, zhvillimin ekonomik (kryesisht të biznesit të vogël) etj.

REKOMANDOHE:

- Rritja e numrit të projekteve, apo programeve të cilat nxisin formimin profesional dhe punësimin e grave dhe vajzave, si dhe shtrirja e këtyre projekteve edhe në zonat rurale, dhe;
- Rritja e ndërgjegjësimit të shoqërisë për pjesëmarrjen aktive të grave dhe vajzave në vendimmarrje (politikë).

9. Energjia

Furnizimi i Kosovës, me energji elektrike bëhet nga dy burime primare: dy termocentralet me ndezje të thëngjillit “Kosova A” dhe “Kosova B” në rajonin e Prishtinës, dhe importeve përgjatë rrjetit 400 kv dhe 220 kv në termocentralin “Kosova B”, përgjatë rrjetit 400 kv në NS Deçan 110/35/10 kv dhe NS Isniq 35/10/kv. Gjendja e rrjetit për furnizim me energji elektrike për momentin është e mirë, ku me ndihmën e donatorëve dhe investimeve Komunale është bërë riparimi i një pjese të madhe të këtij rrjeti duke përfshirë tensionin e ulët dhe tensionin e lartë. Komuna e Deçanit, ka shtrirje me furnizim të energjisë elektrike edhe nga hidrocentrali i Kozhnjerit, i cili e bën furnizim me 8 mg/w po ashtu edhe 32 mg/w nga Kelkos kompani – operator privat ku zbraza bëhet në NS Deçan 110/35/10 kv. Rrjeti primar është në gjendje të rregullt dhe funksional i tensionit të ulët në: Qyteti i Deçanit, (objektet përgjatë rrugës kryesore furnizohen me rrjet nëntokësor), Lëbushë, Dubovik, Carrabreg i Ulët, Carrabreg i Epërm, Pozhar, Kodrali dhe Drenoc. Ndërsa pjesërisht janë: Strellci i Epërm, Strellci i Ulët dhe Isniqi.

9.1. Sektori i ndriçimit publik i rrugëve

Gjatësia e gjithë rrjetit të ndriçimit publik sipas Planit Komunal të Veprimit për Efiçencën e Energjisë (PKVEE) është raportuar të jetë 55,350 m, ndriçimi i rrugëve publike sipas këtij plani është siguruar për 30 rrugë-seksione në Komunën e Deçanit. Ndriçimi publik në Komunën e Deçanit, përfshinë 5,183 ndriçues. Nga kjo, në total është 90% janë raportuar të jenë të teknologjisë LED dhe 10 % llamba të tipit HID halide.

9.2 Telekomunikacioni

Në territorin e Komunës së Deçanit, veprojnë disa operatorë si: Vala, Telekomunikacioni i Kosovës (TK) dhe IPKO, të cilat ofrojnë telefoni fikse dhe mobile, kurse kompani të tjera si: Kujtesa, Art Motion, Një Art etj. veprojnë si kompani që ofrojnë shërbime në televizion kabllor dhe internet brenda zonës urbane dhe zonat rurale. Në rastet të shumta, linjat tele-komunikuese përdorin rrjetin ajror të KEDS-it, respektivisht shtyllat e tensionit të ulët, pa ndonjë planifikim paraprak. Megjithatë, gjendja aktuale e infrastrukturës së telekomunikacionit në Komunën e Deçanit, është relativisht e mirë. Posta e Kosovës (PTK) ofron shërbime postare, që mbulojnë gjithë territorin e Komunës.

9.3 Ngrohja

Komuna e Deçanit, nuk ka sistem të ngrohjes qendrore. Ekonomitë familjare për ngrohje përdorin: drurin, peletin, briketin, karburantet ose energjia elektrike për ngrohje.

10. Infrastruktura dhe shërbimet publike

10.1 Ujësjiellësi

Sistemi i ujësjiellësit në Komunën e Deçanit, menaxhohet nga njësia operative K.R.U “Hidrodrini” Sh.a Pejë.

Tabela 4: Mbulushmëria me shërbimin e ujësjiellësit nga njësia operative K.R.U “Hidrodrini” Sh.a Pejë.

Mbulimi me shërbimin e ujësjiellësin në komunën e Deçanit	Nr.
Numri i përgjithshëm i banorëve	42,4755
Numri i ekonomive familjare në komunë	6948
Numri i ekonomive familjare të përfshira me shërbimin e ujësjiellësit	6948
Objekte të institucioneve publike në komunë	50
Numri i objekteve të institucioneve të përfshira me shërbimin e ujësjiellësit	50
Numri i bizneseve aktive në komunë	2254
Numri i bizneseve të përfshira me shërbimin e ujësjiellësit	2254

Bazuar në rëndësinë e ujësjiellësit dhe ndikimin e tij në kualitetin e jetës dhe mirëqenien e popullatës si dhe në zhvillimin ekonomik dhe social të Komunës, gjatë hartimit të PLVM-së, duhet gjithsesi të harmonizohen planet dhe projektet planifikuese për investimet kapitale në infrastrukturën e furnizimit me ujë ku nevojat imediate janë për përmirësimin e rrjetit ekzistues të ujësjiellësit në pjesën urbane dhe rurale aty ku ka nevojë duke përfshirë edhe zvogëlimin e humbjeve të ujit dhe gjetjen e humbjeve teknike dhe administrative si dhe identifikimin dhe eliminimin e kyqjeve ilegale. Kjo para së gjithash nënkupton interesin dhe përgjegjësinë e Komunës, për ofrimin e shërbimeve cilësore për pjesën e përfshirë të popullatës me këto shërbime, po ashtu dhe për zgjerimin e infrastrukturës dhe krijimin e kushteve për përfshirjen e zonave aktualisht të pambuluara me këto shërbime të furnizimit me ujësjiellës të cilat janë fshati Belle dhe Pleqe, kurse në 35, vendbanime dhe pjesa urbane kanë të shtrire dhe funksional rrjetin e ujësjiellësit. Dezinfektimi i ujit të pijes bëhet me klor të lëngët për arsye të mungesës së klorit të gazet. Cilësia e ujit për pije kontrollohet nga IKSHPK-Pejë bazuar në Ligjin Nr. 2003/22 për Inspektoratin Sanitar të Kosovës, sipas parametrave të analizave nga IKSHPK cilësia e ujit të pijes në Komunën e Deçanit, në pikëpamje fizike, kimike dhe biologjike është i mirë. Projektet e planifikuara për fazën afatmesme në periudhën 2021-2023 dhe afatgjatë 2020-2028 për infrastrukturën teknike të planifikimit janë këto projekte:

- Funksionalizimi i klorinatoreve në Komunën e Deçanit;
- Rehabilitimi në disa pjesë të ujësjiellësit në qendër të qytetit me vlerë 50,000.00 euro;
- Sistemi i ujësjiellësit në rajonin e Vokshit do të pajiset me ujëmatës;
- Sistemi i rezervarit të Hulaj të rehabilitohet me ujëmatës;
- Marrja në menaxhim të rrjetit të kanalizimit të ujerave të zeza në tërë territorin e Komunës së Deçanit;
- Ndërtimi dhe shtrirja e ujësjiellësit në Bjeshkët e Deçanit.
-

10.2 Kanalizimi

Sistemi i kanalizimit në Komunën e Deçanit, ka shënuar një zhvillim të theksuar viteve të fundit. Në bazë të shënimeve të Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike dhe aktualisht sistemi i kanalizimit i ujërave të zeza është i shtrirë në një gjatësi të përgjithshme prej: 64,572.36 m. Në rrjetin e kanalizimit përshihen: Qyteti i Deçanit, fshatrat: Beleg, Carrabreg i Epërm, Carrabreg i Ulët, Llukë e Epërm, Llukë e Ulët, Lumbardh, Rastavicë, Pobërgjë dhe Sllup, ku të gjitha ujërat e zeza trajtohen pjesërisht dhe duhet të ndërtohen impiante sipas standardeve për trajtimin e ujerave të zeza, për të evituar ndotjen e cila paraqet kërcënim serioz për shëndetin e popullatës dhe mjedisin në tërësi është e domosdoshme edhe realizmi sa me i shpejt i planifikimit për ndërtimin e kanalizimit në 18, fshatra tjera të cilat janë pa sistem të kanalizimit duke përfshirë edhe ndërtimin e impianteve. Ndërtimi i kanalizimit dhe impianteve në këto vendbanime: Strellc i Ulët-Bohriqe, Duvovik- Lagjja Gërvallaj-kufi me fshatin Kryshec dhe Papiç, kjo me vlerë afërsisht 13 milion (trembëdhjetë milion euro) ku trajtimi i ujerave të zeza do të bëhet sipas normave dhe standardeve mjedisore.

10.3 Kanalizimi atmosferik

Deri me tani rrjet të kanalizimit për ujërat atmosferike është i shtrirë vetëm në zonën urbane dhe atë në pjesën qendrore të qytetit me gjatësi prej 3 km, me kapacitet Ø 200mm - Ø 500mm, me puseta të vendosura në largësi nga 25-30 m, përgjatë rrugës kryesore të qytetit, shkarkimi i tyre bëhet në lokacione të ndryshme në kanalet e hapura. Shtrirja e rrjetit të ujërave atmosferike në të ardhmen parashihet edhe ndërtimi i rrjetit të kanalizimit për ujërat atmosferike në pjesën e vjetër të qytetit e ashtu quajtura (rruga e vjetër) me gjatësi prej 3 km. Ky rrjet parashihet të ndërtohet edhe në këto qendra të vendbanimeve në zonat rurale si: Strellc i Epërm, Isniq, Carrabreg i Epërm, Irzniq dhe Drenoc ku do të jetë me gjatësi prej 12 km, por është e domosdoshme të bëhet edhe trajtimi i tyre dhe pastaj shkarkimi në kanalet e hapura apo në rrjedhat e lumenjve.

10.4 Menaxhimi i mbeturinave

Komuna e Deçanit, ka krijuar një sistem komunal për menaxhim të mbeturinave dhe plotësimin me mjetet përcjellëse për shtrirjen e plotë të shërbimit për mbledhjen (grumbullim) të mbeturinave në gjithë territorin e Komunës. Shtrirja e menaxhimit të mbeturinave në gjithë Komunën, bëhet nga Ndërmarrja Publike Lokale “Higjiena” Sh.A, e cila ofron shërbime rreth mbledhjes (grumbullimit) të mbeturinave dhe ndarjes në bazë në ekonomitë familjare. Trajtimi i mbeturinave përfshin: riciklimin, ripërdorimin, reduktimin dhe kompostimin e mbeturinave e deri në transportimin e tyre në deponin regjionale. Ndërmarrja Publike Lokale “Higjiena” Sh. A, mbështetet nga Gizi-Gjerman në kuadër të projektit “Shërbimet të Qëndrueshme Komunale”, siç janë përcaktuar në Ligjin Nr. 04/L-060 Për Mbeturina. Kjo ndërmarrje e bën mbledhjen (grumbullimin) e mbeturinave duke afuar shërbimin “Derë me derë”, për ekonomitë familjare në zonën e Qytetit të Deçanit, kompania ku pjesën urbane e mbulon në mbledhjen e mbeturinave rreth 1 km (99.18 ha) duke shtrirë edhe mbledhjen e mbeturinave në 35 fshatra të Komunës. Kurse dy vendbanime siç janë: fshati Belle dhe Pleqe, sipas

konfiguracionit malor ofrohet shërbim sipas Planit Komunal për Menaxhim të Mbeturinave në Komunën e Deçanit. Në Komunën e Deçanit, janë të përfshira: 6948 ekonomi familjare, 2,254 biznese dhe 50 institucione, ku shtrirja dhe shërbimi është 100 % në gjithë territorin e Komunës.

Sa i përket përbërjes së mbeturinave komunale, pjesën më të madhe e përbëjnë mbeturinat organike me 36%, mbetutinat e qelqit me 12%, ato të drurit 14%, plastikës 9%, metalet 11%, tekstili 14% dhe mbaturinat e letrës dhe kartonit 4%.

Tabela 5: Përbërja e mbeturinave komunale në komunën e Deçanit

Lloji i mbetutinave	%
Mbeturina organike	36
Qelq	12
Dru	14
Plasitkë	9
Metale	11
Tekstil	14
Letër dhe karton	4

Grumbullimi i mbeturinave në Komunën e Deçanit, bëhet përmes sistemit “Derë më derë” (kontejnerëve 120 l dhe qese plastike), kontejnerëve të përbashkët (1.1m³) si dhe kontejnerëve me kontratë (1.1 m³). Shërbimi “Derë më derë” kryhet nëpërmes kontejnerëve 120 l dhe qese plastike dhe i njëjti bëhet duke ofruar shërbim për qytetin dhe të gjitha fshatrat. Ndërsa shërbimi me kontejnerë të përbashkët (në pjesën e qendrës së qytetit) dhe me kontratë kryhet nëpërmes kontejnerëve 1.1m³.

10.5 Ndërmarrja Publike Lokale “Higjiena” Sh.A

N.P.L “Higjiena” SH. A, bënë grumbullimin e mbeturinave më këtë frekuencë të shërbimeve: në qytet shërbimi ofrohet çdo ditë nga ora: 08:00-16:00h . Gjatë sezonit të verës kur sasia e mbeturinave rritet për shkak të ardhjes së qytetarëve nga diaspora shërbimi ofrohet edhe dy herë në ditë. Bizneset dhe institucionet me Kontrata të Veçanta shërbejnë në bazë të orarit të kontratave dhe në bazë të pastrimit të kontejnerëve. Ndërsa në fshatra shërbimi bëhet me kontejnerë 1.1 m³, institucionet dhe disa biznese. Ekonomit familjare shërbejnë me 120 l, ose me qese plastike. Mbeturinat e grumbulluara transportohen në deponinë regjionale.

Në planifikimin e projekteve në Ndërmarrjen Publike Lokale “Higjiena” sh.a në bashkëpunim me komunën e Deçanit me qëllim të zgjerimit të kapaciteteve dhe shërbimeve të kompanisë janë planifikuar disa projekte kryesore. **Projekti i qendrës së ndarjes së mbeturinave.**

- Ky projekt është përgatitur nga ana e komunës së Deçanit në bashkëpunim me Ndërmarrjen Publike Lokale “Higjiena” sh.a me qëllim të krijohet një pikë e transferit të mbeturinave e cila do të jetë një ndihmës e madhe për kompaninë, do të zvogëlojë koston e largimit mbeturinave për shkak se ato nuk zbrazen në deponin aktuale duke ulur edhe shpenzimet e derivateve amortizimit, dhe duke ja mundësuar kompanisë rritjen e fuqisë punëtore.

Foto si duket një projekt i qendrës së transferit



- **Projekti i kontejnerëve nëntokësor në zonën qendër**

Me qëllim të zgjerimit modernizimit të shërbimeve dhe duke ju mundësuar qytetareve qasje të mirë në ambient të pastër komuna e Deçanit ka përgatitur një projekt të krijimit të kontejnerëve nëntokësor në zonën qendër ku aktualisht janë kontejnerët. Me këtë investim qytetit do ti krijohet një pamje e bukur dhe qytetareve qasje e lehtë dhe e modernizuar në kontejnerët publik nëntokësor.

Foto ilustrim si duken një nga llojet e kontejnerëve nëntokësore



10.6 Mbeturinat e ndërtimit dhe demolimit

Mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimit mund të përbëhen nga materialet ndërtimore dhe janë në përgjithësi të vëllimshme dhe të rënda. Sa i përket mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit dhe deponimit të tyre brenda komunës nuk ka një lokacion për mbeturinat inerte, ato hidhen në mënyrë të paligjshme nëpër toka bujqësore, në lumenjtë që gjenden afër tyre dhe sipërfaqe djerrina. E domosdoshme është të caktohen 2-3 lokacione për deponim të mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit, të hartohet rregullore dhe procedura lokale. Mbeturinat inerte mund të përdoren për mbushjen dhe rehabilitimin e gropa apo hendeqeve të ndryshme.

Komuna e Deçanit, ka caktuar vendin për deponimin e mbeturinave të konstruktimit dhe demolimit në Rr. "Luan Nimonaj" në Deçan.

10.7 Mbeturinat e bujqësisë dhe industrisë ushqimore

Mbeturinat nga bujqësia dhe industria e ushqimit, përfshijnë nus-prodhimet nga thertoret, eshtrat e kafshëve dhe kafshët e ngordhura, plehrat e kafshëve etj. Në industrinë e prodhimeve dhe përpunimit të qumështit, mishit, miellit, pijeve të ndryshme alkoolike dhe joalkoolike etj. gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre për përfitim të produkteve krijojnë mbeturina, por mbeturinat krijohen edhe gjatë dhe pas konsumimit të produktit ushqimor, ose pas skadimit të afatit të përdorimit. Gjatë importit të produkteve ushqimore të cilat pas skadimit të afatit, ose për shkak të ambalazhimit-skadimit një sasi e konsideruar e tyre bëhet mbeturinë, grumbullimin e tyre e bënë Ndërmarrja Publike Komunale "Higjiena" Sh. A.

10.8 Mbeturinat e rrezikshme

Mbeturinat e rrezikshme përfshijnë mbeturinat nga produktet medicinale Mbeturinat nga produktet medicinale janë mbeturina që mund të paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut dhe ambientin. Grumbullimin e tyre e bënë Qendra Kryesore Mjekësisë Familjar QKMF- Deçan, të cilat për asgjësimin e tyre dërgohen në incenerator në Qendrën Regjional në Pejë. Në Komunë e Deçanit, dikur ka qenë vetëm një incenerator në fshatin Irzniq, i cili tani nuk është në funksion. Në të ardhmen duhet të ndërtohet një incenerator sipas standardeve mjedisore që bën djegien e mbeturinave medicinale. Inceneratori- nënkupton objektin, apo pajisjen stacionare të krijuar për t'u shfrytëzuar për djegie të mbeturinave të rrezikshme, me apo pa shfrytëzim të energjisë nga djegia e tyre, përfshirë instalimin për pirolizë, gazifikim, apo procese tjera të trajtimeve termike të mbeturinave.

10.9 Automjetet e hedhura dhe mbetjet e tyre

Grumbullimi i automjeteve të hedhura bëhet kryesisht nga disa biznese private nga hekurishtet, autoservise, gjithsej në Komunë janë 2 hekurishte dhe 6 –të autoservise, të cilat mbeturinat i trajtojnë në dy mënyra: njëra është duke i grumbulluar si mbeturina metalike për shitje, të cilat kryesisht shitën në vende të rajonit si dhe tjetra duke i ndarë pjesët e tyre për t'i ripërdorur.

10.10 Mbeturinat e gomës

Në Komunën e Deçanit, nuk ka biznese që merret më grumbullimin e gomave, ose deponi për deponimin e tyre. Gomat e automjeteve nuk kategorizohen si mbeturinë e rrezikshme, por disa lloje specifike mund të kenë përbërës të tretshëm dhe të rrezikshëm që të trajtohen, duhet të caktohet një pikë grumbulluese në Komunën e Deçanit.

10.11 Mbeturinat e pajisjeve elektrike dhe elektronike

Pajisjet elektrike dhe elektronike pas përdorimit të tyre shndërrohen në mbeturina, të cilat në mungesë të ripërdorimit dhe riciklimit paraqesin mjaft problem për mjedisin, për shkak se këto përmbajnë disa komponentë të rrezikshme. Nuk ka të dhëna për sasinë e krijuar, por dihet se sasia e tyre është në rritje të vazhdueshme duke pas parasysh importin e pajisjeve të reja dhe të përdorura ku duhet të caktohet një pikë grumbulluese në Komunën e Deçanit.

10.12 Mbeturinat e vajrave

Mbeturina me vajrave dhe vajrat e përdorura paraqesin ndotje të madhe të dheut dhe ujërave, për shkak se ato derdhen në çdo vend duke ndotur dheun (tokën) dhe ujin. Vajrat e përdorura pjesërisht grumbullohen për t'u ripërdorur ose djegur për përfitimin e energjisë së nxehtësisë dhe ende nuk ekziston ndonjë qendër për grumbullimin e tyre.

11. Infrastruktura e transportit dhe trasnporti

Transporti i njerëzve dhe i mallrave në territorin e Komunës së Deçanit, bëhet përmes transportit rrugor ndërsa hekurudhor nuk është i pranishëm. Komuna e Deçanit, posedon një rrjet të rrugëve që ofrojnë lidhje të mira me komunat tjera dhe shtetet fqinje. Komuna është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e transportit brenda territorit të saj si vijon:

- transportin e rregullt të udhëtarëve;
- transportin e lirë të udhëtarëve;
- transportin taksit të udhëtarëve dhe
- transportin e udhëtarëve për nevoja vetanake.

Rrjeti i rrugëve nacionale dhe rajonale që administrohen nga niveli qendror, është: 69.5 km, kurse rrugë lokale janë me gjatësi prej 405 km, nga kjo gjatësi prej 335.5 km, janë përgjegjësi e Komunës. Të asfaltuara në Komunën e Deçanit, janë: 250 km dhe të pa asfaltuara janë: 155 km. Gjithsej rrugë të emëruara në Komunën e Deçanit, janë: 593 rrugë nga këto 19 rrugë të pa

emëruara me kode dhe të emëruara gjithsej janë: 574 rrugë, ku në total gjatësia e tyre është: 408,443 m. 19 Komuna e Deçanit, ka kompetencë të certifikojë automjetet me (8+1) ulëse për transport urban dhe urbane-periferik, ndërsa për transport të rregullt të udhëtarëve me autobusë brenda territorit të Komunës, mund të ushtrohet si: transport urban dhe urbane-periferik, transport i veçantë i udhëtarëve, transport për nevoja vetanake.

Kompanitë private të licencuara nga Ministria e Infrastrukturës Rrugore, ofrojnë shërbime qytetarëve për linjat urbane dhe linjat ndër-urbane, ndërsa nuk ofron shërbim nga stacioni i autobusëve i cili ekziston si objekt por nuk shfrytëzohet (kontest pronësore) kurse shërbim urban dhe urbane-periferike realizohet nga komibuset privat dhe taksit private (8+1). Analizës së transportit për Komunën e Deçanit, i paraprinë studimi i projektit Mobkos, duke analizuar zhvillimet dhe formën urbane-rurale dhe nder urbanë: shfrytëzimin e tokës, qasjen në pjesë të ndryshme të qytetit, fshatra, pjesët malore-bjeshkët përparësitë, potencialet dhe sfidat për zhvillim të ardhshëm.

Tabela 6 : Infrastruktura në komunën e Deçanit

Lloji i infrastrukturës	Gjendja 2022
Rrugë të asfaltuara regjionale (Magjastiraja/ km)	69.5 km
Rrugë lokale te asfaltuara (brenda Zones Urbane) (km)	405 km
Rrugë lokale te asfaltuara brenda vendbanimeve rurale (km)	250 km
Trotuare (zona urbane dhe zona rurale/km)	10 km
Shtigje per çiklistë /km	5 km
Ndriçim publik /km	20,0 km
Ujësjiellës / km)	138 km
Kanalizim atmosferik/ km	12 km
Kanalizim i ujërave të zeza urbane/ km	65 km
Hapësira të gjelbëruara (publike / m ²)	98 ha

Shënimi: Këtu mund të futen masa për zbatimin e ligjit për transportin e Personave me Aftësi Ndryshe, përshtatja e mjeteve të transportit publik .

11.1 Ndotja nga komunikacioni

Transporti rrugor është një nga burimet më të mëdha të ndotjes, duke kontribuar në cilësi të dobët të ajrit, zhurmës dhe ndryshimet klimatike. Transporti i mallrave dhe udhëtarëve bëhet me mjete të ndryshme të cilat janë të prirura të ndotin mjedisin duke ndikuar në ndotje të ajrit nga transporti. Ndotësit e ajrit nga transporti përfshijnë oksidin e azotit, grimcat, monoksidin e karbonit dhe hidrokarbure. Të gjithë kanë një ndikim të dëmshëm në shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe bimësisë në nivel lokal. Për të lehtësuar gjendjen mjedisore parashihet të realizohet projekti i rrugës transit, i cili e redukton ndotjen nga komunikacioni. Si përparësi brenda zonës urbane është edhe ndërtimi i rrugës së qendrës, që është me dy korsi, ku lëvizja e automjeteve dhe transportit është dukshëm më e lehtë duke krahasuar me gjendjen e viteve të mëparshme.

12. Infrastruktura publike dhe sociale

12.1 Shëndetësia

Shërbimet shëndetësore në Komunën e Deçanit, ofrohen në nivel të kujdesit primar shëndetësorë në këto njësi: — Një-Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Deçan; — Tri-Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) në Strellc i Epërm, Isniq dhe Irzniq; — Shtatë-Ambulanta të Mjekësisë Familjare (AMF) në Lumbardhë, Prapaqan, Gramaçel, Pobergjë (Polana), ndërsa tri prej AMF në: fshatin Ratish i Ulët, Prilep dhe Maznik, nuk janë në funksion. Të angazhuar në ofrimin e Shërbimeve të Kujdesit Parësor Shëndetësorë në Komunën e Deçanit, janë gjithsej 120 punëtor.

Kujdesi parësor shëndetësor (KPSH) mbështetet në konceptin e mjekësisë familjare dhe përfshin kujdesin dentar dhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike. Shërbimet ofrohen në Institucione shëndetësore publike dhe private. Rrjeti publik i KPSH përbëhet nga gjithsej 10 institucione, nga të cilat Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) si njësi kryesore, dhe njësitë e saj përbërëse: 3 Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) dhe 5 Ambulancat Mjekësisë Familjare (AMF), Qendra kryesore e vaksinimit në QKMF dhe Njësia e Urgjencës në objekt të veçantë në kuadër të QKMF.

Në kuadër të QKMF-së funksionon edhe Qendra Informuese (SISH).

QKMF ndodhet në qytetin e Deçanit dhe në të ofrohen shërbimet specialistike si dhe ato dentare dhe emergjente për tërë popullatën e komunës së Deçanit. Kjo qendër mbulon me shërbime të patronazhit (mobil) për gjithë qytetaret.

QMF-të ndodhen në: Strellc i Epërm, Isniq dhe Irzniq. Në këto qendra ofrojnë shërbime mjekë të specializuar kurse mungojnë shërbimet si: Stomatologjike, Laboratorike dhe kontrollet Gjinekologjike.

AMF-të ndodhen në këto vendbanime: Prapaqan, Lumbardh, Gramaqel, Poberghe-Polana dhe 2 që nuk janë funksionale janë në fshatrat: Ratish i Ulet dhe Prilep.

12.2 Mirëmbajtja - Ngritja e nivelit të shërbimeve të higjenes në QKMF-e Deçan dhe QMF Isniq, Strellc dhe Irzniq me pajisje, aparatura të nevojshme

QKMF -ja funksionon në kuadër të KPSH në komunën e Deçanit një nivel të kënaqshëm, edhe përkundër gjendjes financiare jo të favorshme të cilën gjendet, për qytetaret e komunës ofrohet shërbime shëndetësore, duke u bazuar në Masterplanin e Zhvillimit të KPSH të Deçanit.¹³ Në komunën e Deçanit popullata realizon shërbime të përkujdesjes parësor shëndetësor duke u bazuar në principet e Mjekësisë Familjare. Ky shërbim mjaft i kushtueshëm dhe mjaft kompleks ofrohet përpos në QKMF edhe në 3 Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe në 6 Ambulanta të Mjekësisë Familjare (AMF). Duke i plotësuar nevojat e mbi 42,755 banorëve të cilët jetojnë në qytetin e Deçanit dhe në mbi 37 fshatra, të cilat janë të shtrira rreth qytetit. Meqenëse për ofrimin e shërbimeve në KPSH një vëmendje e veçantë i kushtohet edhe nivelit të higjenes në hapësirat ku ofrohen këto shërbime për qytetarët. Mirëmbajtja e higjenes në hapësirat e QKMF-së dhe QMF-ve në komunën tonë bëhet nga stafi i mirëmbajtjes së higjenes të cilët me shumë vështirësi arrijnë që ta mbajnë të pastër hapësirën ku ofrohen shërbimet shëndetësore. Makinat të cilat janë në dispozicion janë të vjetruara, edhe parkunder servisimit të vazhdueshëm pothuajse janë jashtë përdorimit. Stafi i mirëmbajtjes së

¹³ Hasan Gjokaj-Udhëheqës I projektit për përmirësimin e cilësisë në QKMF dhe QMF

higjenes në hapësirat e QKMF-së me sipërfaqe prej 3365.8 m². Këtu përfshihen mirëmbajtja e korridoreve me toaleta në të dy katet, hapësirat e pritjes – në mjekime familjare, hapësirat për pritje në pediatri, hapësirat e urgjencës, hapësirat e maternitetit, vaksinim, stomatologji, laborator, administrat dhe hapësirat e veçanta në shërbimin për COVID-19.

QMF-Isniq ka sipërfaqe prej 646 m². QMF-Strellc ka sipërfaqe prej 450 m², ndërsa QMF - Irzniq ka sipërfaqe prej 192m². Gjithësej 3653.8m².

Përgjegjësit (stafi i mirëmbajtjes) për mirëmbajtjen e higjenes, hasin në vështirësi në realizimin e detyrave të tyre për krijimin e një ambienti sa më të pastër gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore.¹⁴

Duke u bazuar në të gjitha këto argumente, stafi udhëheqës i QKMF së bashku me Drejtorinë Komunale për SHMS dhe pas diskutimeve dhe konsultimeve me ekspertë e përgatiti këtë projekt propozim me të cilin tejkalohen sfidat dhe problemet e përshkruara më lart dhe e mundësojnë funksionimin optimal të sistemit të KPSH në Deçan.

Probleme:

- Mungesa e mirëmbajtësve në raport me kërkesën për pastrim
- Hartimi i planit për përmirësimin e nivelit të higjenes në hapësirat e QKMF-së dhe QMF-ve duke u bazuar në standarte bashkëkohore.
- Paisja e QKMF-së (Hapësira e Urgjencës me një makinë për pastrim) dhe QMF-ve me nga një makinë për pastrim për secilen për mirëmbajtjen e higjenes.
- Trajnimi i personelit për mirëmbajtje të higjenes dhe përdorimin e pajisjeve
- Mungesa e aparaturave në raport me kërkesat për mirëmbajtje të higjenes¹⁵
- Furnizimi i vazhdueshëm me material për selektimin e mbeturinave spitalore gjatë ofrimit të shërbimit për pacientët.
- Pajisja me material shpenzues për mirëmbajtjen e higjenes.
- Trajnimi për personelin që dërgon mbetje të rrezikshme për asgjësim në Spitalin Regjional – Pejë (insenerator), pajisje të nevojshme dhe mjete transportues.
- Pajisja me frigorifer për ruatjen e barnave (injeksioneve) etj.

12.3 Përkujdesja sociale

Në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DSHMS) në komunën e Deçanit funksionon Qendra për Punë Sociale e cila zbaton programin e masave për rritjen e mirëqenies sociale të qytetarëve. Qendra për Punë Sociale (QPS) bën vlerësimin e nevojave dhe identifikimin e përfituesve të asistencës sociale dhe atyre që plotësojnë kushtet për strehim të përkohshëm. Në vitin 2017 në komunën e Deçanit kanë qenë të përfshira në asistencë sociale 331 familje me 1249 persona, përderisa në vazhdimësi kërkesat për asistencë sociale dhe për banim social janë më të mëdha se mundësitë buxhetore të komunës. Hapësira në të cilën është i vendosur ky institucion nuk është e mjaftueshme për punë dhe nuk ofron qasje të lehtë për personat me aftësi të kufizuara. Banimi është çështje vendimtare për stabilitet social, shëndet dhe zhvillim kualitativ të mirëqenies njerëzore.

Banimi si shfrytëzues më i madh i hapësirës, ndikon në rrjedhën e zhvillimit të gjithmbarshëm të shoqërisë dhe njëherit është komponent i rëndësishëm i zhvillimit social-ekonomik, gjegjësisht të standardit jetësor, komuna e Deçanit ka këto qendra të banimit si:

- 1. Qendra për banim social**-Më financim të përbashkët MMPH dhe donacioni –SDC Zvicëran me Komunën e Deçanit është ndërtuar objekti me qira jo përfitues në vitin 2003-2004 me 16 njësi banesore.

¹⁴ Selmon Berisha –Drejtor i QKMF-së në Deçan

¹⁵ Lulavere Qorraj- Mjete familjare në QKMF-ë Deçan

2. QK (Qendra kolektive) -Lagjja “Baballog” me 14 objekte të banimit.

Planifikimi i komunës së Deçanit për ndërtimin e objekteve për banim social për periudhën 2017-2020 është paraparë dy objekte, kurse mjetet për ndërtimin e objektit të tretë do të shërbejnë për ndihmë të shlyerjes së qirasë për familjet që kanë nevojë.

Komuna e Deçanit zotëron Shtëpinë e Komunitetit për Personat me Aftësi të Kufizuara me kapacitet prej 10 persona e cila është ndërtuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ndërsa tani menaxhohet nga komuna e Deçanit, e cila strehon personat me aftësi të kufizuara psikike në kuadër të Rajonit.

Deçani nuk ka Shtëpi të pleqve, duhet të planifikohet një qendër për të moshuarit, gjithashtu rastet e dhunës në familje dhe kujdesin e fëmijëve Qendra për Punë Sociale, është në koordinim me qendrën rajonale në Pejë.

12.4 Institucionet arsimore:

Arsimi në komunën e Deçanit është i organizuar në: nivel të arsimit parashkollor/parafillor ku paraqet nivelin 01 dhe 02 sipas përshtatjes në përkufizimet e SNKA-së (Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit). Nivelin 01: Paraqet zhvillimin e hershëm dhe edukimin e fëmijës nga mosha 0 deri nën 3 vjeç. Arsimi parashkollor-para fillor në këtë nivel përfshihen çerdhet për fëmijë 1-2 vjeçar, kopshtet (për fëmijë 3-4 vjeçarë) dhe klasa e parë për fëmijë 5-6 vjeçarë. Në komunën e Deçanit niveli i arsimit parashkollor zhvillohet në një çerdhe, e cila gjendet në afërsi të qendrës së qytetit, Kopshti i fëmijëve “Fatosat”, me kapacitetit 120 vende, duke i përfshirë grup-moshat nga 6 muajsh-6 vjeç.

Niveli 02: Arsimi parafillor përfshin moshat 3 vjeç deri në 6 vjeç.

Arsimi i detyruar:

Arsimi i detyruar paraqet nivelet një dhe dy, sipas SNKA-së (Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit). Arsimi fillor klasifikohet si niveli 1 (klasat 1-5) dhe niveli 2 është arsimi i mesëm i ulët (klasat 6-9). Arsimi i detyruar funksionon në 18 shkolla publike.

Tabela 7 : Numri i fëmijëve në arsimin parafillor, ose nivelit 1¹⁶

Komuna e Deçanit	Para-fillor (5<6 vjeçë)		
	Meshkuj	Femra	Gjithësej
	220	243	463

Niveli i arsimit fillor:

Niveli i arsimit fillor zgjat 5 vjet, duke filluar nga klasa e parë deri në klasën e pestë (1-5). Në këtë nivel regjistrohen fëmijët që mbushin moshën 6 vjeçare, ndërsa grupmosha e nxënësve në këtë nivel është nga 6 deri në 10 vjeç.

Niveli i arsimit të mesëm të ulët:

Niveli i arsimit të mesëm i ulët shtrihet nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë (6-9). Grupmosha e nxënësve në këtë nivel është nga 11 deri në 14 vjeç dhe funksionon në shkolla të mesme të ulëta publike.

¹⁶ MASHT dhe ASK, Statistikat e arsimit në Kosovë 2021/2022

Tabela: Numri i nxënësve në arsimin fillor-mesëm të ulët i nivelit 2¹⁷

Komuna e Deçanit	Nr. i nxënësve në arsimin fillor –mesëm të ulët		
	Meshkuj	Femra	Gjithësej
	1951	1755	3706

Niveli i arsimit të mesëm të lartë:

Niveli i arsimit të mesëm të lartë paraqet nivelin tre (3) sipas SNKA-së (Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit) dhe funksionon në shkolla të mesme publike dhe nuk ka shkolla jopublike (të licencuara) në komunë.

Tabela: Numri i nxënësve në arsimin fillor-mesëm të ulët të nivelit 1 dhe 2¹⁸

Komuna e Deçanit	Nr. i nxënësve në arsimin e mesëm të lartë		
	Meshkuj	Femra	Gjithësej
	551	492	1043

Në bazë të synimeve dhe përmbajtjes këto shkolla janë të organizuara në gjimnaze dhe në shkolla profesionale. Shkollat e mesme të larta (gjimnazet dhe shkollat profesionale) janë shkolla të profilizuara. Gjimnazet “Vëllezërit Frashëri” ndahen në këto dy drejtime:

- Shkencat natyrore dhe
- Shkenca shoqërore-gjuhësore.

Ndërsa shkollat e mesme profesionale “Tafil Kasumaj” në Deçan, ndahen në këto drejtime:

- Mjekësi, elektronikë, mekatronikë, makineri, ekonomi, hoteleri

Statistikat: Tabela 4. Numri i institucioneve arsimore sipas niveleve dhe numri i vijuesve sipas niveleve 2021/2022¹⁹

Niveli i shkollimit	Numri i institucioneve	1.1 Numri i përgjithshëm i fëmijëve, nxënësve të regjistruar
Edukimi parashkollor (0-5)	1 institucion i licencuar	50
Edukimi parafillor (5-6)	18-- shkolla amë	463
Edukimi fillor (6-11)	18-- shkolla amë	3706

¹⁷ MASHT dhe ASK, Statistikat e arsimit në Kosovë 2021/2022

¹⁸ MASHT dhe ASK, Statistikat e arsimit në Kosovë 2021/2022

¹⁹ Plani Zhvillimore i Arsimit të komunës së Deçanit 2018-2022

Edukimi i mesëm i ulët (11-15)	18--shkolla amë	
Edukimi i mesëm i lartë (15-18)	1--shkolla gjimnaz 1-- shkolla e mesme teknike	1043 5212

Sqarim: numri i fëmijëve në kopshëtin e fëmijëve "Fatosat" në Deçan, nga 50 fëmijë nuk janë të përfshirë në MASH dhe ASK, Statistikat e Arsimit në Kosovë 2019/2020.

12.5 Gjelbërimi i hapësirave të shkollave

Hapësirat e gjelbëra janë të një rëndësie thelbësore ku sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, hapësirat e gjelbra janë: urbane, parqe, kopështe, hapësirat e institucioneve publike, fusha, lëndina, e të tjera si këto janë jetike për shëndetin e njeriut. Një rol të domosdoshëm duhet kushtuar rregullimit të infrastrukturës së jashtme të oborret e institucioneve edukativë arsimore përveç që duhet rregulluar kujdes të veçantë, janë vendosur ulëse dhe shportat e mbeturinave dhe mbjellë drurë dekorativë. Mbjelljen e fidanëve në oborrin e shkollës SHMU "Ardhmëria" në Beleg, Baballoq, Gramaqel, Isniq, Dubovik, Voksh.

- Mbjellja e drurëve në të dy anët e rrugëve në pjesën urbane dhe rurale.
- Rregullimi i hapësirave në pjesën rurale me ulëse dhe drurë dekorativë.
- Formimi nëpër shkolla i klubeve ekologjike.

13. Kultura

13.1 Manifestimet kulturore

Jeta kulturore në komunën e Deçanit është e pasur me një numër të madh të aktiviteteve të natyrave të ndryshme, duke filluar nga ato kulturore dhe sportive. Të gjitha këto aktivitete kulturore-sportive zhvillohen dhe organizohen në objekte të kulturës.

Qytetarët e Deçanit kanë treguar gjithmonë një interes të madh për aktivitete kulturore dhe sportive duke kontribuar në art dhe kulturë. Kultura tregon të kaluarën dhe të tashmen e një populli të cilën deçanasit e kanë dëshmuar me manifestimet e ndryshme kulturore dhe tradicionale.

Zhvillimet kulturore kanë zënë vend që prej një kohe të gjatë. Ne teatrin që mban emrin e aktorit të njohur deçanas, teatri "Skënder Tafa" kanë dalë shumë herë shfaqje e drama, që kanë bërë jehonë të madhe edhe në nivel vendi. Shumë artistë, këngëtarë dhe figura politike kanë origjinë nga Deçani. Dikur në Deçan dhe rrethinë ka ekzistuar një numër i madh i grupeve folklorike, më i njohur Grupi Folklorik ka qenë grupi "Mehmeti Riza" nga fshati Isniq, ndërsa sot veprojnë një numër i konsiderueshëm i tyre, duhet të veçohet edhe Ansambli i Valleve i fëmijëve të qytetit të Deçanit. Në komunën e Deçanit organizohen manifestime kulturore për të shënuar festat, apo datat e rëndësishme:

Festat më të rëndësishme janë:

- Dita 24 marsit-Epopeja e Dukagjinit
- Dita e dëshmorëve të komunës së Deçanit, 15 qershori
- Dita e Çlirimit të qytetit të Deçanit, 16 qershor.

Aktivitetet e trashëgimisë kulturore

- Dita e qethjeve të deleve, në muajin korrik
- Dita e gështenjës, në muajin tetor
- Darka e lamës, në muajin nëntor
- Dita e mjaltit, në muajin qershor dhe korrik
- Dita e pjekjes së rakisë në Glllogjan
- Panairi veror dhe vjeshtor
- Ditët e diaspores

Aktivitetet sportive

- Turneu memorial i futbollit "Ruzhdi Ramosaj"
- Turneu memorial i shahut "Zeqë Hasi"
- Krosti "Rruga e lirisë" më 23 Mars
- Turniri në futdral "Luan Haradinaj" më 06 Maj
- Turniri në ping-pong "Enver Halilaj dhe Altin Haskaj"
- Turniri i shahut "Besim Selmonaj"
- Turniri i boksit "Mustaf Selmonaj"

Festivalet folklorike

- Festivali i këngës për fëmijë "Ardhëmëria"
- Festivali "Eshkë e ndezur mbi Shkelzen"

Dekoratat:

Komuna e Deçanit ndan një numër të dekoratave për personat që kanë treguar vlera për liri, kulturë, arsim, sport etj., e ato janë:

- SHKELZEN HARADINAJ
- ISMAIL HARADINAJ
- HAKI POVATAJ
- ZEQË HASAJ
- MIRËNJOHJE E QYTETIT
- Epopeja e Dukagjinit – art dhe letërsi

Sporti – është një ndër lëmitë më të preferuara nga të gjitha shtresat e shoqërisë. Të rinjtë e komunës së Deçanit aktivitetet e tyre sportive i realizojnë në Palestrën Sportive, Stadiumin e Qytetit me 400 m² dhe 1500 ulëse dhe në fushat e mbuluara Sportive. Në shumicën e shkollave të komunës kanë hapësira për aktivitetet sportive ku në oborret e disave nga shkollat përveç fëmijëve hapësirat sportive shfrytëzohen edhe nga komuniteti dhe klubet sportive. Ekzistojnë 20 fusha të vogla sportive dhe 3 fusha të mbuluara, dhe gjinden në: SHFMU "Lidhja e Prizrenit" Deçan, SHFMU "Bajram Curri" Strellc i Epërm dhe SHFMU "Isa Boletini" Isniq. Përveç terreneve sportive për shumë qëllime, është e nevojshme të ndërtohen

objekte më të vogla sportive, apo fusha të lojërave për aktivitete të përditshme dhe për rekreacion në të gjitha fshatrat si dhe të rindërtohen fusha për lojërat e shkollave dhe sallat për aktivitete sportive.

Në kuadër të komunës ekipet sportive janë: 1. Klubi Hendbollistik për femra dhe meshkuj, 2. Klubi Futbollistik për meshkuj, 3. Klubi i Volejbollit për femra, 4. Klubi i Atletikës.

Komuna me financim të përbashkët me nivel qendror ka ndarë një vlerë të mjeteve financiare në mënyrë që të krijojë kushte për aktivitete rinore, ku parashihet ndërtimi i Qendrës Rinore dhe Trashëgimisë kulturore në lokacionin e quajtur Podi i Gështenjës më sipërfaqe prej: 580 m² P+1K.

13.2 Hapësirat publike dhe hapësirat e gjelbra:

Nr.	Vendbanimi	Destinimi	Sipërfaqja m2
1.	Deçan	Park/Pishat e Deçanit	15000
2.	Deçan	Park/Luan Haradinaj dhe Sali Çeku	810
3.	Deçan	Sheshi i Habsburgeve	937
4.	Deçan	Sheshi Mentor Tolaj	4894
5.	Deçan	Shëtitorja në dy brigjet e Lumëbardhit	24000
6.	Pobergje	Beqir Bokshi	4160
7.	Isniq	Sheshi Rustem Bruqi	2434
8.	Isniq	Sheshi Isa Boletini	3726
9.	Strellc i Epërm	Sheshi Ismet Ukaj	2471
10.	Irzniq	Sheshi Shqiponjat e Zeza	5685
11.	Gjithsej		64117

Hapësirat publike dhe të gjelbra përdoren për rekreacion aktiv, ose pasiv, ndërkohë që efektet e tyre të shumëfishta (shëndetësore, kulturore etj.) e përmirësojnë cilësinë e jetës. Për të qenë në dispozicion të banorëve, hapësirat publike dhe zonat e gjelbra duhet të jenë të integruara mirë dhe të shpërndahen në mënyrë të barabartë në të gjitha hapësirën pjese urbane dhe rurale. Hapësirat publike dhe të gjelbra në zonat urbane është në konkurrencë të vazhdueshme me ndërtimet, duke rrezikuar të humbasë nga presioni i ndërtimit. Qasja në këto hapësira është e mirë, edhe për personat me nevoja të veçanta dhe shërbimet emergjente. Përdoruesit janë nga të gjitha grup-moshat, mirëmbajtja e tyre bëhet nga Ndërmarrja Publike Lokale “Higjiena” gjatë gjithë vitit.

Tabela Nr. 8 Hapësirat publike dhe hapësirat e gjelbra:

Gjithashtu mungojnë të dhëna mbi gjatësinë e brezave të gjelbër përgjatë rrugëve dhe përgjatë rrjedhave ujore.

14. Mbrojtja e mjedisit



14.1 Mjedisi

Mbrojtja e mjedisit është një prioritet komunal ku përfshihet: Parandalimi dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe biodiversitetit. Për mbrojtje të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga ndotja, komuna parasheh ndërtimin e kanalizimit për ujërat e zeza në zonën rurale dhe impianteve me standarde mjedisore. Gjithashtu parashihet të bëhet mirëmbajtja, rregullimi i shtretërve dhe brigjeve të lumenjve, përrrenjve, pastrimi i deponive ilegale dhe gjelbërimi i hapësirave të degraduara, ndalimin e shfrytëzimit të inerteve nëpër lumenj. Për të ardhmen me qëllim të identifikimit dhe çështjeve të tjera mjedisore mbetet të trajtohen me PLVM, i cili parashihet të bëhet revidimi (ndryshimi). Dokumenti i VSM (Vlerësimi Strategjik Mjedisor) parasheh një përfshirje të zgjeruar të masave dhe veprimeve për zvogëlimin e ndikimit negativ në mjedis si dhe zhvillimeve të tjera të parapara në PLVM-ë, të cilat janë të integruara në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

14.2 Menaxhimi i mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Deçanit, është krijuar një sistem i shëndoshë mjedisor për menaxhimin e mbeturinave, i cili është mbështetur nga GIZ-i Gjerman. Menaxhimi i mbeturinave në territorin e Komunës, bëhet nga Ndërmarrja Publike Lokale “Higjiena” sh.a, e cila bën grumbullimin e mbeturinave sipas parimit “Derë më derë” ka për qëllim zvogëlimin e sasisë së mbeturinave përmes procesit të selektimit, riciklimit, ose në formë të dobishme (kompostim), ku sasia e mbeturinave zvogëlohet në vlerën minimale nga vendi, që është prodhuar e deri në depo. I gjithë procesi bëhet sipas Planit Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave 2020-2025.

14.3 Mbrojtja e tokave bujqësore:

Mbrojtja e tokave bujqësore. Komuna e Deçanit, në kuadër të angazhimeve për mbrojtjen e tokës bujqësore duhet të veprojë sipas objektivave të Strategjisë për Konsolidimin e Tokës 2010-2020, e cila si objektiv të përgjithshme ka realizimin e projekteve të konsolidimit të tokës dhe të sigurojë shfrytëzim racional të tokës bujqësore, mbrojtjen e mjedisit, trashëgimisë kulturore dhe mbështetje për zhvillimin e bujqësisë. Mbrojtja e tokave bujqësore si aset ekonomik dhe mjedisor duhet të mbrohet parimisht nga degradimi dhe ndërtimet e shpërqendruara, gjithashtu duhet të mbrohet nga erozioni, copëzimi dhe ndërtimet, ku si masë për mbrojtje nga ndërtimet duhet të jetë respektimi strikt i normave ligjore. Ndikimi i vazhdueshëm nga aktivitetet njerëzore sjell deri të degradimi i sipërfaqeve tokësore duke shkaktuar edhe pasoja të dëmshme mjedisore dhe socio-ekonomike, ku në Komunën e Deçanit, në tri vitet e fundit shndërrimi i fondit të tokës bujqësore në atë ndërtimore është 13,31.46 ha. Sfida është që të parandalohet degradimi i tokave dhe ndotja e tyre përmes masave dhe politikave specifike për mbrojtjen e tokave e kjo mund të arrihet me ndërmarrjen e këtyre masave si:

- Përgatitja e projekteve për parandalimin e vërshimeve për zonat Strellec, Isniq, Dubovik, Prilep dhe Gramaçel;

Hartimi i projekteve për mbrojtjen e veçantë të ngastrave të tokës nga përdorimi i

pakontrolluar i plehut artificial në bujqësi (nitrate, nitritet, fosfatet dhe ushqyesit e tjerë);

- Hartimi i projekteve ideore dhe kryesorë për mbrojtjen e tokës nga mbeturinat e paligjshme (të gjitha llojet e mbeturinave);
- Përgatitja e projekteve për mbjellje të fidanëve në zonat ku janë pastruar nga mbeturinat;
- Hartimi i projekteve dhe marrja e masave për mbrojtjen nga erozioni;
- Inspektime për zbatimin e masave për mbrojtje të tokës bujqësore kundër degradimit si pasojë e ndikimit njerëzor;
- Hartimi i projekteve për tokat e papunuara dhe për tokat me cilësi të ulët bujqësore;
- Organizimi i një fushate informative për qytetarët, apo me anë të broshurave për mbrojtjen e mjedisit tokësor dhe burimeve tokësore nga tjetërsimi i tokës bujqësore në atë ndërtimore.

14.4 Mbrojtja e ajrit

Ndotja e ajrit në gjithë territorin e komunës, është e mirë, përveç pjesës urbane ku komunikacioni është burim i ndotjes së ajrit (mjedisit). Komuna në bashkëpunim me MMPH, duhet të koordinojë kontrollet e vazhdueshëm të emetimeve të pluhurit dhe tymit nga komunikacioni/trafiku, gurëthyesit, beton-asfaltet, djegiet e mbeturinave, duke vendosur matës të ndotjes së ajrit në rrugët me frekuentim të komunikacionit, apo bizneset me ndikim në mjedis. Të hartohen projekte dhe të krijohen breza të gjelbërimit me qëllim të zvogëlimit/evitimit të ndotjes nga pluhuri, gazra dhe zhurma. Masat kundër ndotjes së ajrit:

- Hartimi i Planit Lokal për Mbrojtjen e Ajrit dhe mobilitetit;
- Marrjen e masave ndëshkuese ndaj personave fizikë, apo juridikë, që i tejkalojnë nivelet e lejueshme të ndotjes dhe zhurmës, sidomos në zonat e banuara.

14.5 Mbrojtja e pyjeve

Në Komunën e Deçanit, pyjet përfshinë rreth 36 % të territorit administrativ, me një sipërfaqe prej rreth 16,786.1 tokë pyjore/sipërfaqe ha, ku shumica e sipërfaqes pyjore gjendet në kuadër të Parkut Kombëtar Bjeshkët e Nemuna, kurse 1,873 ha janë livadhe dhe kulloso. Pyjet kontribuojnë në mënyrë efektive në zhvillimin e qëndrueshëm, nëpërmjet sigurimit të mirëqenies njerëzore, sigurojnë një mjedis të shëndetshëm dhe mbështesin zhvillimin ekonomik të zonës në tërësi. Potenciali unik i pyjeve mbështet një ekonomi të gjelbër, cilësinë e jetës dhe ndikon në zbutjen e ndryshimeve klimatike. Pyjet duhet të jenë të mbrojtura nga degradimi, prerjet ilegale dhe zjarret. Duhet të hartohen projekte në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për inventarizimin e pyjeve, sipërfaqeve të degraduara dhe të shpyllëzuara duhet të rigjenerohen përmes pyllëzimit dhe ri-pyllëzimit, të mbrohen bashkësitë e pastra të hormoqit, si dhe ato të përziera të bredhit dhe hormoqit që janë kategoria më e dëmtuar e halorëve në këtë pjesë, po ashtu të ndërmerren masa mbrojtëse nga dëmtuesit (insektet) për bashkësitë e dushkut (quercus) dhe gështenjës, të ndërmerren masa dhe projekte konkrete për mbrojtjen e tokës pyjore.

Përgatitja e projekteve për mbrojtje, ruajtje dhe konservim të disa llojeve të fito-cenozës (gështenjës);

- Përgatitja e projekteve për mbrojtjen e zonave ku jetojnë kafshët e egra, mes të cilave ka edhe lloje që konsiderohen të rrezikuara si dhe projekteve për mbrojtjen e tyre të veçantë;
- Hartimi dhe miratimi i Planit Lokal për Biodiversitet;
- Përgatitja e projekteve për vitalizimin e habitateve malore dhe për parandalimin të shkatërrimit të vendbanimit të shumë llojeve të florës dhe faunës;
- Ruajtja e brezit të gështenjës dhe trajtimi nga dëmtuesit.

14.6 Mbrojtja nga erozioni

Në Komunën e Deçanit, janë evidentuar zona erozive, të cilat janë prezantuar në Planin e Vlerësimit të Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyre dhe Fatkeqësitë e tjera në territorin e Komunës së Deçanit të vitit 2018, ku sipas këtij plani erozioni shtrihet në hapësirat e tokave bujqësore, të kultivuara apo braktisura, në tokat pyjore e livadhore, shtretërit e lumenjve, përrenjtë dhe tokat përreth tyre. Dëmet e shkaktuara prej tij ndjehen në: bujqësi, pylltari, është afërsisht 3%. Efekti shkatërrues i erozionit është rezultat i faktorëve klimatik natyror, kryesisht i ndikuar nga sasia, lloji, intensiteti dhe kohëzgjatja e reshjeve, lloji dhe shkalla e mbulueshmërisë së tokës me bimësi, pjerrësia e terrenit dhe përbërja pedologjike si dhe nga faktori njeri (degradimi i pyjeve, nxjerrja e zhavorrit, mbi kullotja, ndërtimet). Masat kundër erozionit janë:

- Revidimi, i Planit për Vlerësimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera në Territorin e Komunës së Deçanit 2018;
- Hartimi i projekteve për ndërtimin e pendave mbrojtëse në lumenj, përroskave dhe përrenjve;
- Hartimi i projekteve për ndërtimin e mbrojtësve në brigjet e lumit;
- Hartimi i projekteve për pyllëzimin e vendeve të zhveshura dhe atyre të degraduara;
- Hartimi i projekteve për mbjelljen e brezit gjelbërues që do të mbulonin rripin prej 10 m, largësi prej brigjeve të lumenjve kryesorë.

14.7 Masat për mbrotje nga vërshimet

Mjedisi çdo ditë e më tepër po rrezikohet nga fatkeqësitë natyrore, si rezultat i ndryshimeve klimaterike. Në kuadër të veprimeve për mbrojtje të mjedisit dhe parandalimit të fatkeqësive natyrore Komuna e Deçanit, duhet të jetë e përgatitur që të ballafaqohet me këto sfida dhe t'a minimizojë dëmin për jetën, shëndetin dhe pronën e qytetarëve, duhet të hartojë Planin Operativ për Mbrojtje nga vërshimet për pjesët e rrezikuara, po ashtu duhet të ndërmarrë masa hidroteknike kundër erozionit. Masat për mbrojtje nga vërshimet janë:

- Ndërmarrja e masave për ndalimin e ndërtimeve të objekteve banuese dhe objekteve të karakterit ekonomik afër brigjeve të lumenjve, në largësi prej më së paku 10 m, nga shtrati lumor (pikës së ujit);
- Ndërtimi i pendave për mbrojtje nga erozioni që shkaktojnë përrenjtë në fshatin Strellc i Epërm, përroi i Behovcit, Duraku dhe Suhaja në fshatin Dubovik;
- Pastrimi i shtratit të Lumëbardhit në pjesën nën Urën e Demës në fshati Isniq, Llukë e

Epërm, Llukë e Ulët dhe Lumbardh dhe shtratit të Lumëbardhit të Lloqanit, Prilep, Rastavicë, Baballoq dhe Gramaçel.

14.8 Zhurma

Zhurma është njëra nga brengat e vazhdueshme në nivel të përgjithshëm. Komuna e Deçanit nuk ka plan të veprimit për zonat me nivel të zhurmës si dhe aparature përkatëse për matjen e nivelit të zhurmës me të cilat obligohet sipas Ligjit për mbrojtje nga zhurma Nr. 02/L-102. Këto dokumente duhet të identifikojnë zonat e zhurmës, prezantimin e tyre në hartë dhe propozimin e masave për zvogëlimin e ndotjes nga zhurma si dhe përdorimin e materialit akustik gjatë ndërtimit të objekteve, gjithashtu përgjatë rrugëve të bëhet mbjellja e drurëve- brezi i gjelbërt.

14.9 Fatkeqësitë natyrore



Në komunën e Deçanit, fatkeqësitë natyrore përbejnë rrezik për jetën e njeriut, ambientin, objektet e trashëgimisë kulturore gjithashtu rrezik potencial përbejnë edhe këto dukuri: vërshimet, tërmetet, zjarret e pa kontrolluara dhe aksidentet e shkaktuara nga transportimi i mallrave të rrezikshëm. Për këtë arsye masat për zvogëlimin e rrezikut nga katastrofat, komuna e Deçanit ka të miratuar dokumentin për Vlerësimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera në Territorin e komunës së Deçanit²⁰, i cili shërben si udhëzues për identifikimin dhe rrezikshmërisë dhe planifikimit e masave parandaluese.

14.10 Fatkeqësitë tekniko-teknologjike

Sipas të dhënave zyrtare në Komunën e Deçanit, bizneset individuale në Deçan kanë ndërtuar 16 Pompa të karburanteve të lëngëta për naftë dhe benzinë dhe 5 pompa me butan gaz. Shumica prej tyre janë ndërtuar pa përfillur procedurat dhe dispozitat ligjore. Kapacitet e deponive të këtyre karburanteve nuk kalojnë më tepër se 30 m³ lenden ndezëse. Bartja e këtyre lëndëve djegëse bëhet përmes magjistrales Pejë-Gjakovë, rrugëve rajonale Llukë- Deçan, si dhe rrugëve tjera të fshatrave. Rreziku kryesor është shfaqja e zjarrit dhe shpërthimeve të ndryshme. Sipas shënimeve që posedon komuna nuk ka pasur ndonjë rast të shpërthimit të autocisternave, apo ndezjes së tyre. Qendra e Deçanit, për shkak të vendndodhjes se këtyre pompave, është ndër lokacionet me rrezikshmërinë më të lartë.

Në disa pjesë të komunës hasen edhe grumbullime të hekurit dhe automjeteve të vjetra që janë mjaft të rrezikshme për shëndetin e popullatës dhe mjedisin, ngase lirojnë sasi të rrezeve radioaktive dhe vaj të automjeteve dhe njëkohësisht e ndotin tokën.

14.11 Sipërfaqët me ndotje të lartë (HOT SPOTE)

²⁰ Plani i Vlerësimit i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e komunës së Deçanit viti i miratimit 2018.

Në komunën e Deçanit, nuk ka të evidentuar ndonjë sipërfaqe që mund të kategorizohet si zonë me ndotje të lartë.

14.12 Sipërfaqët e rrezikuara nga zjarri

Në komunën e Deçanit vazhdimisht ka pasur raste të shpërthimeve të zjarrit nëpër pjesët e bjeshkëve, zonave të pyllëzuara si dhe në disa raste edhe disa objekte individuale dhe disa zjarre fushore. Dëmet nuk janë të vogla por nëse përfshihen edhe zjarret në pyje kapin një kosto shumë të madhe. Zjarret që janë paraqitur në male dhe fusha dyshohet që janë shkaktuar nga pakujdesia e faktorit njeri. Sipërfaqet e fshatrave të komunës së Deçanit, që janë më të rrezikuara janë ato të zonave që shtrihen në pjesën e Bjeshkëve të Nemuna.

14.13 Erozioni

Erozioni është një faktor shumë i rëndësishëm për trajtim sepse kërcënon sipërfaqet bujqësore, infrastrukturën si dhe të mirat e krijuara dhe të planifikuara nga faktori njeri. Kjo dukuri është e pranishme më shumë në pjesën malore në forma dhe intensitete të ndryshme. Në shpejtimin e kësaj dukurie në shumicën e rasteve ka ndikuar faktori njeri, si rezultat i shfrytëzimit joracional të tokës bujqësore, prerjes së pakontrolluar të pyjeve, por edhe për shkak të shfrytëzimit të pakontrolluar të aluvialeve përgjatë lumneve. Më së shumti është e pranishme në si pasojë e degradimit të pyjeve, vegjetacionit dhe pjerrtësisë së terreni, që paraqitet në formë të pastrimit sipërfaqësor dhe shtretërve të përgjatë brigjeve të lumenjve dhe përrojeve dhe mungesës së pendave.

15.Trashëgimia natyrore

Trashëgimia natyrore në Komunën e Deçanit, është e pasur dhe e shumëllojshme ku duhet të veçohen rezervatet natyrore si: “Kozhnjeri”, “Maja Ropsit”, “Bjeshka e Prilepit”, “Zona e rëndësisë së Posaçme” (viti i shpalljes 2005). Prej bimëve drunore me të rëndësishmet në këtë pjesë janë: Gështenja (Castane Sativa), Hormoçi (Picea), Bredhi (Abis), Arneni (Pinus Peuce), Arneni i bardhë (Pinus Cheldreichii), Ahu (Fagus moesiaca) dhe llojet e ndryshme të fletorëve. Në Grykën e Deçanit dhe Lloqanit, është mjaft mirë e zhvilluar edhe verri (Alnus) dhe lloje të ndryshme të shëlgut (salix). Vlen të theksohet edhe aspekti gjeologjik, që është mjaft heterogjen dhe dallon nga pjesët e tjera të Alpeve Shqiptare (Bjeshkët e Nemuna), ku janë prezent disa lloje të shkëmbinjve, me të përhapurit janë shkëmbinjtë silikat, serpentini dhe karbonit (dollarit). Shkëmbinjtë silikat janë të përhapur edhe në “Majën e Ropsit” dhe aty është prezent një florë, gjithashtu karakteristike që dallon nga pjesët e tjera të Alpeve Shqiptare. Prej llojeve bimore, që janë të rrezikuara nga nxjerrja e rrënjëve për t’u shitur duhet cekë lloji Gentiana Lutea (gentiana e verdhëllincuri), e cila më parë kishte një shtrirje të gjerë, kurse tani ka mbete në disa lokalitete gati në zhdukje. Kjo bime është shëruuese (përdorej për plagë dhe sëmundje të lëkurës) dhe rrënjët e saja edhe sot përdoren dhe shiten me çmim të lartë. Përveç shfrytëzimit të egër të bimëve të larta (vaskulare) duhet bërë edhe edukimi i atyre njerëzve që bëjnë grumbullimin e kërpudhave. Duhet të mësohen si duhet bërë vjelja (jo të mirën më rrënjë, por të priten me thike në mënyrë që të mos të ndikojnë në zhdukjen e këtyre bimëve që kane rendësi ekonomike). Në aspektin vegjetacionit rëndësi kanë disa fitocenoza

që janë mjaft të rralla si wulfenis dhe arnenit (molikës).

15.1 Zona e veçantë e mbrojtur

Zona e Veçantë e Mbrojtur- shtrihet në Grykën e Deçanit, përgjatë rrjedhës së “Lumëbardhit të Deçanit”, me një hapësirë prej 790.7 ha , është shpallur me vendim të UNMIK-ut në vitin 2005. Sipas Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, “Zonë e Veçantë e Mbrojtur” e përkufizon se do të jetë një zonë e përcaktuar me hartë, ose Plani Zhvillimor i Komunës së Deçanit 2020-2028 171 me një zonë të përcaktuar që rrethon një monument, ndërtesë, grup ndërtesash, tërësi, fshat, ose qendër historike të qytetit, që mbrohet nga çdo zhvillim, apo aktivitet i cili mund të dëmtojë kontekstin e tij historik, kulturor, arkitektural, apo arkeologjik, mjedisin natyror, apo kuadrin vizual estetik. Shpallja e kësaj zonë më shumë ka qenë vendim politik që është ndërmarrë ku paraprakisht nuk është bërë një hulumtim të vlerave shkencore biologjike që ka zona. Manastiri i Deçanit, i cili është i mbrojtur nga UNESCO. Kjo pjesë karakterizohet më bukur të rrallë të natyrës me shkëmbinjtë gëlqerorë, që “Lugina e Lumëbardhit”, është e ndërtuar në kanjonin e glacialit të dikurshëm në luginën, që është 30 km. Vlen të theksohet se në aspektin gjeologjik, është mjaft heterogjen dhe dallon nga pjesët e tjera të Alpeve Shqiptare (Bjeshkët e Nemuna). Në këtë pjesë gjendet edhe kompleksi i trungjeve të pishës së zezë (*pinus nigra*) pyjore, i vënë në mbrojtje ligjore, si zonë e mbrojtur e pishës pyjore. Ky pyll është mbjellë në pjesën e parë të shek. XIX-të, me sipërfaqe prej 15 ha, kurse pjesët jugore dhe lindore të këtij pylli janë të pasur me gështenja. Përgjatë rrjedhës së “Luginës së Lumëbardhit”, janë të pasura me trungje të verrit (*alnus glutinosa*, *alnus viridis*) dhe shelgu (*Salix*) po ashtu edhe bimët barishtore janë shumë të pranishme të kësaj pjesë që i japin një diversifikim florës të kësaj pjesë. Kjo pjesë duhet të veçohet së është e pasur më faunë lumore ku veçohen llojet e peshqve. Këto rrjedha të ujit asnjëherë nuk shterin, as në kohë thatësie, sepse kanë rrjedha anësore. Edhe pse është në kundërshtim ligjor, janë lejuar punimet për ndërtimin e hidrocentralit të Kelkos Company sh.p.k me ç‘rast me prerjen e gjelbërimit të lartë në pjesën anësore të rrugës, ku në shumë vende ka ardhur deri të procesi i rrëshqitjeve dhe masave të dheut.

15.2 Rezervati “ Bjeshka e Kozhnjerit”

Rezervati Strikt “Bjeshka e Kozhnjerit” – Maja e Ropsit –gjendet në shkëmbinjtë gëlqerorë dhe serpentini, në lartësinë mbidetare 1708 – 2501 metra dhe ka sipërfaqe 1,110.57 hektarë. Në këtë gjinden bashkësitë bimore si: Bashkësia e Hormoqit (*Picetum excelsae*), Bashkësia e Hormoqit dhe Arnenit (*Piceo-Pinetum peucis*) dhe Bashkësia e Arnenit (*Pinetum peucis*). Në kuadër të vegjetacionit të bimëve barishtore dallohen këto lloje: *Saxifraga stellaris*, *Valeriana tripteris*, *Malva moschata*, *Cirsium candelabrum*, *Tanacetum vulgare*, *Salix eleagnos*, *Lilium martagon*, *Centaurea ıpecensis*, *Verbascum baldacii*, etj.

15.3 Malet e Prilepit

Malet e Prilepit-Rezervati Strikt “Malet e Prilepit” gjendet në shkëmbinjtë gëlqerorë, në lartësinë mbidetare 1815 metra dhe ka sipërfaqe 106.04 hektarë. Në këtë zonë janë prezentë bashkësitë bimore si në vijim: Panja e heldrahit (*Acer heldreichii*), Arneni (*Pinus peuce*), Pisha e bardhë (*Pinus silvestris*), Hormoqi (*Picea abies*), Bredhi (*Abies alba*), Panja malore (*Acer*

pseudoplatanus), Panja gjetherrapi (*Acer platanoides*), Ahu (*Fagus moesiaca*), Mushtekna (*Betula pendula*), Plepi i egër (*Populus tremula*), Shelgu i egër (*Salix caprea*) etj.

- Të ndërmerren masa për parandalimin e eksploatimit ilegal i llojit të bimës mjekësore Sanëza (*Gentiana lutea* L.), si dhe në të gjitha pjesët tjera ku gjendet e zhvilluar.
- Krijimi i një Rrjeti Ekologjik Ndërkufitar koordinim dhe bashkëpunim.
- Projekte konkrete zhvillimore mbi energjinë e ripërtëritshme, pylltarinë, burimet natyrore dhe bulmeti.
- Krijimi i hartës së partnerëve në zonën aktive ndërkufitare me qëllim të mbrojtjes së mjedisit, biodiversitetit dhe promovimin e turizmit.
- Identifikimi i biodiversitetit ndërkufitar në Kosovë dhe Mal të Zi si dhe hartografimi i tij në platformë Web GIS.

Ndërtimi i shtigjeve për ecje, çiklizëm nga zona e posaçme der në km 6.

Zonat dhe monumentet natyrore të mbrojtura

Komuna e Deçanit është e njohur me trashëgimi natyrore ku një pjesë e kësaj pasurie është nën mbrojtje ligjore. Disa nga zonat e mbrojtura të natyrës në territorin e komunës së Deçanit datojnë që nga vitet e '50 të shekullit të kaluar (tabela 1).

Tabela 9. Zonat dhe monumentet e mbrojtura në Deçan para realizimit të projektit²¹

Emërtimi i Zonës/ objektit	Komuna/zona	Kategoria sipas IUCN	Viti i mbrojtjes	Përshkrimi i shkurtër i vlerave
REZERVAT STRIKT I NATYRES				
/Maja e Ropsit	PK. "Bjeshkët e Nemuna"	I	1955 (2016)	Rezervat bimor i llojeve të molikës, Bredhit, Pishës, Ahut, dhe i Dhisë së Egër (<i>Rupicapra rupicapra</i> L.)
Bjeshka e Kuzhnjerit	PK. "Bjeshkët e Nemuna"	I	1955 (2016)	Rezervat natyror, i llojit dhia e egër (<i>Rupicapra rupicapra</i> L.).
Malet e Prilepit	PK. "Bjeshkët e Nemuna"	I	1963 (2016)	Rezervat bimor me përbërje të pastër të Panjës malore (<i>Acer heildreichii</i>) dhe Arrnenit (<i>Pinus peuce</i>)
PARK KOMBETAR				
Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"	Deçan, Pejë Istog, Junik, Gjakovë	II	2013	Karakterizohen me lloje të shumta relikte dhe endemike të florës, vegjetacionit dhe faunës. Me vlera gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrologjike, speleologjike, kulturore, edukativo-arsimore dhe turistike.
MONUMENTE NATYRORE				
Bliri (<i>Tilia argentea</i>) në Isniq	Isniq- Deçan	III	1968	Monument natyror me karakter botanik
Trungjet e Blirit (<i>Tilia argentea</i>) në Isniq	Isniq- Deçan	III	1968	Monument natyror me karakter botanik
PEIZAZH I MBROJTUR				
Pishat e Deçanit	Deçan	V	1969	Lokalitete me vlera floristike, edukativo-arsimore dhe turistike

²¹ Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK-MMPH)

15.4 Lista e objekteve të monumenteve natyrore

Shumëllojshmëria e monumenteve natyrore të karakterit botanik, hidrologjik, gjeomorfologjik në Komunën e Deçanit, si dhe peizazheve të ndryshme natyrore që kanë përhapje në territorin e komunës, konsiderohen vlera të një trashëgimie natyrore. Ka pasur hulumtime nga Instituti për Mbrojtjen e Natyrës (Tani Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit) ka bërë hulumtimin dhe evidentimin vlerave të reja të natyrës.

Përveç vlerave të natyrës të mbrojtura paraprakisht, gjatë procesit të evidentimit të vlerave natyrore në territorin e komunës së Deçanit janë evidentuar 17 vlera të reja, disa prej të cilave për shkak të vlerave të veçanta do të janë të mbrojtura institucionale, për shkak vlerave të larta dhe të veçanta.

Tabela 10. Vlerat e natyrës të evidentuara në komunën e Deçanit 2020²².

Nr	Vendbanimi	Objekti natyrorë	Koordinatat		Lartësia mbidetare
			X	Y	
1.	Llukë e Ulët	Gleni i Llukës	0445113	4710617	560
2.	Kodralli	Trungu i blirit	0445529	4708672	544
3.	Kodralli	Trungu i bungëbutë	0445470	4709057	545
4.	Strellc i Ultë	Trungu i blirit	0441801	4714155	653
5.	Strellc i Epërm	Trungu i blirit	044181	4714155	653
6.	Deçan	Burimi i ujit mineral	0439827	4710943	644
7.	Decan	Trungu i blirit	0441261	4709725	633
8.	Maznik	Trungu i dushkut	0453817	4710299	434
9.	Dashinoc	Trungu i dushkut	0450452	4709613	480
10.	Ratish i Ultë	Trungu i mrizit (bungut)	0450134	4707598	491
11.	Ratish i Epërm	Kompleksi i trungjeve	0448136	4708422	522
12.	Ratish i Epërm	Kompleksi i trungjeve	0448136	4708422	522
13.	Shaptej	Kompleksi i trungjeve te dushkut	0449262	4705079	455
14.	Gramaqel	Kompleksi i trungjeve-varrezat e jagozit	0448058	4702903	495
15.	Carrabreg i Eperm	Trungu i dushkut	0441720	4708619	621
16.	Drenoc	Trungjet e blirit dhe trungu i pishes	0441783	4707251	606
17.	Rastavic	Trungu i dushkut	0444732	4704069	523

15.5 Biodiversitetit

Pozita gjeografike, faktori gjeologjik, pedologjik, hidrologjik, relievi dhe klima kanë ndikuar që ky territor të ketë një diveristet të pasur biologjik me bimë barishtore shumëvjeçare (hemikriptofita), rreth 70 % dhe bimë drunore dhe shkurret fanerofita rreth 7 %. Biodiversitetit përfshinë shumëllojshmërinë brenda dhe midis llojeve, si dhe shumëllojshmërinë ekosistemeve. Sipas hulumtimeve të bëra janë përshkruar 795 lloje të bimëve të ndryshme, endemike subendemike, që u përkasin elementeve endemike të ndryshme, gjithashtu edhe një numër i madh i llojeve relikte. Po ashtu, ky rajon është i pasur edhe me lloje të shumta të bimëve mjekuese (boronica, linsuri, kamomili dhe çajrave te tjera natyrore etj.).


Në Librin e Kuq të Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës janë ofruar të dhëna për mbrojtjen e natyrës, identifikimin e zonave të rrezikuara, të dhëna objektive për llojet e rrezikuara me standarde globale, motivimin e njerëzve që përmes aktiviteteve të ndryshme të mbrojnë natyrën, të dhëna për llojet e rrezikuara, shkallën e rrezikshmërisë, faktorët që rrezikojnë speciet dhe habitatet, një bazë të dhënash për të monitoruar gjendjen e llojeve të

²² Instituti për Mbrojtje të Natyrës

rrezikuara.

Numri i taksonëve të përfshira në Librin e Kuq të Florës Vaskulare të Kosovës, sipas Raunkierit janë paraqitur në figurë. Figura tregon se dominojnë Hemikriptofitet me 155 taksonë, pastaj Gjeofitet me 32 dhe Kamefitet me 27. Në numër më të vogël janë Fanerofitet me 19 taksonë dhe më së paku Terofitet me vetëm 4 taksonë.

23. Fig. 3 Taksonet e përhapjes të bimëve sipas ndarjes së Raunkierit



Gjatë hulumtimeve intensive të kryera në terren grupi i punës ka konstatuar edhe disa lloje të reja për Florën e Kosovës në përgjithësi, por në raste të caktuara dhe më gjerë – për florën e Evropës Juglindore. Kemi konstatuar 9 taksonë bimorë të reja për Florën e Kosovës.

Këto taksonë janë: *Crocus flavus*, *Quercus robur* subsp. *Pedunculiflora*, *Cyanus lingulatus*, *Juniperus sabina*, *Ranunculus degenii*, *Viola herzogii*, *Pulsatilla alpina*, *Minuartia baldacii* subsp. *Baldacii* dhe *Gypsophila spergulifolia*.

Tabela 11. Bimët endemike të florës vaskulare, karakteristike për Kosovën të cilat janë të përhapura edhe në Alpet Shqiptare-Komuna e Deçanit²³.

Nr.	Familja/lloji	Lulëzimi /familja	Rio topi	Përhapja në Deçan	Bimë endemike	Zbulimi	Gjendja
DIPSACACE AE							
1.	Cephalaria pastricensis Dorfl. Et Hayek. 1921. (Cefalaria e Pashtrikut)	VI – VII / VIII	Në vende me bar, shkurra, pyje të zones malorere dhe subalpike.	Pashtrik, Alpet Shqiptare (Bjeshkët e Lumbardh it, Zhleb).	Deçan	Dorfler, I., Hayek, A. (1921), nga materiali i mbledhur në Pashtrik dhe Alpet Shqiptare.	Populacione të rrezikuara (Duhet të jenë nën mbrojtje të ligjit)
FABACEA							
1.	Astragalus fialae Degen 1900. (Arithja e Fialit)	VII / VIII	Në shkëmbinj ë të zones alpike	Alpet Shqiptare (Bjeshkët e Lumbardh it).	Deçan	Degen, A. (1900), nga materiali I mbledhur në Alpet Shqiptare.	Populacione të rrezikuara (duhet të mbrohen me ligj).
LAMIACEAE							
1.	Thymus rochlenae Vel. 1903. (Listra e Rohlenes)	VI / VII	Në kullosa, livadhe të zones malor dhe subalpike	Rrethinat e Deçanit.	Deçan	Velenovsky , J. (1903).	Populacione të rrezikuara (duhet të mbrohen me ligj)
SAXIFRAGA CEAE							
1.	Wulfenia bleicii Lak. 1971. (<i>Vulfenia e Bleçiqit</i>) (Në Kosovë janë të përhapura dy nënlloje të këtij lloji: W. bleicii subsp. Bleicii dhe W. bleicii subsp. Rohlenae, të cilat janë të përhapura në Alpet Shqiptare)	VI – VIII / VIII	Në vende me bar, pyje e shkurre të zones subalpike	Alpet Shqiptare	Deçan	Lakusič, R. (1971)	

²³ Bimet Endemike të florës vaskulare karakteristike për Deçanin.

15.6 Flora

Në *Librin e Kuq të Florës Vaskulare*²⁴, në e Republikën e Kosovës e përbëjnë algat, likenet, kërpudhat, fiernat, farëzhveshurat dhe farëveshurat të cilat janë bazë e jetës, formojnë mbështjellësin e gjelbër të tokës që ka ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e organizmave shtazorë dhe njeriut. Pa mohuar rëndësinë e asnjë grupi bimor që kanë për jetën në planetin tonë, e në kuadër të kësaj edhe për jetën në komunën e Deçanit; bimët vaskulare, në veçanti bimët me farë (farëzhveshurat dhe farëveshurat) kanë rolin kryesor në vegjetacionin e Deçanit i cili ka ndikim direkt në klimën, ajrin, ujin dhe tokën. Aeriali i shtrirjes i florës vaskulare te pranishme ne territorin e komunës se Deçanit te cilat janë pjesë e Librit të Kuq veçohen këto bime: *Dinathus scardicus*, *Crocus scardicus*, *Draba korabensis*, *Potentilla montonegrina*, *Selaginella selaginoides*, *Pedicularis oederi*, *Silene waldsteinii*, *Salix herbacea*, *Lilium albanicum*, *Ranunculus incomparabilis*, *Pinguicula balcanica*, *Allysum scardicum*, *Anemone narcissiflora*, *Draba doerfleri* etj. Pjesët më të larta shkëmbore të zonës paraqesin habitat te dhive të egra dhe shqiponjës së maleve (*Aquila crysaetos*), ndërsa pyjet dhe kullosat në pjesët e poshtme të zonës shfrytëzohen nga ariu i murrme dhe kaprojtë, gjithashtu duhet te veqohen edhe këto rezervate, si: Panja e heldrahit (*Acer heldreichii*), Armeni (*Pinus peuce*), Pisha e bardhë (*Pinus silvestris*), Hormoqi (*Picea abies*), Bredhi (*Abies alba*), Panja malore (*Acer pseudoplatanus*), Panja gjetherrapi (*Acer platanoides*), Ahu (*Fagus moesiaca*), Mushtekna (*Betula pendula*), Plepi i egër (*Populus tremula*), Shelgu i egër (*Salix caprea*) etj. Bashkësia e hormoqit (*Piceum excelsae*), Bashkësia e hormoqit dhe arnenit (*Piceo-Pinetum peucis*) dhe Bashkësia e arnenit (*Pinetum peucis*). Në kuadër të vegjetacionit të bimëve barishtore dallohen këto lloje: *Saxifraga stellaris*, *Valeriana tripteris*, *Malva moschata*, *Cirsium candelabrum*, *Tanacetum vulgare*, *Salix eleagnos*, *Lilium martagon*, *Centaurea ipecensis*, *Verbascum baldacii*, etj.

15.7 Fauna

Llojet më të rëndësishme të faunës të cilat gjenden në *Librin e Kuq*²⁵ e ku kanë habitat edhe ne territorin e komunës se Deçanit janë: ariu i murrme (*Ursus arctos*), shqarhi (*Martes foina*), vjedulla (*Meles meles*) etj. Nga llojet e ornitofaunës veçohen: fëllëza e gureve (*Alectoris graeca*), pëllumbi i egër (*Columba oenas*), korbi (*Corvus corax*), qyqja (*Cuculus canorus*), qykapikthi i larmë malor (*Dryobates leucotos*), lauresha e pyjeve (*Lullula arborea*) etj. Nga hulumtimet e kryera, posaçërisht me vendosjen e kamerave kurth (monitoruese), në zonat malore në Gryken e Deçanit, tek Koznjeri është konstatuar prania e shumëllojshme e faunës, në veçanti të gjitarëve (ariu i murrme, ujku, dhelpra, kaprolli, dhia e egër, derri i egër, shqarhi i bardhë, shqarhi i artë, lepuri, ketri, vjedulla, gjeri i lajthive etj.) kurse prania e shpendëve në Bjeshken e Belegut, Prilepit, Baballoqit dhe ne Bjeshken e Deçanit janë të pranishme këto: shqiponja e artë, shqiponja minjngrënëse, skifteri malor, skifteri i përhimet, huti i madh, huti pyjor, pula e pyjeve, shkurtëza, thëllëza e gurit, etj. Në bazë të gjurmëve të gjetura në terren është verifikuar edhe prania e rrëqebullit ballkanik (*Lynx Lynx balcanicus*), ka ndryshuar habitatin nga pjesa e Rugovës është vërejtur edhe ne bjeshkët e Deçanit, ku habitat i kësaj kafshe të rrallë dhe të rrezikuar për zhdukje, është pjese e Listës se kuqe të kafshëve²⁶.

²⁴ Libri i Kuq i bimeve vaskulare i Republikës së Kosovës.

²⁵ Libri i Kuq i bimeve vaskulare i Republikës së Kosovës.

²⁶ Raporti për Gjendjen e Natyrës 2017-2020 MMPH.

15.8 Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemura”

Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” paraqet një rajon gjeografik me bukuri të rrallë, me pasuri të madhe të elementeve të peizazhit si: bjeshkë të larta të zhveshura me dëborë në maja, pyje mbresëlënës me lloje të ndryshme drurësh ku me bukuri dominojnë pishat e larta, lugina magjepsëse e gryka të thella mahnitëse, kullosa e livadhe me lule të të gjitha ngjyrave, burime e rrjedha të shumta ujore që formojnë përrocka e lumenj, shpella të bukura dhe liqene përrallore në vende të larta.

Parku ka potenciale të mëdha për zhvillimin e turizmit, si të atij dimëror ashtu edhe të atij veror. Konfiguraconi i terrenit në Bjeshkët e Belegut, Bjeshka e Carrabregut, Bjeshka e Deçanit, Kurvalla, Dervish Komi janë shumë të përshtatshme për sportin e skisë gjatë dimrit, kurse gjatë verës, këto hapësira brenda parkut, ofrojnë mundësi të jashtëzakonshme për shijimin e bukurive të peizazheve, rehabilitim, qoftë duke shetitur, ecur (haiking).

Potencialet ekzistojnë, por infrastruktura dhe përmbajtjet e tjera që mundësojnë shfrytëzimin e këtyre potencialeve, mungon infrastruktura përkatëse zhvillimore. Vetëm në Bjeshkën e Belegut ka patur ndërtim të infrastrukturës për zhvillimin e skijimit dhe ajo nuk është e mjaftueshme, sepse kapaciteti i ski-liftave atje, nuk ekziston krahasuar me mundësitë që i ka ai vend.

Infrastruktura në nivel jo të kënaqshëm dhe në përgjithësi niveli i ultë i zhvillimit ekonomik në hapësirën e parkut, kanë shkaktuar në ngecje të turizmit të kësaj hapësire.

Komuna e Deçanit brenda hapësirës së Bjeshkëve të Nemuna ka këtë sipërfaqe me 16786 ha apo 27%).

15.9 Asetet e trashëgimisë kulturore

Në komunën e Deçanit trashëgimia materiale është krijuar në mes të qytetërimeve antike, e cila trashëgon një thesar të pasur kulturor dhe është pjesë e trashëgimisë kulturore e jona e identifikuar në Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrotjtje të përkohshme- arkeologjike me nënkategoritë përkatëse. Kjo trashëgimi e pasur, gjendet në çdo pjesë të komunës së Deçanit, burime arkeologjike-fshati Belle, arkekonike- kullat, në monumente fetare, momumente natyrore dhe Lista e Kuqe e florës dhe faunës. Trashëgimi kulturore, konsiderohen të gjitha objektet të cilat në një formë, apo një tjetër, përcjellin pasqyren e zhvillimit dhe ndërtimit nga kohëra të ndryshme e deri në ditët e sotme.

Këto vlera të trashëgimisë kulturore që zotëron komuna jonë janë një ndër elementet më të rëndësishme për zhvillimin e turizmit bazuar në “Strategjinë Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore”, 2017-2027” trashëgimia definohet si shtyllë e rëndësishme e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

Tabela në vijim përfshin numrin e objekteve të trashëgimisë kulturore sipas kategorive (nën mbrotjtje të përhershme dhe të përkohshme).

Tabela Nr. 12 Lista e numrit të objekteve të trashëgimisë kulturore sipas kategorive (nën mbrojtje të përhershme dhe të përkohshme) e Trashëgimise Kulturore ²⁷

Nr.	Trashëgimia Kulturore, sipas kategorive, 2020	Numri
1.	Trashëgimia arkeologjike	10
2.	Trashëgimia arkitektonike	58
3.	Zona e veçantë e mbrojtur	1
4.	Monumente të natyrës	17
5.	Rezervate natyrore	3
6.	Peisazh i mbrojtur	1
7.	Verrat e Llukës-Memorial historik	1

Një pjesë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore kërkon që edhe sot të mbrohet nga dëmtime të metejshme, të konservohet për të ruajtur vlerat arkeologjike, arkitekturore historike të cilat shtrihen në kohë që nga periudha parahistorike e deri në fund të shek. XX, pasqyrohet ndikimi i ankititektit të vonë, romak, bizantin, sllav, otoman, por edhe asaj që janë të karakterit të ndryshëm si: objektet e kultit (kishat, xhamitë, vazrreza etj.) shtëpi të arkitekturës tradicionale shqiptare-kullat, mullinjtë etj.

Gjetjet arkeologjike dëshmojnë që komuna e Deçanit është një vend i vjetër. Këtë më së miri dëshmon prania e gjurmëve në Kërshin e Qelisë (Afreskat e veçanta), Muret e Kalasë në Belle, pastaj artefaktet në fshatin Carrabreg ku hasen rrënojat e varrezave që përcjellin konfiguracionin e kodrës dhe formojnë Tumat Ilire dhe pastaj fshatrat Beleg, Lëbushë, Prapaqan, Irzniq. Objekti i Manastirit i ndërtuar në fillim të shek. XIV, i cili është në mbrojtjen e UNESCO-s, është vlerë e veçantë për vjetërsinë kulturore të Deçanit.

Deçani ka asete të trashëgimisë kulturore-historike, materiale dhe shpirtërore të cilat janë pasuri e madhe për këtë komunë, por edhe më gjerë. Trashëgimia që zotëron Deçani e sidomos ndërtesat e banimit janë dëshmia më e saktë për jetën e zhvilluar në këtë anë qysh në kohërat e hershme. Këto asete mund të jenë pika të pushimit që ofrojnë ushqim tradicional dhe të plotësojnë agjendat turistike regjionale, apo më gjerë. Në mesin e këtyre aseteve mund të veçohen: *Kulla e Osdautaj*, *Kulla e Tahirsylaj* dhe *Kulla e Kuklecëve* që gjendet në fshatin Isnig, pastaj *Kulla e Demukaj* dhe *Kulla e Mushkolaj* në Deçan, *Kulla e Mazrekaj* në Drenoc, *Kulla e Gecaj* në Llukën e Poshtme, *Kulla e Dem Ali Pozharit* në Pozhar, të gjitha të ndërtuara nga fundi i shek. XIX. Sot ato janë funksionale dhe shëmbëllojnë si asete me vlerë në trashëgimin kulturore të Deçanit.

Duke ju referuar Planit Hapësinor Zona e Mbrojtura “Manastiri i Deçanit” gjatë përcaktimit të kushteve duhet të merren për bazë parametrat që dalin nga Ligji për Zona të Veçanta.

²⁷ Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme-Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit Nr. 110/2018, Datë: 03.10.2018.

15.10 Lista e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme 2020²⁸

I. Kategoria: Trashëgimia arkeologjike²⁹

A. Nënkatëgoria: Monument/Ansambël³⁰

Tabela Nr. 13 - Lista e trashëgimisë për mbrojtje të përkohshme

Nr.	Emërtimi	Datimet	Vendi-Komuna	Statusi Nr. i vendimit	Nr. Unik në Databazë
1.	Murgorja e Zojës së Bekuar në Belle	Mesjetë	Belle, Deçan	02-774/66	002837
2.	Fortifikim i antikitetit të vonë	Antikitet i vonë	Strellc i Epërm- Deçan		003504
3.	Lokaliteti arkeologjik në Rastavicë	Romake-Antikë e vonë	Rastavicë -Deçan		003179
A. Nënkatëgoria : Monument / Rezervat					
4.	Lokaliteti i periudhës romake në Irzniq	Romake	Irzniq, Deçan		004196
5.	Lokaliteti i periudhës romake në Irzniq	Romake	Irzniq, Deçan		002995
6.	Tuma e vetmuar në Irzniq	Parahistori	Irzniq, Deçan		003234
7.	Fortifikim parahistorik	Parahistori	Baballoq, Deçan		003650
8.	Lokaliteti arkeologjik parahistorik	Parahistori	Baballoq, Deçan		003235
9.	Fortifikim i antikitetit të vonë	Antikiteti i vonë	Strellc i Epërm, Deçan		003233
10.	Kalaja antike në Belle	Antikiteti i vonë	Belle, Deçan		003164
II. Kategoria : Trashëgimia Arkitekturore					
A. Nënkatëgoria : Monument / Ansambël					
11.	Kulla e Zymer Himës	Shek. XVIII	Deçan	01-77/82	002828
12.	Mulliri i Shabanajve	Shek. XIX	Deçan		001458
13.	Xhamia e Deçanit	Shek. XIX	Deçan		001539
14.	Kulla e Demukajve	Shek. XIX	Deçan		002058
15.	Mulliri i Gjokajve	Shek. XVIII	Deçan		001536
16.	Kulla e Ram Shabanit	Shek. XIX	Prapaçan, Deçan	02-138/80	002826
17.	Kulla e Haxhi Osë Miftarit	Shek. XIX	Isniq, Deçan	03-179/84	002832
18.	Kulla e Ramiz Kukleci	Shek. XIX	Isniq, Deçan		003191
19.	Kulla e Kuklecve	Shek. XVIII	Isniq, Deçan		002613
20.	Xhamia e Isniqit	Shek. XVII	Isniq, Deçan		003171
21.	Kulla e Musë Mehmetit	Shek. XIX	Isniq, Deçan		003308
22.	Kulla e Smajl Nimon Balaj	Shek. XIX	Isniq, Deçan		003309
23.	Kulla e Rexhë Ibër Balaj	Shek. XIX	Isniq, Deçan		003310
24.	Kulla e Zenun Ahmetit	Shek. XIX	Isniq, Deçan		003311
25.	Kulla e Sali Gecës	1800	Isniq, Deçan		003312
26.	Kulla e Mujë Mehmetit	Shek. XIX	Isniq, Deçan		003313
27.	Mulliri i Tahirsadrive (Rrustem Dervishaj)	Shek. XIV	Isniq, Deçan		003180
28.	Kulla e Sadik Ibishit	Shek. XIV	Isniq, Deçan		003405
31.	Xhamia e Pozharit	Shek. XVIII	Pozhar, Deçan		003170

²⁸ Vendim-Regjistri I Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkoshme-Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit Nr. 129/2020, Datë: 10.10.2020

²⁹ Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkoshme-Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit Nr. 110/2018, Datë: 03.10.2018

³⁰ Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkoshme-Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit Nr. 68/2016, Datë: 10.10.2016

32.	Kulla e Demë Ali Pozharit	Shek. XIX	Pozharë,Deçan		003151
33.	Mulliri i Beqir Halil Haxhosaj	Shek. XIX	Prokolluk,Deçan		00964
34.	Xhamia e Drenocit	Shek. XX	Drenoc,Deçan		001371
35.	Kompleksi i Kullave në lagj. Mazrekaj	Shek. XIX	Drenoc,Deçan		003314
36.	Kulla e Tahir Baçit	Shek. XIX	Drenoc,Deçan		004140
37.	Mejtepi në fshatin Llukë e Epërme	Shek. XIX	Llukë e Epërme,Deçan		001622
38.	Kulla e Ali Gecit	Shek. XVIII	Llukë e Ulët,Deçan		002055
39.	Kulla e Florim Jnuz Gecaj	Shek. XIX	Llukë e Ulët,Deçan		003585
40.	Xhamia e Carrabegut	1816	Carrabreg, Deçan		001737
41.	Kulla e Muhamet Dervish Çekaj	Shek. XIX	Irzniq,Deçan		003167
42.	Mulliri i Sadik Berishës	Shek. XIX	Irzniq,Deçan		001302
Aset i listuar në ANEX 1					
43.	Kulla e Shaban Murat Gjukaj	Shek. XIX	Strelc i Ulët,Deçan		003149
44.	Kompleksi i Dëshmorëve	Shek. XX	Glllogjan,Deçan		003150
45.	Qardaku i Azem Hamzë Ahmetaj	Shek. XIX	Glllogjan,Deçan		001367
46.	Xhamia e fshatit Lëbushës	1793	Lëbushë,Deçan		001385
47.	Kulla e Jusuf e Bardhosh Gërvallës	Shek. XX	Dubovikë,Deçan		003211
48.	Kulla e Donikë Jusuf Gërvallës	Shek. XX	Dubovikë,Deçan		003584
49.	Xhamia e Vokshit		Voksh,Deçan		002136
50.	Tyrbja e Sadri Pepaj	Shek. XIX	Kodrall,Deçan		001291
51.	Kulla e Miftar Alisë	Shek. XIX	Kodrall,Deçan		003315
52.	Kulla e Bajram Xhafer Lekaj	Shek. XIX	Lumbardh,Deçan		003527
53.	Xhamia e Baballoqit	1868	Baballoq,Deçan		003169
54.	Kulla e Hamëz Mataj		Baballoq,Deçan		004132
55.	Kulla e Gjyle Kdrijaj	Shek. XIX	Rastavicë,Deçan		003317
56.	Kulla e Himë Nimonit	Shek. XIX	Pobergjë,Deçan		004133
57.	Kulla e Haxhë Alisë	Shek. XIX	Pobergjë,Deçan		004174
58.	Kulla e Ali Jusuf Mataj	Shek. XIX	Pobergjë,Deçan		004134
59.	Kulla e Ali Avdijaj	Shek. XIX	Gramaqel,Deçan		004148
60.	Mulliri i Avdyl Zenel Jasiqit	Shek. XVIII	Gramaqel,Deçan		001289
61.	Kulla e Ram Stojkaj	Shek. XIX	Lloqan,Deçan		001408
62.	Mulliri i Daut Osë Hulaj	Shek. XIX	Hulaj,Deçan		001317
64.	Kulla e Azem Ram Lokaj	Shek. XIX	Voksh,Deçan		004614
65.	Kulla e Sylë Tahirsylaj	Shek. XIX	Isnqi,Deçan		004646
66.	Kulla e Hasan Mehmetit	Shek. XIX			
67.	Shtabi i Zonës Operative të Dukagjinit				004440
68.	Kulla e Bajram Qerim Istrefaj	Shek. XIX	Strelc i Epërm,Deçan		004446
69.	Kulla e Reshat Istrefaj	Shek. XIX	Strelc i Epërm,Deçan		004447
70.	Koshi i drithit Enver Likaj	Shek. XIX	Carrabreg,Deçan		004453
71.	Kulla e Musë Mehmetit	Shek. XIX	Isnqi, Deçan		003308

14. Identifikimi i Problemeve

14.1 Uji

Problemi	Shkaku (Listë shkaqesh që sjellin problemin, që mund të jenë, fizik dhe njerëzore)	Shkalla e ndikimit	Ndikimi (Paraqet ndikim negativ në mjedis, shëndet, mirëqenje etj.	Prioriteti (I matur me shkallen: *Pak i rëndësishëm **Mesatarisht i rëndësishëm ***Shumë i rëndësishëm.
Lumi Ndotja e lumejve	Shkarkimi i ujërave të ndotura Hedhja e mbetjeve Prurjet e ngurta nga përranjët	E mesme	Ndotja e ujit të lumit deri tek zonat e banimit. Zvogëlimi i oksigjenit në ujë, me ndikime mbi florën e faunën ujore.	
Ndotja e ujit të lumit nga faktorët natyrorë dhe erozioni	Demtimi i brezit mbrojtës Bartja e dheut	E Lartë	Humbja e fondit të tokës bujqësore Humbja e masës humusore	
Lumenjtë, përranjët (ujërat e rrjedhshme sipërfaqësore) Vërshimi i ujit në periudhën e shirave sizonal dhe të kanaleve të ujërave sipërfaqësore	Devijimi i lumit nga shtrati Mbyllja e kanaleve Përmblytja e tokave bujqësore, demtimi i kulturave bujqësore të mbjell Demtimi i rrugëve rurale	Lartë	Përmblytja e tokave bujqësore, demtimi i kulturave bujqësore të mbjella	
		Lartë	Përmblytja e shtëpive Demtim i sistemit rrugor Bartja e tokave bujqësore	
Sistemi ujitës –kanalet	Mungesa e mureve mbrojtës për të penguar prurjet e ngurta që sjellin proçkat, vijat e ujit, rrëketë.		Ulja e sasisë së ujit Zvogëlimi i sipërfaqes së ujitur Rendiment i ultë në prodhimet bujqësore	
	Mos mirëmbajtja prej ndërmarrjes së ujërave		Shkaktohet erozion	
Zvogëlimi i sasisë së ujërave nëntokësore duke mos arritur kështu deri në shtresat më të thella të tyre. Ushqimi i dobët i ujërave nëntokësore prej reshjeve atmosferike	Shkatërrimi i pyjeve, prezenca e sipërfaqeve të pjerrëta të zhveshura, shkakton rrjedhje sipërfaqësore në lum.		Ulen të ardhurat nga sektori i bujqësisë Rendimente të ulëta të kulturave që nuk kanë rritje intensive	

14.2 Ajri

Problemi	Shkaku (Listë shkaqesh që sjellin problemin, që mund të jenë, fizik dhe njerëzore)	Shkalla e ndikimit	Ndikimi (Paraqet ndikim negativ në mjedis, shëndet, mirëqenje etj.)	Prioriteti (I matur me shkallen: *Pak i rëndësishëm **Mesatarisht i rëndësishëm ***Shumë i rëndësishëm.)
Ndotja e ajrit me gazra të dëmshme dhe aromatike, (amoniak, dioksidet) etj.	Djegia e mbeturinave	E mesme	Dëmtohet shëndeti i komunitetit, rritet mundësia e infeksioneve të ndryshme	
ndotja e ajrit nga pluhurat	Mungesa e mbi strukturave cilësore të pastrimit të rrugëve	E mesme	Ndikon në shëndet	
Hartimi i Planit Lokal të Mobilitetit	Mungesa e mjeteve financiare	E Ultë	Numri i masat për reduktimin e shkarkimeve	

14.3 Toka

Problemi	Shkaku (Listë shkaqesh që sjellin problemin, që mund të jenë, fizik dhe njerëzore)	Shkalla e ndikimit	Ndikimi (Paraqet ndikim negativ në mjedis, shëndet, mirëqenje etj.)	Prioriteti (I matur me shkallen: *Pak i rëndësishëm **Mesatarisht i rëndësishëm ***Shumë i rëndësishëm.)
Humbja e tokës bujqësore	Ndërtimet e pakontrolluara nga mungesa e hartave zonale	E mesme	Ndikon në uljen e nivelit të zhvillimit të bujqësisë Uljen e kualitetit të tokës bujqësore dhe prodhimeve	
Përmbytja e tokës bujqësore në rastet e rënies së reshjeve me intensitet të lartë.	Mos pastrimi i rregullt i kanaleve të ujitjes dhe mirëmbajtjes dhe rregulimit të lumjeve	E mesme	Behet shpëlarja e tokës bujqësore nga humusi dhe lëndet e tjera ushqyese. Ulet prodhimi i kulturave bujqësore	
Tokat pyjore e kullosat Prezenca e paket e humusit në tokat pyjore të komunës	Prerjet pa kriter të pyjeve	E mesme	Pakësohen rezervat ujore në toke. Shkaktimi i erozioneve	
Prezenca e erozionit në sipërfaqen e tokave pyjore me bimësi të paket	Prerjet pa kriter teknik Pjerrësia relativisht e lartë në disa zona të bjeshkeve	E mesme	Ndikimi në peizazh	
Tokat ndërtimore Përdorim jo racional i tokës ndërtimore	Mungesa e planeve dhe hartave zonale	E mesme	Prishet infrastruktura rrugore	

14.4 Biodiversiteti

Problemi	Shkaku (Listë shkaqesh që sjellin problemin, që mund të jenë, fizik dhe njerëzore)	Shkalla e ndikimit	Ndikimi (Paraqet ndikim negativ në mjedis, shëndet, mirëqenje etj.	Prioriteti (I matur me shkallen: *Pak i rëndësishëm **Mesatarisht i rëndësishëm ***Shumë i rëndësishëm.
Mungesa e një Planit Lokal për Biodiversitetin Evidentimi jo i plote i bimëve me vlera të veçanta e me mundësi përdorimi në mjekësi etj.	Mungesa e fondeve të domosdoshëm për hartimin e dokumentit	E mesme	Dëmtimi i habitateve Varfërimi i biodiversitetit. Mungesa e një strategjie për ruajtjen e biodiversitetit.	
Dëmtimi i habitave të veçanta të florës dhe faunes nga faktori njeri	Zvogëlimi dhe rrezikimi i llojeve të veçanta të florës dhe faunës	E mesme	Dëmtimi i bimëve mjekësuese nga mos njohja Ulja e biodiversitetit Dëmtimi edhe nga prerjet e drurëve- fitocenoza e endomorfike	
Reduktimi i faunës në territorin e Bjeshkëve të Nemuna	Gjuetia e pa ligjshme	E mesme	Pakësimi i vlerave ekologjike Prishja e zinxhirit jetësor e ushqyes në ekosistemin pyll.	

14.5 Peizazhi dhe ekosistemet specifike

Problemi	Shkaku (Listë shkaqesh që sjellin problemin, që mund të jenë, fizik dhe njerëzore)	Shkalla e ndikimit	Ndikimi (Paraqet ndikim negativ në mjedis, shëndet, mirëqenje etj.	Prioriteti (I matur me shkallen: *Pak i rëndësishëm **Mesatarisht i rëndësishëm ***Shumë i rëndësishëm.
Dëmtimi i bregut të lumit të Lloqanit në segmente të caktuara nga vërshimet	Mospastrimi i mbetjeve dhe sedimenteve në shtrate të lumit	E mesme	Ndryshimi i rrjedhjes së lumit e me këtë edhe ndryshimi i konfiguracionit të terrenit Dëmtimi i peizazhit natyror	
Dëmtimi i brezit mbrojtës të terrenit në segmente të caktuara, gjatë ndërtimeve	Gërmime për zgjerim të trasesë së rrugës Mos marrje e masave për modifikim të terrenit të dëmtuar	E mesme	Peizazh jo i këndshëm.	
Erozion apo rreshqitje të dheut përgjatë rrugës R-107	Gërmimet gjatë punimeve dhe mungesa e kanaleve kulluese	E mesme	Peizazh jo i këndshëm.	

14.6 Mjedisi social dhe ekonomik

Problemi	Shkaku (Listë shkaqesh që sjellin problemin, që mund të jenë, fizik dhe njerëzore)	Shkalla e ndikimit	Ndikimi (Paraqet ndikim negativ në mjedis, shëndet, mirëqenje etj.	Prioriteti (I matur me shkallen: *Pak i rëndësishëm **Mesatarisht i rëndësishëm ***Shumë i rëndësishëm.
Fushata të pakta sensibilizuese mjedisore	Mungesa e financimit të aktiviteteve mjedisore si Ditës së Tokës, Ujit dhe Mjedisit	E mesme	Ndikon negativisht në edukimin e përgjithshëm mjedisor Sjellje jo korrekte e komunitetit ndaj vlerave mjedisore.	
Bujqësia Mungesa për ruajtje dhe deponim të prodhimeve vendore	Mungesa e infrastrukturës së nevojshme për grumbullimin e tyre Mungesa e certifikimeve të prodhimeve		Mos interesimi për token dhe kultivimin e qëndrueshëm bujqësor Nuk stimulohet bujqësia natyrore që është në harmoni me mjedisin e zonës	
Blegtoria Mungesa e ikave grumbulluese dhe përpunimit dhe tregimit të produkteve blegtorale.	Mungesa e fondeve për blerje teknologjish.	E mesme	Përfitimet e ulëta dhe prodhime bujqësore të pakta në treg	
Fruta malit Mungesa e një pike grumbulluese dhe përpunuese	Mungesa e fondeve për blerje teknologjish		Prodhime të pakta në tregunë konsumit vendor	

14.7 Turizmi

Problemi	Shkaku (Listë shkaqesh që sjellin problemin, që mund të jenë, fizik dhe njerëzore)	Shkalla e ndikimit	Ndikimi (Paraqet ndikim negativ në mjedis, shëndet, mirëqenie etj.	Prioriteti (I matur me shkallen: *Pak i rëndësishëm **Mesatarisht i rëndësishëm ***Shumë i rëndësishëm.
Mungesa e ofertave turistike në nivel kombëtar dhe lokal	Mungesa e një strategjie zhvillimore për turizëm në nivel lokal	E mesme	Mos optimizmi i zhvillimit turistik ndërkomunal dhe rajonal	
Mungesa e produktit atraktiv turistik nga ana e agjencioneve lokale dhe komunës	Mungesa e promovimit dhe guidave malore të Bjeshkëve të Deçanit		Turizmi i promovuar në masë jo adekuate nga mungesa e ofertës turistike	
Mungesa e një planit për zhvillimin afatgjatë shoqëro-ekonomik (turistikë)	Mungesa e fondeve dhe eksperteve në këtë fushë për hartimin e një plani lokal apo një plani të veprimit për turizëm	E mesme	Turizmi i promovuar në masë jo adekuate nga mungesa e ofertës turistike	
Mungesa e ndërmarrjeve turistike dhe hoteliere të Deçanit	Mungesa e trajnime apo fondeve për aftësimin e kuadrove për guide turistike, apo atraksione tjera promovuese, mungese e materialeve promovuese duke filluar nga spotet, broshurat, etj		Mos zhvillimi i zonës, si dhe ndikimi social dhe migrimi i popullatës për arsye të pa punësisë.	
Ndërtimet pa leje të tebanave(staneve) objekteve në këto zona me potencial turistike	Mungesa e infrastrukturës		Ndotja e mjedisit nga mungesa e infrastrukturës adekuate.	
Shkatërrimi i natyrës dhe peisazheve nga prerjet	Mungesa planeve adekuate		Degradim ambiental	
